AUSTRIAN DEVELOPMENT AGENCY

TFL
TOGETHER FOR LIFE



Klima e përgjithshme e biznesit dhe ndikimi i tërmeteve të vjeshtës 2019 e pandemisë COVID-19 te gratë sipërmarrëse

TOGETHER FOR LIFE

SHTATOR 2020

Studimi "Klima e përgjithshme e biznesit dhe ndikimi i tërmeteve të vjeshtës 2019 e pandemisë COVID-19 te gratë sipërmarrëse" është zhvilluar nga shoqata "Together for Life", në kuadër të projektit "Përmirësimi i fuqizimit ekonomik të grave pas pasojave të tërmetit dhe shpërthimit të COVID-19", mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të kuptuarit e klimës së përgjithshme të biznesit në Shqipëri për gratë drejtuese, dhe ndikimin e tyre nga tërmetet e vjeshtës 2019 dhe pandemia COVID-19. Studimi, i vetmi i detajuar në këtë nivel për gratë sipërmarrëse në Shqipëri, ofron një panoramë të qartë mbi situatën e tyre, problematikat që hasin dhe nevojat që kanë për mbështetje.

Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi e Together for Life dhe nuk reflekton qëndrimin e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

EKSPERTE E STUDIMIT DHE AUTORE E RAPORTIT

Alketa Berzani

GRUPI I PUNËS

Alketa Berzani

Alma Lahe

Silvana Xheka

Autor: © TOGETHER FOR LIFE

Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil –Tekno Projekt

Shk.2, Ap.14

Tiranë, Shqipëri

Email: info@togetherforlife.org.al

Web: www.togetherforlife.org.al

Përmbajtja e lëndës

1. **Rishikim literature e studimesh të tjera** 10
1.1 Parathënie për studimin 11
1.2 Sipërmarrja private në Shqipëri dhe përfshirja e grave 12
1.3 Vështirësitë e biznesit dhe grave sipërmarrëse 18
1.4 Tërmetet e vjeshtës 2019 në Shqipëri dhe pasojat në sektorin privat 30
1.5 Pandemia COVID-19 në Shqipëri dhe pasojat në sektorin privat 36
Metodologjia 41
2.1 Objektivat studimorë 42
2.2 Përqasja metodologjike dhe profili i të anketuarve 42
2.3 Instrumentet studimore 46
2.4 Aspekte etike 47
2.5 Kufizime të studimit 48
Gjetjet studimore 49
3.1 Klima e përgjithshme, vështirësitë tipike dhe nevojat e sipërmarrjes së grave 50
3.2 Tërmetet e vjeshtës 2019 dhe ndikimi në sipërmarrjen e grave 63
3.3 Pandemia COVID-19 dhe ndikimi në sipërmarrjen e grave 66
3.4 Nevojat e biznesit dhe mbështetja pas tërmeteve të vjeshtës 2019 e COVID-19 68
Rekomandime 77
Anekse 82
Aneksi A – Lista e grafikëve dhe tabelave 82
Aneksi B – Pyetësori sasior për studimin online me gratë sipërmarrëse 82
Aneks C – Udhërryesi për intervistat me institucionet publike dhe mikrofinanciare 92

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shoqata “Together for Life”, në kuadër të projektit “Përmirësimi i fuqizimit ekonomik të grave pas pasojave të tërmetit dhe shpërthimit të COVID-19”, mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), zhvilloi një studim me fokus gratë sipërmarrëse. Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të kuptuarit e klimës së përgjithshme të biznesit në Shqipëri për gratë drejtuese, dhe ndikimin e tyre nga tërmetet e vjeshtës 2019 dhe pandemia COVID-19. Studimi, i vetmi i detajuar në këtë nivel për gratë sipërmarrëse në Shqipëri, ofron një panoramë të qartë mbi situatën e tyre, problematikat që hasin dhe nevojat që kanë për mbështetje.

Përpos hulumtimit të literaturës, strategjive, akteve normative, statistikave e raporteve studimore, ky studim përfshin në thelb komponentin sasior, dhe konkretisht janë realizuar 200 intervista të suksesshme online gjatë periudhës 30 prill – 15 qershor 2020, si edhe komponentin cilësor, duke përfshirë këndvështrimin e autoriteteve shtetërore dhe institucioneve mikrokredituese.

Analiza e të dhënave sasiore, e cila paraqet përvojën e grave sipërmarrëse, vështirësitë dhe nevojat e tyre të shtuara për shkak të pasojave të shumta të tërmeteve që goditën vendin në vjeshtën e 2019 dhe pandemisë COVID-19, nxjerr në pah disa gjetje kryesore, si më poshtë vijon:

Klima e biznesit deri në nëntor 2019 dhe problematikat gjinore

Deri përpara goditjes së vendit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, situata e bizneseve të drejtuara nga gratë paraqitet mesatare, në terma të aktivitetit dhe fitimeve. Situata e këtyre bizneseve në Tiranë paraqitet lehtësisht më e mirë sesa ato në qarqet Lezhë e Durrës, sikurse situata e kompanive me 10+ punonjës paraqitet disi më e mirë se mikrobizneset me 1-9 punonjës.

Shumica dërrmuese e grave sipërmarrëse (85%) hasin në aktivitetin e tyre të përditshëm vështirësi të lidhura me shitjet e marketingun, legjislacionin e detyrimet shtetërore. Gati 7 nga 10 prej tyre kanë vështirësi në financimin e aktivitetit, me tregun e punës dhe burimet njerëzore.

Vështirësitë në shitje e marketing për 6 nga 10 gratë sipërmarrëse nënkuptojnë luhatjen e kërkesës ose klientelën e paqëndrueshme, si dhe informalitetin e lartë. Më shumë se gjysma vlerësojnë si të larta kostot e marketingut dhe konkurrencën e ashpër si pengesë për zhvillim.

Legjislacioni dhe detyrimet shtetërore janë shqetësim madhor për 7 nga 10 ndërmarrjet që drejtohen nga gratë, për shkak të taksave e tatimet e larta dhe ndryshimeve të vazhdueshme në sistemin fiskal. Gjithashtu, 6 nga 10 biznese besojnë se ka mungesa në kuadrin ligjor, ndërkohë që për ndërmarrjet me 10+ punonjës veçanërisht shqetësuese është mosrimbursimi i TVSH-së nga shteti dhe korrupsioni në radhët e administratës shtetërore.

Vështirësitë për financim mes grave sipërmarrëse fillojnë nga sigurimi i informacionit të nevojshëm mbi subvencionet, grantet apo kreditë dhe interesat e larta të kredive nga institucionet financiare, dominuese në 6 nga 10 biznese.

Më shumë se 6 nga 10 gra të vetëpunësuar ose profesioniste të lira ankohen për mungesën e ofrimit të kredive të zbutura dhe interesat e larta të kredive aktualisht. Po kaq e lartë është edhe frekuenca e bizneseve me 10+ punonjës, që ankohen për problemin e likuiditetit, si afate të gjata shlyerjeje, shlyerje të vonuara, pagesa me klering.

Tregu i punës dhe burimet njerëzore janë një shqetësim madhor për bizneset e drejtuara nga gratë, ku dominon mungesa e stafit të kualifikuar dhe me përvojë (68%). Kjo problematikë shfaqet veçanërisht e lartë tek ndërmarrjet 10+ punonjës (89%) dhe kjo është e kuptueshme pasi kjo kategori punëson më shumë, pra ka më shpesh procedura rekrutimi dhe kërkesa për specialistë të ndryshëm. Më shumë se gjysma e grave sipërmarrëse shprehen për vështirësitë e krijuara nga kërkesa e punonjësve për paga të larta e bonuse, ndërkohë që në Shqipëri paga mesatare bruto rezulton 52,380 Lekë (INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri, 2020). Zhvillimet e vazhdueshme teknologjike vendosin më shumë se gjysmën e grave sipërmarrëse përpara vështirësisë për të kryer investime të vazhdueshme në linjat e prodhimit, makineritë, pajisjet e programet me qëllim përshtatjen e biznesit të tyre me këto ndryshime.

Gjatë rutinës së biznesit, vështirësitë sociale të shprehura nga gjysma e grave sipërmarrëse i rendit këto problematika në vendin e fundit, duke vënë në pah se sa shqetësuese janë problematikat e tjera, si: financimi, shitjet etj. Ndërkohë, kur flitet për vështirësi të ndikuara ose që i atribuohen gjinisë së pronareve dhe drejtueseve, këto problematika sociale shfaqen më të shtuara dhe klasifikohen si më tipiket e më të shpeshtat. Kjo është e kuptueshme, pasi vetë këto gra ja kanë dalë të ngrenë aktivitetin e tyre privat, pavarësisht mentalitetit apo vështirësisë për të balancuar prezencën në biznes me rolin në familje. Ndërkohë disave iu është dashur të luftojnë për të arritur e të tjera dëshmojnë se si gratë përreth ballafaqohen me këto problematika gjinore.

Sipas grave sipërmarrëse, politikat publike dhe mjedisi i biznesit në Shqipëri janë qartazi më shumë favorizuese përkundrejt burrave sipërmarrës. Rreth 6 nga 10 gra sipërmarrëse veçojnë se fitimi i tenderave publikë e koncesioneve, si dhe mundësia për të hyrë në treg ose për t'iu përqasur tregjeve të reja janë më shumë në favor të sipërmarrësve meshkuj. Ndërkohë që gjysma beson sërish se politikat dhe mjedisi favorizon më shumë promovimin e sipërmarrjes private ku pronarët a drejtuesit janë meshkuj. Përjashtim bën vetëm qasja gati e barabartë për të dyja gjinitë në edukim dhe trajnim për menaxhimin e ndërmarrjeve private.

Mbështetja aktuale e qeverisë për biznesin e grave dhe nevojat e paplotësuara

Mbështetja e qeverisë shqiptare e aktorëve të tjerë ndër vite ka qenë e kufizuar për gratë sipërmarrëse, duke variuar midis 4% dhe 11% ndërmarrje që kanë përfituar fonde nga qeveria shqiptare, donatorët e bankat. Gratë sipërmarrëse kanë përfituar më shumë fonde nga donatorët e huaj e vendas dhe bankat e institucionet mikrokredituese sesa nga qeveria shqiptare, e cila duket se ka kontribuar më shumë për mbështetjen e tyre pas tërmetit të nëntorit 2019. Profesionistet e lira ose gratë e vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë kanë marrë më pak mbështetje nga të gjithë aktorët.

Vetëm 1 në 20 prej tyre kanë përfituar fonde publike të qeverisë shqiptare pas tërmetit të nëntorit 2019. Mikrobizneset me 2-9 punonjës janë mbështetur më shumë nga donatorët e huaj dhe vendas, kurse ndërmarrjet me 10+ punonjës kanë marrë më shumë mbështetje nga bankat dhe institucionet e tjera financiare.

Gati 2 në 3 gra sipërmarrëse rendisin nevojën për mundësi financimi si prioritetin kryesor për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve të tyre dhe grave të tjera të cilat duan të përfshihen e ofrojnë nisma të reja private. Me mundësi financimi ato nënkuptojnë nga ofrimi i financimit të drejtpërdrejtë, lehtësira fiskale, lehtësira në përfitimin e fondeve, hartimin e politikave buxhetore me ndikim gjinor, e deri te fushatat informuese mbi programet mbështetëse për financim. Dy nevoja të tjera të rëndësishme, komplekse dhe imediate për 4 nga 10 gra sipërmarrëse, janë gjetja e tregjeve dhe kanaleve të reja të shitjes, si dhe krijimi i një portali online i dedikuar për gratë sipërmarrëse që nga promovimi, këshillimi etj.

Ofrimi i trajnimeve e seminareve për menaxhim e udhëheqje, që fokusohet tek aspektet ligjore e fiskale, komunikimi e marketingu, zhvillimi i burimeve njerëzore, teknikat e negocimi etj, është një tjetër nevojë që duhet parashikuar për të mbështetur gratë sipërmarrëse në fillimet dhe përgjatë veprimtarisë së tyre. Njohja, grupimet formale dhe shkëmbimi mes grave sipërmarrëse shfaqet si një sugjerim dhe njëkohësisht nevojë për t'i fuqizuar ato edhe më shumë përkundrejt mjedisit jo fort favorizues. Promovimi i barazisë gjinore dhe sipërmarrjes femërore në media dhe, më herët, në kurrikulat e praktikat mësimore, theksohet si një nevojë për të edukuar brezat e ardhshëm, për të zbehur stereotipat e paragjykimet shoqërore, dhe për të nxitur shpirtin e praktikën sipërmarrëse.

Pasojat e tërmeteve të vjeshtës 2019 dhe COVID-19

Sikurse është e pritshme, fatkeqësi si tërmetet dhe pandemia COVID-19 në përgjithësi sjellin pothuaj vetëm pasoja negative tek biznesi. Vetëm 1% e ndërmarrjeve kanë pasur efekte pozitive prej tërmetit dhe 4% prej COVID-19 për shkak të natyrës së biznesit që zhvillojnë.

Më shumë se 8 nga 10 ndërmarrje të drejtuara nga gratë në këto tri qarqe janë ndikuar negativisht (shumë ose disi) si pasojë e tërmeteve. Bizneset në Durrës e Lezhë kanë nivel edhe më të lartë të ndikimit negativ sesa në Tiranë (88% vs. 77%). Tirana është qarku ku më shumë se 1 në 5 biznese e cilësojnë tërmetin si neutral për aktivitetin e tyre.

Më pak se gjysma e bizneseve kanë pësuar ulje të xhiros e fitimit. Gjysma e ndërmarrjeve në Durrës e Tiranë kanë rezultuar me ulje të xhiros e fitimit, kundrejt 1 në 3 të homologeve në Lezhë. Gjatë asaj periudhe, 1 në 3 ndërmarrje në total të drejtuara nga gratë kanë pezulluar përkohësisht veprimtarinë e tyre, por me frekuencë më të lartë në Durrës (50%).

Ndërkohë që në total më shumë se 1 në 4 biznese të drejtuara nga gratë kanë pësuar dëmtime të ambienteve të biznesit (fabrikë, dyqan, zyrë, magazinë, etj). Kjo përqindje është më e lartë në Durrës dhe Lezhë, ku janë dëmtuar ambientet e 1 në 3 ndërmarrje, dhe është më e ulët në Tiranë, ku kanë pësuar dëmtime të ambienteve të biznesit 1 në 7 ndërmarrje.

Gati 1 në 5 ndërmarrje me 10 ose më shumë punonjës në strukturë kanë ulur numrin e stafit paralelisht me volumin e prodhimit si pasojë e tërmeteve të vjeshtës 2019.

COVID-19 ka prekur edhe më fort ndërmarrjet e drejtuara nga gratë në këto tre qarqe, ku më shumë se 9 nga 10 janë ndikuar negativisht (shumë ose disi). Gjatë fazës së parë të shpërthimit të pandemisë (mars - qershor), gjysma e ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë bllokuan plotësisht veprimtarinë ose e pezulluan atë përkohësisht. Më tej, gjysma e grave sipërmarrëse pësuan ulje të xhiros e fitimit; 1 në 3 prej tyre hasën vështirësi për të shlyer detyrimet ndaj shtetit dhe palëve të treta, ndërkohë që 3 nga 10 shtuan shpenzimet për të garantuar kushtet higjieno-sanitare bashkë me dezinfektimin e ambienteve të punës.

Një pjesë e barrës së krijuar nga pandemia është mbartur nga punonjësit. Më pak se 1 nga 5 ndërmarrje ka shkurtuar personel dhe po kaq kanë ulur pagat e stafit. Më pak se 1 në 10 ndërmarrje i kanë ndërmarrë të dyja këto masa: shkurtim personeli dhe reduktim page (8.5%). Shkurtimi i personelit ka ndodhur në 1 prej 3 ndërmarrjeve me 10+ punonjës dhe gati 1 prej 5 mikrobizneseve me 2-9 punonjës. Reduktimi i pagave ka qenë një strategji e aplikuar në nivel të ngjashëm midis këtyre bizneseve (më shumë se 1 në 5 ndërmarrje), por studimi nuk ka matur masën e reduktimit, pra sa për qind e pagës është reduktuar nga secila kategori e ndërmarrjeve.

Mbështetja e biznesit për t'u rimëkëmbur nga efektet e tërmetit dhe COVID-19

Edhe pse ka kaluar 6 muaj nga miratimi i paketës së plotë fiskale e ndihmuese të qeverisë për ndihmën ndaj popullatës dhe biznesit të dëmtuar nga tërmeti, më pak se 1 nga 5 ndërmarrje të drejtuara prej grave kanë marrë mbështetje nga pushteti qendror ose lokal. Pjesa më e madhe e tyre (66%) nuk kanë marrë asnjë lloj mbështetjeje, edhe pse janë ndikuar negativisht nga tërmeti.

Ndihma e shtetit shqiptar ka konsistuar në (a) njohjen e shpenzimeve në bilanc për dëmet materiale, të mallrave, ndërtesave dhe çdo shpenzimi të kryer për rindërtim prej tërmetit; (b) heqjen e TVSH-së për materialet e ndërtimit; dhe (c) përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga të cilat kanë përfituar respektivisht 8%, 5% dhe 4% e grave sipërmarrëse. Shumica e ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë (60%) janë mbështetur në një formë ose tjetër nga qeveria për të përballuar efektet e pandemisë COVID-19. Frekuenca e kësaj ndihme është në raport të drejtë me madhësinë e biznesit: janë mbështetur më shumë ndërmarrje me 10+ punonjës (70%) e mikrobiznese me 2-9 punonjës (62%) sesa gra të vetëpunësuar pa punonjës (48%). Megjithatë, 1 në 3 gra sipërmarrëse nuk kanë marrë asnjë mbështetje, pavarësisht pasojave negative që ka sjellë COVID-19 në veprimtarinë e tyre private.

Rreth 1 në 5 biznese të drejtuara nga gratë kanë përfituar nga qeveria shumën prej 40 mijë lekësh për periudhën prill – qershor 2020; gati 1 në 7 biznese të drejtuara nga gratë kanë përfituar "pagën e luftës", përfshi ato të vetëpunësuara; dhe vetëm 4% kanë marrë mbështetje për rimbursimin e pjesshëm të pagës së punonjësve. Rreth 1 në 5 biznese të drejtuara nga gratë deklarojnë si mbështetje shtyrjen e deklarimit të bilanceve dhe 1 në 10 shtyrjen e afatit për shlyerjen e kredisë.

Pritshmëritë dhe nevojat e grave sipërmarrëse për të ardhmen e afërt

Gratë sipërmarrëse besojnë se pasojat kryesore biznesi do t'i vuajë në shumë aspekte, kryesisht në 6-mujorshin e parë të pandemisë (maj – tetor 2020), por një pjesë do të vijojë edhe më tej. Gjysma e tyre parashikojnë ulje të xhiros dhe fitimit, ndonëse vetëm 1 në 4 pret që të ulë volumin e prodhimit gjatë kësaj periudhe. Pothuaj 1 në 3 biznese të drejtuara nga gratë pret të përballet me vështirësi në furnizimin me lëndën e parë. Si pasojë e këtyre dhe problematikave të tjera, 1 nga 4 gra sipërmarrëse do të vijojë të paguajë stafin me pagë të reduktuar, dhe 1 nga 5 do të shkurtojë personel. Gati 3 nga 10 biznese do të mendojnë huamarrjen, gjysma e të cilëve prej bankave (15%) dhe gjysma tjetër prej individëve të njohur (14%).

Biznesi i drejtuar prej grave në rrethana normale has një sërë vështirësish, të cilat u përmendën më herët. Në kushtet e efekteve të amplifikuara prej tërmetit dhe pandemisë, problematikat janë thelluar e shtuar, duke e bërë edhe më të nevojshme ndërhyrjen e shtetit dhe aktorëve të tjerë. Për këtë arsye, teksa shteti shqiptar harton paketat lehtësuese dhe ndihmuese ndaj sektorit privat, gratë sipërmarrëse kërkojnë që të ketë një vëmendje të shtuar ndaj ndërmarrjeve të tyre, sidomos ndaj profesionisteve të lira, bizneseve të vogla dhe atyre të reja. Ndërkohë që nuk duhet lënë jashtë vëmendjes edhe biznesi më i madh, i cili punëson një numër të lartë punonjësish.

Si prioritet nga shumica prej tyre (72%) shfaqet kërkesa për të lehtësuar barrën fiskale ose reduktimin e TVSH-së dhe taksave qendrore e vendore, minimalisht për një periudhë 6-12 mujore. Gati 4 nga 10 sipërmarrëse kërkojnë nga shteti politika lehtësuese ose reduktimin e kontributeve shëndetësore e shoqërore që duhet të paguajnë për personelin, si dhe ofrimin e granteve e subvencioneve. Rreth 3 nga 10 sipërmarrëse shprehin nevojën për politika lehtësuese mbi shlyerjen e qirave, shlyerjen e borderosë dhe ndihmë të drejtpërdrejtë financiare, si p.sh. me anë të kredive të zbutura. Disa kërkojnë thjesht lehtësim ose relaksim të masave për lëvizjen e lirë brenda e jashtë vendit apo për organizimin e aktiviteteve me shumë pjesëmarrës etj.

KAPITULLI I

RISHIKIM LITERATURE E STUDIMESH TË TJERA

1.1 Parathënie për studimin

Shoqata "Together for Life", në kuadër të projektit "Përmirësimi i fuqizimit ekonomik të grave pas pasojave të tërmetit dhe shpërthimit të COVID-19", mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), realizoi studimin "Klima e biznesit dhe ndikimi i tërmeteve të vjeshtës 2019 dhe pandemisë COVID-19 te gratë sipërmarrëse". Mbledhja e të dhënave sasiore online me gratë sipërmarrëse filloi në 30 prill dhe përfundoi në 15 qershor 2020.

Gratë dhe vajzat janë kthyer në gjeneruese të rritjes ekonomike në nivel ndërkombëtar. Arritja e diversitetit gjinor në sipërmarrjen private është me rëndësi jetike për të përmirësuar rezultatet e biznesit. Sipas një analize të Boston Consulting Group (2019), nëse gratë do të kishin përfaqësim të barabartë me burrat në sipërmarrje, PBB-ja në rang global mund të rritej me 3-6%, duke ndihmuar rritjen e ekonomisë globale me 2.5 – 5 trilionë dollarë.[1] Edhe pse gratë në Shqipëri përbëjnë 50.1% të popullsisë, sipërmarrëset femra përfaqësojnë 32.0% të të vetëpunësuarve dhe vetëm 25.4% të pronarëve/administratorëve të ndërmarrjeve aktive në vend gjatë vitit 2019.[2] Ekzistojnë disa faktorë shtesë, siç është bashkërendimi i biznesit dhe përgjegjësive të shumta familjare apo dominanca mashkullore e mjediseve të biznesit ndër vite, që e bëjnë sipërmarrjen private një mundësi më pak praktike e tërheqëse për gratë sesa për burrat. Krijimtaria femërore dhe potenciali sipërmarrës i grave janë një burim i nënshfrytëzuar i rritjes ekonomike dhe i shtimit të vendeve të punës.[3]

Shqipëria në këto 12 muajt e fundit ka përjetuar dy fatkeqësi natyrore, tërmetet e 21 shtatorit dhe 26 nëntorit 2019, të cilat krijuan dëme e humbje në një vlerë mbi 980 milionë euro, dhe pandeminë COVID-19, dëmet dhe humbjet e të cilës nuk janë llogaritur ende. Të gjitha këto kanë ndikuar ndjeshëm ekonominë e brishtë shqiptare, konsumatorin dhe sipërmarrjen private në vend.

Për të gjitha këto arsye, "Together for Life" ndërmori një studim në qarqet e prekura nga tërmeti: Durrës, Tiranë dhe Lezhë, të cilat, sikurse pjesa tjetër e vendit, janë prekur gjithashtu nga shpërthimi i pandemisë COVID-19. Ky studim ka për qëllim të kuptojë situatën në të cilën vepron sipërmarrja femërore dhe vështirësitë që has në 'normalitet', ndikimin e tërmetit dhe COVID-19, si dhe nevojat e tyre për të zhvilluar biznesin e për t'u rimëkëmbur.

Rezultatet e studimit do t'u prezantohen të gjithë aktorëve, duke filluar nga qeveria e institucionet publike përgjegjëse për sipërmarrjen e politikat gjinore, tek institucionet financiare, banka e jo banka, me qëllim nxitjen e tyre për të hartuar politika, programe e oferta të përmirësuara ndaj sipërmarrjes femërore dhe për të ndërmarrë masa efektive në mbështetje të bizneseve të drejtuara prej grave.

1. https://cherieblairfoundation.org/app/uploads/2019/09/our-three-year-strategy-cherie-blair-foundation-for-women.pdf
2. INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020, Fq.20, 22, 78-79, 125
3. https://ec.europa.eu/growth/smes/promoting-entrepreneurship/we-work-for/women_en

Shoqata "Together for Life" beson që ky studim do të jetë një pikënisje për matje e analiza të mëtejshme mbi sipërmarrjen e gruas në Shqipëri, sikurse edhe një pikëtakimi e frymëzimi për të gjitha gratë që planifikojnë ose veprojnë në sipërmarrjen private.


1.2 Sipërmarrja private në Shqipëri dhe përfshirja e grave

Fillimisht disa shifra për punësimin e grave në Shqipëri…

Bazuar tek Anketa e Forcave të Punës, INSTAT deklaron se për sa i përket popullsisë 15-64 vjeç, diferenca e pjesëmarrjes së burrave dhe grave në forcat e punës në 5-6 vitet e fundit ka qenë pothuajse i pandryshuar, me një përmirësim të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës me 61.6% në vitin 2019, nga 50.1% që ishte në vitin 2013.[4]

Sipas arsyeve të inaktivitetit, gratë mbesin jashtë forcës së punës kryesisht pasi janë nxënëse, studente, në trajnim të mëtejshëm, përvojë pune pa pagesë (22.3%) ose duke përmbushur detyrat shtëpiake (18.0%). Vetëm 1.0% e burrave kanë si arsye të inaktivitetit të tyre përmbushjen e detyrave shtëpiake dhe 28.1% e tyre janë nxënës a studentë.[5]


Grafiku 1: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, grupmosha 15-64 vjeç (në %)



Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç gjatë vitit 2019 është 68.2% për burrat dhe 54.4% për gratë, duke shënuar një rritje për të dyja gjinitë krahasuar me vitin paraardhës. Megjithatë, shkalla e punësimit, sikurse pjesëmarrja e grave në forcat e punës, është më e vogël sesa te burrat.[6]


4. Gjendet në: http://databaza.instat.gov.al/sq/2ed8cc50-eb6a-49af-9acf-22fa383b7e5e
5. INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020, Fq.71
6. Ibid.

Grafiku 2: Shkalla e punësimit te grupmosha 15-64 vjeç (në %)



Për vitin 2019, struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregojnë se 27.1% e grave janë të punësuara me pagë, ndërsa 15.2% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Për burrat e punësuar këto shifra janë përkatësisht 31.3% dhe 10.8%. Rritja e shkallës së punësimit të grave ka ardhur nga rritja e ngjashme si tek ato të punësuara me pagë dhe tek ato pa pagë, respektivisht +1.6 dhe +1.2 pikë përqindje. Një pjesë e konsiderueshme e burrave që punojnë janë të vetëpunësuar, konkretisht në vitin 2019 janë 26.1%, ndonëse me një rënie prej 1.3 pikë përqindje krahasuar me vitin paraardhës, ndërsa gratë e vetëpunësuara përbëjnë 12.1%.[7]

Grafiku 3: Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç sipas gjinisë, viti 2018-2019



Për gratë dhe burrat e moshës 15-64 vjeç mbizotëron punësimi në sektorin e bujqësisë. Në vitin 2019, në këtë sektor janë punësuar 41.6% e të punësuarave gra, duke pësuar një rënie me 0.7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

7. INSTAT. Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020. Fq.71

Sektori i dytë që zë peshën më të madhe në punësimin e të dyja gjinive, pas sektorit të bujqësisë, është tregtia, më pas transporti, hoteleria, shërbime të biznesit dhe administrative, përkatësisht me 21.6% të punësuara gra dhe 31.7% burra.[8]

Kufizimet ligjore e rregullatorë, së bashku me mangësitë në zbatimin e ligjit, ende pengojnë shfrytëzimin e plotë të mundësive ekonomike për gratë. Ndërkohë që vendi humbet çdo vit rreth 20% të PBB-së, për shkak të përfaqësimit të ulët të grave në forcën e punës, numrit të lartë grave që punojnë pa pagë ose të nënpaguara, si dhe diferencës në paga mes burrave e grave.[9]

Ndërmarrjet ekonomike dhe gratë sipërmarrëse në Shqipëri

Numri i ndërmarrjeve ekonomike aktive në fund të vitit 2019 është 162,342, pra pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar, duke shënuar një rënie të lehtë me 493 ndërmarrje ose 0.3% më pak se në vitin 2018. Bujqësia dhe tregtia zënë përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve, respektivisht me 28.2% dhe 27.3%. Nga analiza e ndërmarrjeve sipas madhësisë, rezulton se mbizotërojnë mikrondërmarrjet me 1-4 të punësuar (89.2%) dhe kontributi i tyre në punësim llogaritet të jetë 26.2%. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përbëjnë vetëm 1.2% të ndërmarrjeve gjithsej në vend, por kontributi i tyre në punësim llogaritet të jetë 47.8% në vitin 2019 nga 48.1% në vitin 2018.[10]

Tabela 1: Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë, viti 2019


Aktiviteti ekonomik: gjendje në fund të vitit 2019	Gjithsej Total		Grupuar sipas numrit të të punësuarve 1-4 punonjës		5-9 punonjës		10-49 punonjës		50+ punonjës	
Gjithsej	**162,342**	**100%**	**144,857**	**100%**	**8,569**	**100%**	**6,932**	**100%**	**1,984**	**100%**
Prodhuesit e të mirave	**60,061**	**37.0%**	**55,342**	**38.2%**	**1,871**	**21.8%**	**2,052**	**29.6%**	**796**	40.1%
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	45,705	28.2%	45,543	31.4%	85	1.0%	66	1.0%	11	0.6%
Industria	9,630	5.9%	6,681	4.6%	1,122	13.1%	1,251	18.0%	576	29.0%
Ndërtimi	4,726	2.9%	3,118	2.2%	664	7.7%	735	10.6%	209	10.5%
Prodhuesit e shërbimeve	**102,281**	**63.0%**	**89,515**	**61.8%**	**6,698**	**78.2%**	**4,880**	**70.4%**	**1,188**	**59.9%**
Tregtia	44,324	27.3%	39,971	27.6%	2,498	29.2%	1,658	23.9%	197	9.9%
Transporti dhe magazinimi	5,614	3.5%	5,101	3.5%	251	2.9%	208	3.0%	54	2.7%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	18,440	11.4%	15,819	10.9%	1,758	20.5%	794	11.5%	69	3.5%
Informacioni dhe komunikacioni	3,089	1.9%	2,554	1.8%	267	3.1%	213	3.1%	55	2.8%
Shërbime të tjera	30,814	19.0%	26,070	18.0%	1,924	22.5%	2,007	29.0%	813	41.0%

8.INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020, Fq.71
9. Gjendet në: https://www.worldbank.org/sq/news/press-release/2019/11/14/albania-to-enhance-gender-equality-in-access-to-economic-opportunities-with-world-bank-support
10. INSTAT, Regjistri i Ndërmarrjeve Ekonomike 2019, Fq.8-14

Të dhënat e INSTAT tregojnë se nga viti 2012 deri në vitin 2018 ka pasur një rritje të vazhdueshme të ndërmarrjeve ekonomike në vend, edhe pse rritja nga 2017 në 2018 është minimale (vetëm 0.2%). Trendi i sipërmarrjes së grave ka të njëjtën rritje në numër nominal, ndërkohë që në terma të kontributit të tyre në përqindje ka ulje-ngritje. Rritja më e ndjeshme e bizneseve të grave ka ndodhur në vitin 2015, ku shënohen 47,706 ndërmarrje aktive nga 32,023 në vitin 2014, dhe rritja e dytë në vitin në vitin 2017, ku kishte 48,193 ndërmarrje aktive të udhëhequra nga gratë nga 43,003 në vitin 2016.

Viti 2019 ka shënuar një ulje të lehtë tek gratë sipërmarrëse përkundrejt vitit paraardhës me 0.3 pikë përqindje. Ato kanë drejtuar 25.4% të gjithë ndërmarrjeve aktive gjatë vitit 2019; kjo përqindje është më e lartë tek kategoria e prodhuesit të shërbimeve (33.3%) dhe më e ulët tek prodhuesit e të mirave (11.9%). Femrat drejtuese kanë përfshirje minimale në sektorin e ndërtimit (9.8%) dhe në sektorin e transportit e magazinimit (5.8%). [11]

Grafiku 4: Ecuria e ndërmarrjeve aktive dhe sipërmarrjes femërore ndër vite, 2010 – 2019




Gjatë vitit 2019, gratë sipërmarrëse zënë 21.3% të ndërmarrjeve me 50+ të punësuar, ndërkohë që kanë më shumë pjesë në mikrobizneset me 1-4 punonjës, ku drejtojnë 25.8% të tyre. Në krahasim me vitin 2018, ku gratë drejtonin 386 ndërmarrje me 50+ punonjës dhe zinin 19.6% të kësaj kategorie, në vitin 2019 ka një rritje me 1.7 pikë përqindje.[12]


Nëse fokusohemi tek 41,209 ndërmarrjet e drejtuara nga gratë gjatë vitit 2019, vëmë re se ato janë kryesisht mikrobiznese me 1-4 të punësuar, konkretisht 90.5% e totalit, pasuar nga 4.9% mikrobiznese me 5-9 të punësuar. Ndërmarrjet me 10-49 punonjës dhe ato me 50+ punonjës zënë respektivisht 3.5% dhe 1.0%, vlera këto lehtësisht më të ulëta se sa përqindja që kanë këto ndërmarrje në totalin e bizneseve në vend (shiko grafikun 6).[13]

11. INSTAT, Regjistri i Ndërmarrjeve Ekonomike 2019, Fq. 16, 28
12. INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020, Fq.125
13. INSTAT, Regjistri i Ndërmarrjeve Ekonomike 2019, Fq. 28

Grafiku 5: Raporti gjinor i sipërmarrësve, viti 2019



Grafiku 6: Madhësia e bizneseve në total dhe ato të drejtuara nga gratë, viti 2019



Në vitin 2019, gratë drejtuese vazhdojnë të kenë përqendrimin më të lartë në qarkun e Tiranës (32.4%), ndërkohë që gjenden më pak në qarkun e Beratit (17.5%). Ky vit ka shënuar rritje në numër nominal biznesesh të drejtuara nga gratë vetëm në qarqet Tiranë, Fier dhe Kukës, kurse kanë pësuar rënie në nëntë qarqet e tjera.[14]


14. INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020, Fq.126

Tabela 2: Ndërmarrjet aktive me pronar / administrator femër ndër vite (2012 – 2019)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Tiranë	13,064	14,463	15,197	18,141	17,498	19,306	17,299	17,383
Durrës	3,121	2,816	2,640	3,930	3,787	4,216	3,690	3,450
Lezhë	731	796	970	1,581	1,666	1,697	1,562	1,495
Elbasan	1,819	1,858	2,016	3,367	3,297	3,823	3,186	3,156
Fier	2,554	2,615	2,576	6,106	4,174	4,767	4,006	4,034
Vlorë	2,378	2,519	2,707	3,934	3,464	3,746	3,184	3,040
Korçë	1,667	1,742	1,965	3,287	2,613	3,010	2,559	2,520
Berat	1,247	1,270	1,229	2,186	1,638	1,992	1,631	1,602
Gjirokastër	613	655	644	1,089	1,120	1,294	1,089	1,057
Shkodër	1,644	1,565	1,508	3,012	2,725	3,085	2,581	2,476
Dibër	314	376	404	736	705	791	663	608
Kukës	140	160	167	337	316	466	375	388
Total vendi	**29,292**	**30,835**	**32,023**	**47,706**	**43,003**	**48,193**	**41,825**	**41,209**

Përfaqësimi i grave në qarkun e Tiranës, Durrësit, Vlorës dhe Lezhës është më i lartë sesa shpërndarja e ndërmarrjeve aktive në përgjithësi. Gati gjysma e grave sipërmarrëse veprojnë në qarqet Tiranë e Durrës. Më konkretisht, 42.2% e ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë janë aktive në qarkun e Tiranës, kurse Durrësi është qarku i tretë për nga madhësia ku janë të vendosura gratë sipërmarrëse, me 8.4%.

Grafiku 7: Shpërndarja gjeografike e ndërmarrjeve aktive në total vs. ndërmarrjeve me pronar / administrator femër, viti 2019



1.3 Vështirësitë e biznesit në përgjithësi dhe grave sipërmarrëse në veçanti

Problematikat e sipërmarrjes private në përgjithësi

Sipas Forumit Ekonomik Botëror dhe "Raportit të Konkurrushmërisë Globale 2019",[15] në renditjen e përgjithshme Shqipëria zë vendin e 81 nga 141 vende nga gjithë bota, me një indeks prej 57.6 pikësh. Shqipëria shënon një rënie prej 5 vendesh ose 0.5 pikë më pak nga viti 2018. Disa nga shtyllat e vlerësimit, si: institucionet, shëndetësia, aftësitë, tregu i produkteve, dinamika e biznesit dhe kapaciteti për inovacion kanë rënie, të tjera janë përmirësuar, si: infrastruktura, përshtatja e TIK, tregu i punës, sistemi financiar dhe madhësia e tregut.

Shqetësuese mbetet renditja e vendit, përtej vendit të 100, për indikatorë si: krimi i organizuar, pavarësia e gjyqësorit, efiçenca e kuadrit ligjor (për të sfiduar vendimet e veprimet e qeverisë, si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve), e drejta e pronës, infrastruktura e transportit (ndërlidhja rrugore), konkurrueshmëria vendore, efekti i taksave dhe subvencioneve, te konkurrenca, lehtësia për të gjetur punonjës të aftë, kultura sipërmarrëse, kërkimi e zhvillimi (R&D), ndërveprimi dhe diversiteti.


Ndërkohë, sipas raportit të Bankës Botërore "Lehtësia e të bërit biznes 2019",[16] Shqipëria renditet në vendin 63 nga 190 vende me një indeks prej 69.51 pikësh, duke shënuar një përmirësim prej 0.5 pikësh nga viti i mëparshëm. Shqetësuese shfaqet renditja e vendit për indikatorë si lejet e ndërtimit, marrja e energjisë dhe pagesa e taksave.

Komisioni Evropian monitoron zhvillimet në qasjen e ndërmarrjeve të vogla e të mesme me 1-249 punonjës (NVM) në financa ose kapital përmes studimit mbi "Mundësinë e Aksesit në Financat e Ndërmarrjeve", i cili zhvillohet çdo vit me 36 shtete nga BE dhe Ballkani.[17] Në 6-mujorin e parë të vitit 2019 kanë marrë pjesë 18,159 NVM në total, nga të cilat 102 ndërmarrje të tilla nga Shqipëria.

Ndërmarrjet e vogla e të mesme shqiptare vlerësojnë se gjatë vitit 2019 perspektiva e përgjithshme ekonomike, e cila ndikon edhe në disponueshmërinë e financimit të jashtëm, është kryesisht e pandryshuar (44%) ose e përkeqësuar (40%), kurse gjendja specifike e shitjeve dhe fitimeve të vetë ndërmarrjeve është masivisht e pandryshuar (58%) ose e përmirësuar (27%). Në lidhje me financimet, gatishmëria e bankave shikohet gati dhjetëfish më shumë e përmirësuar (32%) sesa aksesi ndaj mbështetjes financiare publike (3%); teksa kjo e fundit vlerësohet gjerësisht si e pandryshuar (62%).[18]

15. World Economic Forum, The Global Competitiveness Report 2019, Fq. xiii, 46-49
16. World Bank Group, Doing Business 2019, Fq.5, 152
17. European Commision, Survey on the Access to Finance of Enterprises (SAFE), November 2019. Gjendet në: https://ec.europa.eu/docsroom/documents/38667
18. Ibid.

Grafiku 8: Ndryshimet në faktorët dhe rrethanat e financimit, prill-shtator 2019



Sipas AmCham dhe Indeksit të Biznesit 2019-2020, ku kanë marrë pjesë 144 ndërmarrje, 66% e tyre vlerësojnë si të paforvshme ose shumë të paforvshme klimën e biznesit në Shqipëri gjatë vitit 2019; çka shënon një rënie me 10.34 pikë në indeksin e "Klimës së Biznesit" krahasuar me vitin 2018.[19]


Nga ana tjetër, edhe pse anëtarët e anketuar të AmCham kanë vazhduar të perceptojnë një rënie në "Performancën e Ekonomisë Shqiptare" (-6.32), gjatë vitit 2019 shumica e tyre mbajtën të pandryshuar ose rritën investimet (respektivisht 45% dhe 32%) dhe punësimin (respektivisht 48% dhe 30%). [20]

Për 38% të këtyre ndërmarrjeve ishte akoma e vështirë të financonin aktivitetin gjatë vitit 2019, duke cilësuar gjithashtu se "Politikat dhe Shërbimet Bankare" ishin të pafavorshme (35%).[21]

Sipas studimit të KE-s, rezulton se problemet kryesore që kanë hasur ndërmarrjet e vogla e të mesme shqiptare, pra me më pak se 250 punonjës, gjatë periudhës prill-shtator 2019 janë pikërisht disponueshmëria e stafit të specializuar ose menaxherëve me përvojë (18%), konkurrenca (16%), gjetja e klientëve (12%) dhe legjislacioni (12%).

19. AmCham, Indeksin e Biznesit 2019-2020, Fq.15
20. Ibid., Fq.42-44
21. Ibid., Fq.6, 46-48

Grafiku 9: Problemet kryesore për NVM-t, prill-shtator 2019




Në të njëjtën linjë, edhe AmCham në Indeksin e Biznesit 2019-2020 cilëson se gjetja e personelit të kualifikuar në vend gjatë vitit 2019 është raportuar të jetë e vështirë ose shumë e vështirë për shumicën e kompanive (74%), duke u renditur si shqetësimi i tretë më i rëndësishëm për anëtarët e Amcham gjatë vitit 2019. Ky indeks ka rënie të vazhdueshme për të gjashtin vit radhazi.[22]

Grafiku i mëposhtëm tregon ndryshimin e disa treguesve të biznesit sipas NVM shqiptare, pra me më pak se 250 punonjës, gjatë periudhës prill – shtator 2019. Sikurse vihet re, më shumë se gjysma e ndërmarrjeve shqiptare deklarojnë se u janë shtuar kostot e krahut të punës, përfshi këtu kontributet shoqërore (54%), ndonëse vetëm 24% kanë shtuar personel. Gjithashtu, 53% raportojnë se u janë shtuar kostot e tjera si materialet, energjia etj. Ndërkohë që xhiroja ka qëndruar kryesisht e pandryshuar për shumë prej tyre (42%) ose është rritur (22%), gjysma e ndërmarrjeve shqiptare (50%) deklarojnë se kanë pasur ulje të fitimit neto.[23]

22. AmCham, Indeksin e Biznesit 2019-2020, Fq.49


23. European Commision, Survey on the Access to Finance of Enterprises (SAFE), November 2019. Gjendet në: https://ec.europa.eu/docsroom/documents/38667

Grafiku 10: Ndryshimet në treguesit e biznesit në Shqipëri, prill – shtator 2019



Të pyetur mbi nevojat për financim, disa ndërmarrje kanë cilësuar se kreditë bankare nuk janë të përshtatshme për to (nuk i kanë përdorur në të kaluarën ose nuk kanë ndër mend t'i përdorin në të ardhmen), respektivisht 29% e NVM-ve shqiptare përkundrejt 52% e NVM-ve në BE. Si arsye kryesore për këtë, shumica (76%) e ndërmarrjeve të 28-es së BE-s listojnë mungesën e nevojës për një kredi të tillë, kurse në Shqipëri kjo është arsye për 39% të NVM-ve. Pengesa kryesore për NVM-të shqiptare janë normat e larta të interesit, siç deklarojnë 50% e kompanive që e cilësojnë kredinë bankare si të papërshtatshme.

Grafiku 11: Arsyeja kryesore përse kreditë bankare nuk janë të përshtatshme




**Baza e vogël (30-49 raste), ndaj rezultatet konsiderohen si indikativë.*

24. European Commision, Survey on the Access to Finance of Enterprises (SAFE), November 2019

Shumica e NVM-ve shqiptare (68%) deklarojnë rritje të xhiros vjetore gjatë viteve 2016-2018, ku më së shumti (39%) kanë pasur një rritje të moderuar, pra me më pak se 20% të xhiros dhe 29% kanë pasur rritje të ndjeshme, pra me mbi 20% të xhiros. Gjithashtu vihet re një frymë optimiste në vlerësimin e tyre për xhiron vjetore për 2019-2021, ku 67% presin sërish rritje, më së shumti rritje të moderuar (44%) dhe më pak ndërmarrje presin rritje të ndjeshme të xhiros vjetore (23%); por duhet konsideruar që këto vlerësime janë bërë përpara tërmetit të 26 nëntorit 2019.[25]

Grafiku 12: Rritja e ndërmarrjeve sipas qarkullimit vjetor 2016-2018 vs. pritshmërive për rritjen e këtij qarkullimi gjatë periudhës 2019-2021



Problematikat e sipërmarrjes së grave

Bizneset në pronësi të grave në të gjithë botën mendohet se përfshijnë midis një të katërtës dhe një të tretës së të gjitha ndërmarrjeve (rreth 25% - 33%), një vlerësim i cili sigurisht është i nënvlerësuar sepse të dhënat në dispozicion nuk dallojnë gjithmonë gjininë e pronarit apo administratorit dhe sepse gratë kanë më shumë të ngjarë të drejtojnë biznese informale, sektor ku të dhënat janë të vështira për t'u mbledhur.[26]

Shumë nga çështjet me të cilat përballen gratë sipërmarrëse janë të njëjta me ato të çdo biznesi të ri (startup). Cilësitë dhe aftësitë e rëndësishme për të arritur suksesin janë të ngjashme dhe të pandikuara nga gjinia, si p.sh.: aftësia e menaxhimit, njohuritë financiare, krijimtaria, dinamizmi, vetëbesimi dhe gatishmëria për të ndërmarrë risqe. Por, në përgjithësi, shumë karakteristika të grave sipërmarrëse dhe të ndërmarrjeve të tyre ndryshojnë nga ato të burrave, dhe për këtë arsye kërkojnë politika ndërhyrëse të veçanta. Këto janë të rëndësishme, jo vetëm për arsye të barazisë gjinore, por sepse sipërmarrja private ka një efekt pozitiv tek zhvillimi dhe rritja e vendeve të punës si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në zhvillim.[27]

25. European Commision, Survey on the Access to Finance of Enterprises (SAFE), November 2019

26. BIAC & Deloitte, Putting all our ideas to work: Women and Entrepreneurship, 2015, Fq.8

27. Ibid., Fq.10

Faktorët që diferencojnë sipërmarrjen e grave janë disa, si më poshtë:[28]

- Bizneset e udhëhequra nga gratë kanë tendencë të përqendrohen në sektorë më pak tërheqës për investitorët. Bizneset e grave zakonisht janë në sektorë si: moda, shitja me pakicë, shërbime familjare, arsimi dhe kujdesi shëndetësor.
- Gratë sipërmarrëse zakonisht fillojnë me më pak kapital dhe më pak borxh të jashtëm sesa burrat dhe kanë më shumë të ngjarë të marrin kredi personale ose të përdorin paratë e familjes. Mesatarisht, një e treta e burrave të vetëpunësuar kanë edhe të punësuar të tjerë, ndërsa ky është rasti vetëm për një të pestën e grave të vetëpunësuara. Cilado qoftë arsyeja, bizneset e grave priren të jenë më të vogla sesa ato të burrave, si në aspektin e numrit të punonjësve, ashtu edhe për sa i përket pranisë dhe vlerës së pasurive ose aseteve fikse.
- Gratë fillojnë bizneset e tyre më vonë në jetë. Kjo ndodh pjesërisht sepse gratë kanë tendencë të zgjedhin më shumë ekuilibrin midis punës dhe jetës për shkak të përgjegjësive familjare. Edhe pasi ngrenë biznesin e tyre, ato kanë tendencë të punojnë më pak pikërisht për të njëjtën arsye. Sipas OECD-s, 22% e grave të vetëpunësuara punojnë më pak se 40 orë në javë, përkundrejt 10% e burrave të vetëpunësuar.
- Këto gra sipërmarrëse kanë tendencë të jenë të mirë-arsimuara. Sipas OECD-s, mesatarisht në vendet e kësaj organizate, 33% e grave të vetëpunësuara dhe 27% e burrave të vetëpunësuar kanë një diplomë të arsimit terciar (diplomë universitare, ekuivalente ose më lartë).

Gratë përballen me më shumë vështirësi sesa burrat kur krijojnë dhe drejtojnë një biznes, kryesisht në qasjen në financa, trajnime, rrjetëzim (networking) dhe në balancën biznes – familje.[29]

Kur u kërkohet të identifikojnë pengesën më të madhe për themelimin dhe rritjen e biznesit të tyre, gratë sipërmarrëse në të gjithë botën përmendin pengesat për të pasur akses në financim. Ky është një shqetësim i zakonshëm për të gjithë sipërmarrësit, por siç vëren OECD-ja, gratë priren të përballen me pengesa më të larta në këtë drejtim, përkundër fakteve që ato kanë të dhëna më të mira të ripagimit të huasë sesa burrat.

Qasja e pabarabartë në financa prodhon rezultate të ndryshme. Këto pabarazi janë rezultat i ndërveprimit kompleks të faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu mënyrën e funksionimit të institucioneve financiare, normave shoqërore, mentalitetin aktual dhe paragjykimet e (pa)vetëdijshme të investitorëve meshkuj që kanë tendencë të investojnë tek bizneset e burrave, sikurse edhe duke përfshirë nivelin e besimit dhe veprimeve të vetë grave.

28. BIAC & Deloitte, Putting all our ideas to work: Women and Entrepreneurship, 2015, Fq.10
29. European Commission, Entrepreneurship 2020 Action Plan: Reigniting the entrepreneurial spirit in Europe, Fq.22. Gjendet në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52012DC0795&from=EN

Kryesisht, si rezultat i normave kulturore e shoqërore dhe praktikave të biznesit, financimi i kapitalit privat përfshin përdorim të gjerë të ndërmjetësve. Nëse ndërmjetësuesit nuk sjellin investitorë në bizneset e udhëhequra nga gratë, biznesi i udhëhequr nga gratë do të mbetet i përjashtuar nga konsiderata e investitorëve potencialë. Kjo është arsyeja pse rrjetet janë të rëndësishme, ndërkohë që nga ana tjetër, gratë kanë tendencë të mos integrohen mjaftueshëm brenda rrjeteve të investitorëve ku mbizotërojnë meshkujt.[30]

Nga hulumtimi i publikimeve online të autoriteteve shtetërore e organizatave të ndryshme, rezulton se nuk ka studime të mirëfillta dhe të detajuara të cilat fokusohen specifikisht te gratë sipërmarrëse në Shqipëri, problematikat që ato hasin dhe nevojat që kanë për mbështetje.

Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në komunikimin me shoqatën "Together for Life" (korrik 2020), një nga problemet e hasura më shpesh nga AIDA gjatë komunikimit me gratë sipërmarrëse ka qenë mungesa e aksesit në financa, e cila pasqyrohet më tej në mundësitë për rritje të biznesit të tyre dhe në eksplorimin e tregjeve të reja.[31]

Gjatë periudhës shtator 2019 – shkurt 2020, shoqata e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare (SHGPAZ) kreu një sërë aktivitetesh dhe një vrojtim me 181 gra sipërmarrëse në 9 qytete të vendit, i cili konkludoi në një raport "Programet e BE-së dhe kombëtare për sipërmarrjen dhe pengesat e grave sipërmarrëse për të bërë biznes në Shqipëri", publikuar në prill 2020.[32] Sipas këtij vrojtimi, dy problemet kryesore me të cilat ato hasen më shpesh / janë më të rëndësishme kur ato bëjnë biznes, janë niveli i lartë i taksave (mbi 60%) dhe konkurrenca e pandershme (mbi 58%). Më pas renditen mungesa në financim (42%), problemet me korrupsionin dhe çmimi i lartë të energjisë (rreth 40%), ndryshimet e shpeshta legjislative fiskale (24%) dhe kontrollet e shpeshta të tatimorëve (22%). Më pak problematike vlerësohet infrastruktura e dobët, nga 10% e grave sipërmarrëse.[33]

Raporti i SHGPAZ "Vlerësim i mjedisit për sipërmarrjen femërore në Shqipëri" (2013) rendit një sërë faktorësh që ndikojnë kontekstin mjedisor për fillimin ose zhvillimin e bizneseve të grave:[34]

- Mjedisi rregullator në Shqipëri, i përmirësuar me përshtatjen dhe përafrimin e ligjeve me direktivat e BE-së, nuk i kushton asnjë vëmendje të veçantë grave në biznes;
- Nuk ka programe të promovimit të sipërmarrjes të fokusuara tek gratë në përgjithësi apo grupime të veçanta, si gratë me aftësi të kufizuara, vajzat e reja etj.
- Gratë përballen me kufizime, sidomos kur përpiqen për mobilizimin e kapitalit për të zgjeruar ose diversifikuar biznesin e tyre, edhe pse sa kanë të drejta të barabarta në lidhje me kreditimin e tyre nga institucionet financiare;

30. BIAC & Deloitte, Putting all our ideas to work: Women and Entrepreneurship, 2015, Fq.11-12
31. MFE. Kthim përgjigje ndaj kërkesës së shoqatës Together for Life me nr. Prot.11150/1, dt. 27.07.2020
32. Gjendet në: https://shgpaz.al/pdf/Studimi_Programet_e_BE.pdf
33. SHGPAZ. Programet e BE-së dhe kombëtare për sipërmarrjen dhe pengesat e grave sipërmarrëse për të bërë biznes në Shqipëri, Prill 2020. Fq.23
34. Gjendet në: https://www.shgpaz.al/pdf/ilo_report_shqip.pdf

- Qasje e kufizuar e grave në shërbimet për zhvillimin e sipërmarrjes, ndonëse shumica e ofruesve të këtyre shërbimeve janë në pronësi të qeverisë apo përfaqësohen si përpjekje të përbashkëta me kompani konsulente private (të vendosur kryesisht në zonat urbane);
- Nuk ka shoqata të grave punëdhënëse, përveç SHGPAZ; ato janë të integruara në Dhomat e Tregtisë. Ndërkohë, krijimi i shoqatave të grave afariste është identifikuar si një nevojë për të promovuar sipërmarrjet e grave dhe të ofrojë mbështetje biznesi nga vetë ato;
- Nuk ka mbështetje shtetërore për një pjesëmarrje cilësore e efektive të grave sipërmarrëse në tregjet vendore, ndër/kombëtare dhe për pjesëmarrje në ekspozita në këto nivele;
- Ka të dhëna të kufizuara rreth sipërmarrjes së grave në Shqipëri. Të dhënat e INSTAT-it ilustrojnë një raport indeksi gjinor, por jo të dhëna më të detajuara.

Një pjesë e tyre janë të reflektuara në strategjitë e qeverisë për barazinë gjinore dhe zhvillimin e biznesit për periudhën 2014-2020.

Problematikat e sipërmarrjes së grave në Shqipëri dhe mbështetja qeveritare

Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE) është institucioni qendror kryesor përgjegjës për hartimin e politikave makroekonomike dhe fiskale, me qëllim arritjen e stabilitetit ekonomik, nëpërmjet drejtimit me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

Një nga detyrat e kësaj Ministrie është mbështetja për krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet sigurimit të programeve apo projekteve të ndryshme të mbështetjes financiare, zhvillimit e zbatimit të programeve / projekteve të asistencës teknike, përmirësimit të vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe investimeve, reduktimi i barrierave administrative dhe kostos së biznesit, bazuar në ligjin nr. 8957/2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", i ndryshuar dhe në Strategjinë për Zhvillimin e Investimeve dhe Biznesit (SZHBI) 2014-2020. Kjo strategji (SZHBI) përbën dokumentin bazë për zbatimin e politikave kombëtare për nxitjen e biznesit dhe investimeve, dhe ka si mision kryesor rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë. Një prej shtyllave është pikërisht Shqipëria si një vend që stimulon zhvillimin e sipërmarrjes dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM).

Sipas analizës SWOT mbi NVM-të, në strategji renditen disa pika të dobëta, si askesin e kufizuar të tyre në financim, informaliteti në ekonomi, mangësi në ofrimin e shërbimeve për biznesin, si dhe mungesa e programeve gjinore e mbështetëse për gratë. Gjithashtu paraqiten disa rreziqe për NVM-të, si ndryshimet e vazhdueshme në legjislacionin e taksave, moszbatimi i ligjit, mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara, stereotipat gjinore e profesionale gjinore, si dhe numri i vogël i grave në pozita udhëheqëse. . Ndërkohë që nxitja e sipërmarrjes femërore paraqitet si sfidë, duke theksuar mungesën e politikave për mbështetjen e tyre.[35]

35. Fletore Zyrtare Nr.157, viti 2014. SZHBI 2014-2020. Fq. 8053-5

Zhvillimi i NVM-ve dhe sipërmarrjes do të shoqërohet me futjen e instrumenteve të reja financiare për të gjitha NVM-të, dhe, në veçanti, në mbështetjen e atyre bizneseve që drejtohen nga femra apo që janë në fazën fillestare të tyre (startup).[36]

Ndër të tjera, strategjia synon rritjen e pjesëmarrjes së grave që drejtojnë biznese. Më specifikisht, synohet që deri në fund të vitit 2020 të arrihet shifra 35% gra sipërmarrëse, 35% gra të vetëpunësuara dhe 35% disbursim kredish për sipërmarrjet femërore. Masat që parashikon kjo strategji për t'u ndërmarrë e për të arritur këto synime janë disa, si më poshtë vijon:[37]

- Ndërmarrja e një anketimi në vend për të siguruar të dhëna të sakta mbi sipërmarrjen femërore, si: numrin, madhësinë, vendndodhjen gjeografike, sektorët, problematika që hasin gratë dhe nevojat që kanë. Dhe mbi bazën këtij studimi të hartohet një program mbështetës për të rritur pjesëmarrjen e grave sipërmarrëse në biznes;
- Krijimi i bazës së të dhënave mbi perfomancën ekonomike të grave në biznes;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi përfitimet nga programet e BE-së a) për të rritur numrin e grave ambasadore e mentore, dhe b) për t'u bërë pjesë e rrjetit në nivel rajonal e evropian;
- Hartimi i një dokumenti politikash për sipërmarrjen e grave, plan veprimi dhe buxhet;
- Zbatimi i politikave adekuate për gratë në biznes, duke i shoqëruar me programe mbështetëse financiare, si: skema grante për fillimin e biznesit dhe për fuqizimin e tyre, skema mbështetëse për të rritur aksesin në financë të femrave sipërmarrëse, krijimi e mbështetja e rrjetit kombëtar për gratë sipërmarrëse.

Fondi i parashikuar për të mbështetur gratë në biznes përgjatë viteve 2014-2020 është 83 milionë lekë, i gjithi nga buxheti i shtetit.[38] Ndërkohë që si tregues suksesi është listuar krijimi i programit për mbështetjen e 100 bizneseve të udhëhequra nga gratë përmes kredive me interesa të ulëta.[39]

Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) dhe Plan Veprimi 2016-2020[40] parashtron disa synime strategjike e aktivitete, duke synuar pikërisht rritjen e përfshirjes së grave në sipërmarrjen private dhe lehtësimin e problematikave që ato hasin.

Më konkretisht, Qëllimi Strategjik 1 "Fuqizimi ekonomik i grave e burrave" ka katër objektiva:[41]

- Objektivi 1.1: Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe reduktimi i hendekut gjinor.

36. Ibid., Fq. 8069
37. Ibid., Fq. 8074-8076
38. Fletore Zyrtare Nr.157, viti 2014. SZHBI 2014-2020. Fq.8091-2
39. Ibid., Fq. 8094
40. Gjendet në: https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf
41. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020, Fq. 22

- Objektivi 1.2: Reduktimi i punës së papaguar të grave në familje, duke rritur aksesin dhe cilësinë tek shërbimet sociale.
- Objektivi 1.3: Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale.
- Objektivi 1.4: Reduktimi i varfërisë së grave dhe vajzave.

Për secilin qëllim e objektiv ka disa aktivitete të parashikuara dhe rezultate të pritshme, si dhe është përcaktuar buxheti i nevojshëm për to, pjesërisht i mbuluar nga qeveria shqiptare dhe pjesërisht nga donatorët. Buxhetin më të madh e kërkon pikërisht qëllimi strategjik 1 "*Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave*" me 57.2% të shpenzimeve totale. Më specifikisht, janë dy objektivat e qëllimit strategjik 1 të cilat kërkojnë 52.6% të shpenzimeve të të gjithë buxhetit (ose 92% të buxhetit të planifikuar për qëllimin strategjik 1). Respektivisht, objektivi 1.2 me 26.4% të totalit të shpenzimeve dhe objektivi 1.3 me 26.2% të shpenzimeve totale. Ndërkohë tabela 3, paraqet hendekun financiar sipas qëllimeve strategjike dhe objektivave specifikë. Hendeku më i madh në qëllimin strategjik 1 është pikërisht objektivi 1.3 "*Fuqizimi ekonomik i grave ne zonat rurale*", ku mungon gati 28% e shumës së nevojshme për zbatim.[42]

Tabela 3. Hendeku financiar sipas qëllimit strategjik dhe objektivave, SKBGJ 2016-2020

	Objektivi 1	Objektivi 2	Objektivi 3	Objektivi 4	Totali
Qëllimi I	3.10%	2.59%	27.95%	0.03%	33.67%
Qëllimi II	0.57%	1.35%			1.92%
Qëllimi III	7.04%	53.31%	3.63%		63.98%
Qëllimi IV	0.03%	0.02%	0.00%	0.40%	0.45%

SKBGJ 2016-2020 ka përcaktuar një sërë treguesish gjinor për çdo qëllim e objektiv bashkë me institucionin përgjegjës, ndër të cilat më relevante për gratë sipërmarrëse janë si më poshtë:[43]

- Teksa në vitin 2014 përqindja e bizneseve në pronësi ose me administratore gra ishte 31%, SKBGJ 2016-2020 synon që kjo përqindje të rritet në 32.5% në 2017 dhe 34.5% në 2020.
- Ndërkohë që në vitin 2015 përqindja e grave përfituese të fondeve të AIDA-s ishin vetëm 3.3%, SKBGJ 2016-2020 synon që kjo përqindje të dyfishohet (6.9%) në vitin 2017, por është e papërcaktuar rritja e pritshme për vitin 2020.
- Teksa në vitin 2015 përqindja e grave përfituese të shërbimeve të ekstensionit ishte 10%,

42. Ibid., Fq. 27-28, 30-31
43. Ibid., Fq. 41-42

SKBGJ 2016-2020 synon që kjo përqindje të rritet në 13% në 2017 dhe 15% në 2020.


- Ndërkohë që në vitin 2015 përqindja e grave fermere përfituese të fondeve në skemat e subvencionit ishte 10%, SKBGJ 2016-2020 synon që kjo përqindje të rritet në 11% në 2018.

Detyrën e saj për të mbështetur krijimin dhe zhvillimin e NVM-ve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e realizon edhe nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Me qëllim rritjen e konkurueshmërisë së NVM-ve, forcimin e kapaciteteve prodhuese dhe daljen e tyre në treg, AIDA menaxhon disa skema financiare nga buxheti i shtetit, si Fondi i Konkurrueshmërisë, Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanatit), Fondi Start-up dhe Fondi i Inovacionit.[44]

Të dhënat nga INSTAT[45] tregojnë për një numër tejet të kufizuar përfituesish nga këto skemat mbështetëse. Gjatë vitit 2019 kanë përfituar 94 sipërmarrës (0.06% e ndërmarrjeve aktive), ndonëse është dyfishuar nga viti i kaluar në total dhe për secilën gjini. Numri i përfituesve në 2019 vazhdon të mbetet më i ulët për gratë (43.6%) sesa për burrat (56.4%), me një diferencë prej 12.8 pikë përqindje. Numri i përfituesve është i kufizuar, ndaj rezultatet gjinore për secilën skemë janë indikative. Gjithsesi vihet re se ka më shumë gra se burra përfitues nga Fondi i Ekonomisë Kreative e Fondi i Start-up, por ka më shumë burra se gra përfituese nga Fondi i Inovacionit e Fondi i Konkurrueshmërisë. Në total, ndër vite (2015-2019) kanë përfituar fonde nga AIDA 118 biznese të drejtuara nga gratë përkundrejt 184 biznese të drejtuara nga burrat. Pra, 39% e këtyre ndërmarrjeve përfituese kanë qenë të drejtuara nga gratë dhe 61% nga burrat.

Grafiku 13. Përfitues të skemave mbështetëse nga AIDA, në total dhe sipas gjinisë 2019

Viti / Year	Numër-Number		%	
	Burra / Men	Gra / Women	Burra / Men	Gra / Women
2015	39	9	81,3	18,8
2016	49	36	57,6	42,4
2017	17	10	63,0	37,0
2018	26	22	54,0	46,0
2019	53	41	56,4	43,6



44. Gjendet në: http://aida.gov.al/fondet-e-aida-s/
45. INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2020, Fq.131

Sipas MFE,[46] përqindja më e madhe e përfitueseve femra nga grantet që AIDA ofron është në qytetin e Tiranës (40%), pasuar nga Shkodra (16%),Durrësi e Fieri (6% secili). Nga gjithë fondet e AIDA-s, një fond që është pothuajse i dedikuar grave sipërmarrëse është fondi i Ekonomisë Kreative (artizanatit). Për periudhën 2014-2019, nga 85 përfitues gjithsejnga ky fond, 59 kanë qenë femra, ose, e thënë ndryshe, gati 70% e tyre.

SHGPAZ në vrojtimin e fundit pasqyron një sërë programesh kombëtare dhe të BE-së të cilat ofrojnë mbështetje ndaj sipërmarrjes private në përgjithësi dhe grave sipërmarrëse në veçanti, si Programi IPARD, Programi për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (Kredi për NVM, Kredi për projektet e vogla, Fondi shqiptar i garancisë për NVM-të), Programi Gratë në Biznes, Projekti IDEA, disa Fonde për Startup nga Yunus, AIDA e Bashkia Tiranë, dhe tri fonde nga AIDA: Fondi i Ekonomisë Kreative, Fondi për Inovacionin dhe Fondi për Konkurrueshmërinë.[47]

E megjithatë, vrojtimi konkludon se rreth 90% e grave sipërmarrëse që morën pjesë nuk kanë përfituar asnjë grant. Kjo përqindje e lartë tregon mungesë njohurie mbi ekzistencën e këtyre programeve mbështetëse, si edhe për numrin e pakët të skemave e granteve mbështetëse. Ato pak raste kishin përfituar nga fondet e AIDA, IPA, GIZ, IDEA dhe Bashkisë së Tiranës. Përfitimi i granteve ka rezultuar në korrelacion të drejtë me vitet e biznesit në treg.[48]

MFE cilëson Programin e Vetëpunësimit, financuar nga Qeveria Zvicerane dhe zbatuar nga PNUD, si një formë mbështetje nëpërmjet promovimit të vetëpunësimit, trajnimeve dhe suportit te drejtpërdrejtë për krijimin e bizneseve të reja. Dy raundet e para kanë rezultuar në regjistrimin e 84 bizneseve te reja, nga të cilat 76 ende plotësisht aktive. Thirrja e tretë (2018-2019) u prezantua në qytetin e Tiranës dhe nga 313 aplikime 45 fituan të drejtën për të përfituar grantin, por 43 u regjistruan si biznese pranë QKB. Ndërkohë nuk ka të dhëna sipas gjinisë.[49]

MFE cilëson gjithashtu mbështetjen që institucionet publike ofrojnë për rritje kapacitetesh në fushën e menaxhimit të bizneseve, veçanërisht të sektorit të hoteleri-turizëm, nëpërmjet ofrimit të kurseve profesionale në 6 qendrat e formimit profesional publik në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Gjirokastër. Sipas të dhënave statistikore të 3-mujorit të parë të vitit 2020 dhe të të mbarturave të vitit 2019, rezulton se ka gjithsej 78 kursantë të regjistruar, nga të cilët gjysma janë femra (39 kursante). Janë certifikuar gjithsej 17 kursantë, ndërkohë që 61 janë ende në proces.[50]

46. MFE. Kthim përgjigje ndaj kërkesës së shoqatës Together for Life me nr. Prot.11150/1, dt. 27.07.2020
47. SHGPAZ. Programet e BE-së dhe kombëtare për sipërmarrjen dhe pengesat e grave sipërmarrëse për të bërë biznes në Shqipëri, Prill 2020. Fq.7-15
48. Ibid., Fq.19-20
49. MFE. Kthim përgjigje ndaj kërkesës së shoqatës Together for Life me nr. Prot.11150/1, dt. 27.07.2020
50. Ibid.

SHGPAZ në një vrojtim "Njohja e programeve të BE-së dhe kombëtare për sipërmarrjen nga studentët dhe nxënësit në Shqipëri" (dhjetor 2019) me 309 nxënës të shkollave të mesme (46% e kampitonit) dhe studentë universiteti (50% e kampionit), evidenton se programet kombëtare për mbështetjen e të rinjve janë më të pakta në numër se ato të BE-së dhe njihen akoma më pak. Si pasojë e mungesës së informacionit dhe nivelit të ulët të inisiativës për të bërë biznes, numri i përfituesve të granteve është i kufizuar (7% e pjesëmarrësve ose familjarëve të tyre kishin përfituar ndonjë grant). Edhe stafi pedagogjik (ndonëse i kufizuar, vetëm 4% e kampionit) nuk kishte njohuri më të mira në këtë aspekt. [51]

1.4 Tërmetet e vjeshtës 2019 në Shqipëri dhe pasojat në sektorin privat

Tërmetet e vjeshtës 2019 dhe ndikimi në sipërmarrjen private

Në shtator dhe nëntor 2019 Shqipëria u përfshi nga një seri tërmetesh, të cilat shkaktuan dëme në godina e jetë njerëzish dhe detyroi popullsinë e disa zonave të shpërngulej, si dhe shkaktoi dëme e pasoja edhe në sektorin privat.

Tërmeti i 21 shtatorit 2019 fatmirësisht nuk pati humbje jetësh, por pati mbi 150 persona të lënduar dhe dëme të konsiderueshme në mbi 1500 objekte, kryesisht banesa, rreth 160 pallate, mbi 30 shkolla dhe 13 universitetete, kryesisht në qarqet e Durrësit dhe Tiranës.[52] [53]

Tërmeti i 26 nëntorit 2019 që goditi Shqipërinë shkaktoi 51 humbje jetësh, më shumë se 900 të plagosur, rreth 17 mijë qytetetarë të zhvendosur përkohësisht, ndërsa preku më shumë se 200 mijë persona (47,263 në mënyrë direkte dhe 155,029 në mënyrë indirekte) në 11 bashki: Durrës, Shijak, Krujë, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Lezhë, Kurbin e Mirditë. Mijëra ndërtesa u shkatërruan dhe u dëmtuan rëndë, përfshi infrastrukturën publike dhe private, shtëpi, shkolla dhe struktura të kujdesit shëndetësor. Ndikimi i përgjithshëm i katastrofës në 11 bashkitë e prekura arrin në mbi 980 milionë euro dhe do të duhen afro 1,08 miliardë euro për rimëkëmbje në të gjithë sektorët. Shumica e dëmeve të regjistruara janë në sektorin e banesave, ndjekur nga sektori prodhues, si biznesi, turizmi, bujqësia, trashëgimia kulturore dhe sektori arsimor.[54]


Dëmet në kapitalin fizik dhe humbjet nga ky tërmet vlerësohet të jenë sa ekuivalenti i rreth 7.5% të Produktit të Brendshëm Bruto (6.4% të PBB në dëme dhe 1.1% të PBB në humbje).

51. Gjendet në: https://www.shgpaz.al/sq/te-reja/214-studimi-njohja-e-programeve-te-be-se-dhe-kombetare-per-sipermarrjen-nga-studentet-dhe-nxenesit-ne-shqiperi
52. https://www.mod.gov.al/index.php/newsroom-2/fjalime-te-ministrit/3985-fjala-e-ministres-se-mbrojtjes-olta-xhacka-ne-seance-plenare-te-kuvendit-te-shqiperise
53. https://www.monitor.al/pas-termeti-kerkohet-me-urgjence-vleresimi-sizmik-i-digave-shkollave-spitaleve/
54. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/sq/IP_20_249

Dëmet arritën në 26.4% të formimit të kapitalit fiks bruto të vitit 2018. Dëmet më të rënda ishin në turizëm dhe godinat e banimit, por dëmtime pësuan dhe ndërtesat që lidhen me arsimin, shëndetësinë dhe infrastrukturën tjetër publike, prodhimin dhe tregtinë. Kur ky tërmet destabilizoi PBB-ë e tremujorit të katërt, si konsumi ashtu edhe investimi u tkurrën në mënyrë dramatike.[55]

Më konkretisht, sipas raportit "Shqipëria: Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë",[56] rezulton se 86% janë dëme dhe 14% janë humbje nga totali prej 985.07 milionë euro. Nga ana tjetër, 86% e dëmeve e humbjeve janë private vs. 14% publike. Dëmet e përllogaritura për prodhimin (biznesin dhe punësimin, bujqësinë, turizmin dhe trashëgiminë kulturore që është përfshirë në këtë sektor sipas metodologjisë së këtij vlerësimi, pasi është një burim kryesor i të ardhurave për qeverinë) shkojnë në vlerën 70.82 milionë euro, kurse humbjet respektive në 79.66 milionë euro, pra gjithsej 150.48 milionë euro ose ndryshe 15.7% e vlerës totale të pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore.

Grafiku 14: Dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga tërmeti 26.11.2019 sipas sektorëve



Nënsektori i turizmit pësoi më shumë dëme dhe humbje, me 90.24 milionë euro, shumica e të cilave janë për shkak të humbjeve nga rënia e pritshme e vizitorëve të huaj midis 2020-2022. Nënsektori i biznesit e punësimit është i dyti me i prekur, në vlerën 52.95 milionë euro, në dëme e humbje, shumicapër shkak të dëmit të pësuar nga 714 biznese në prodhim dhe tregti.[57]

55. http://pubdocs.worldbank.org/en/764381588143421027/RER17-Albania-Country-Note-ALB.pdf
56. Shqipëria: Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë, Prezantimi Shkurt 2020
57. Shqipëria: Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë, Raporti Volumi B, Shkurt 2020, Fq. 46

Tabela 4: Dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga tërmeti 26.11.2019 për nën-sektorët e prodhimit

Nën-sektorë	Dëme		Humbje		Total	
	Milion Eur	Milion Lek	Milion Eur	Milion Lek	Milion Eur	Miliard Lek
Biznesi dhe Punësimi	47.48	5,842.41	5.46	671.85	52.95	6.5
Turizmi	16.71	2,056.17	73.53	9,047.87	90.24	11.1
Trashëgimia kulturore	5.31	653.40	0.44	54.14	5.75	0.7
Bujqësia	1.3	159.97	0.22	27.07	1.54	0.2
Total milion Eur	**70.8**		**79.65**		**150.48**	
Total miliard Lek		**8.7**		**9.8**		**18.5**

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të dëmeve dhe humbjeve në sektorin e prodhimit, bashkia e Durrësit është më e prekura, me një total prej gati 64,97 milionë euro ose 43% të totalit. Bashkia e dytë më e prekur është Kavaja, me 37.77 milion euro ose 25%, e pasuar në vendin e tretë nga Tirana, me gati 21.89 milionë euro ose 15% të totalit. Më specifikisht, bashkia e Durrësit është më e prekur se gjithë bashkitë e tjera në nënsektorin e biznesit dhe punësimit (27.2 milion euro). Në mënyrë gati ekuivalente me bashkinë e Kavajës, janë dy më të prekurat nga dëmet dhe humbjet në turizëm (mbi 36 milion euro secila). Bashkitë e Durrësit dhe Lezhës janë dy më të prekurat në fushën e bujqësisë (pothuaj të vetmet), me mbi 0.55 milionë euro secila.[58]


Duke u ndalur veçanërisht tek dëmet në biznes, në total janë evidentuar 714 biznese të dëmtuara, nga të cilat 300 biznese në industrinë përpunuese (objekte të mbuluara siç janë njësitë e prodhimit dhe magazinat, të cilat kanë vlera relativisht më të ulëta ndërtimi, por kanë ndërtesa më të mëdha dhe pajisje e makineri më të shtrenjta) dhe 414 biznese në tregti (si dyqane, qendra tregtare, ekspozita, njësi parkimi, njësi shërbime dhe zyra, të cilat janë me madhësi relativisht më të vogla dhe me mobilie e pajisje më pak të shtrenjta). Përmbledhja e dëmit për bizneset sipas llojit të objektit dhe llojit të dëmit pasqyrohet më poshtë:[59]

- 179 biznese janë dëmtuar plotësisht (118 në prodhim dhe 61 në tregti);
- 131 biznese janë dëmtuar pjesërisht (56 në prodhim dhe 75 në tregti);
- 404 biznese kanë pësuar dëmtime të vogla (126 në prodhim dhe 278 në tregti).

58. Ibid., Fq. 47
59. Shqipëria: Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë, Raporti Volumi B, Shkurt 2020, Fq. 49

Dy bashkitë më të goditura në numër biznesesh janë Durrësi dhe Vora, respektivisht me 48% dhe 15.5%, nga totali i 714 bizneseve të dëmtuara, si tregti, industri, prodhim, magazina etj.[60]

Grafiku 15: Shpërndarja e bizneseve të dëmtuara nga tërmeti i 26.11.2019 sipas bashkive



Ndërkohë, nga 60 strukturat akomoduese të dëmtuara në të gjitha këto bashki, pjesa dërrmuese (86.7%) i përkasin bashkisë së Durrësit.[61] Më specifikisht, 18 prej këtyre strukturave akomoduese janë hotele (të gjitha në bashkinë e Durrësit) dhe 42 janë bare e restorante. [62]

Gjithashtu, cilësohet se 438 të punësuar nga 56 biznese në industrinë përpunuese dhe 79 të punësuar nga 124 biznese në tregti humbën përkohësisht punën e tyre.[63]

60. Shqipëria: Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë, Prezantimi Shkurt 2020
61. Ibid.
62. Shqipëria: Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë, Raporti Volumi B, Shkurt 2020, Fq. 56
63. Ibid., Fq. 46

Masat qeveritare në mbështetje të të prekurve nga tërmetet e vjeshtës 2019

Paketa fiskale për procesin e rindërtimit pas efekteve nga tërmetet e vjeshtës 2019 është një përmbledhje e akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim mbështetjen me masa lehtësuese për familjet dhe biznesin e dëmtuar. Këto akte normative u miratuan me procedurë të përshpejtuar në Kuvend në fundvitin 2019, çka vijoi më tej në ditët e fundit të muajit shkurt 2020. [64] [65] [66]

- Akti Normativ Nr. 3, datë 02.10.2019 "Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 'Për sistemin e taksave vendore', të ndryshuar".
- Akti Normativ Nr. 4, datë 30.11.2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".
- Akti Normativ Nr. 5 datë 30.11.2019 "Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 'Për tatimin mbi të ardhurat', të ndryshuar".
- Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
- Udhëzimin Nr. 32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar.
- Vendim Nr. 142, datë 13.2.2020 "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave 'Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, 'Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar".
- Vendim Nr. 143, datë 13.2.2020 "Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit".
- Vendim Nr. 144, datë 13.2.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, 'Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës', të ndryshuar".
- Vendim Nr. 145, datë 13.2.2020 "Për kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, për përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë".

64. Gjendet në: http://financa.gov.al/masat-e-marra/

65. Gjendet në: https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1274/njoftim-per-te-gjithe-tatimpaguesit-te-prekur-nga-termeti-i-dates-26-nentor-2019

66. http://altax.al/images/pdf/PAKETA-FISKALE-2020---PR-RINDRTIMIN-PAS-PASOJAVE-T-TRMETIT-2019.pdf

Specifikisht për bizneset, përfitimet nga kjo paketë janë:

Përjashtimi nga pagesa e TVSH-së e mjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për të rindërtuar zonat e prekura nga fatkeqësitë. Në vendimin e qeverisë, përcaktohen si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja:[67] (i) shërbimet e ndërtimit të furnizuara nga ndërtuesit e autorizuar posaçërisht nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda programit të rindërtimit për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" dhe përgjatë periudhës së rindërtimit; (ii) shërbimet dhe mallrat e furnizuara ndaj ndërtuesve të autorizuar e të përdorura prej tyre për qëllime të proceseve të ndërtimit të përcaktuara si më lartë; (iii) materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore, organizata bamirëse dhe filantropike për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", brenda programit të rindërtimit.

Pra, mund të themi se përfitues direkt të kësaj mase do të jenë ndërtuesit: nëse një objekt apo infrastrukturë do të rindërtohet nga donatorët, kompania ndërtuese që do të kryejë procesin e rindërtimit nuk do të paguajë TVSH-në për mallrat e ndërtimit dhe shërbimet, duke përfshirë edhe importin e materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit.

Të gjithë tatimpaguesve të prekur nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 do t'u njihen si të zbritshëm shpenzimet e kryera për eliminimin e pasojave të tërmetit, si shpenzimet e prishjes së godinave, vlera e mbetur e amortizuar apo çdo proces tjetër që është e lidhur me procesin e rindërtimit. Pra, njihen si shpenzime të zbritshëm edhe: (i) vlera kontabël e mallrave; (ii) vlera kontabël e mbetur e aktiveve që janë dëmtuar/ shkatërruar për shkak të fatkeqësive natyrore në zonat që sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile janë shpallur "zona të fatkeqësisë natyrore".

Udhëzimi i ndryshuar i Ministrisë së Financave për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin te biznesi i vogël, njeh si shpenzime të zbritshëm, vlerën kontabël të mallrave dhe të aktiveve, pra të pronës dhe ndërtesës që janë dëmtuar.[68]

Përjashtim nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve për rindërtimin e subjekteve që aplikojnë për t'u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave për qëllime biznesi, të dëmtuara si pasojë e tërmetit.[69]

Gjithashtu është parashikuar të shfrytëzohen hapësirat ligjore për shtyrjen e pagesave të tatimeve, duke lidhur një marrëveshje midis drejtorisë tatimore dhe subjektit privat për shlyerjen e detyrimit tatimor me këste deri në dy vjet. Këto biznese do të paguajnë fillimisht 20% të detyrimit tatimor, ndërsa 80% i mbetur shtyhet në kohë për një periudhë 2-vjeçare (pra këtyre bizneseve nuk do t'u aplikohen penalitete).[70]
Megjithatë të dhënat zyrtare mbi mbështetjen konkrete të ofruar për bizneset e dëmtuara nga tërmetet e vjeshtës 2019 nuk janë ende të disponueshme.

67. Deloitte.TaxNews Special: Ligji "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", Janar 2020
68. Gjendet në: https://www.monitor.al/detajet-e-paketes-fiskale-per-bizneset-e-demtuara-2/
69. Ibid.
70. Ibid.

1.5 Pandemia COVID-19 dhe pasojat në sektorin privat

Masat qeveritare, dy paketat anti-COVID

Në funksion të kontrollit të situatës së epidemisë nga COVID-19, në Shqipëri janë ndërmarrë një sërë masash me natyrë shtrënguese/kufizuese, të cilat kanë ardhur duke u përshkallëzuar që prej 9 mars 2020. Qeveria shqiptare ka akorduar një shumë prej 45 miliardë lekësh (2.8% të PBB-së) përmes dy paketave mbështetëse për popullsinë dhe sektorin privat të prekur nga pandemia e COVID-19, çka përfshin shpenzime në buxhet, garancitë sovrane dhe shtyrjet e taksave.[71]

Paketa e parë financiare e qeverisë shqiptare "*Mbështetje për Biznesin e Vogël dhe Qytetarët"* në vlerën 6.5 miliardë lekë u komunikua në 19 mars 2020 dhe përmban tri masa, nga të cilat vetëm njëra lidhej me biznesit dhe punonjësit e tyre. Ndihmë financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14,000,000 lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik për shkak të gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Paga e luftës në vlerën 26 mijë lekë në muaj përfitohet nga personat fizikë të vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes dhe të punësuarit në personat fizikë tregtarë, dhe të punësuarit në personat juridikë.[72]


Paketa e dytë financiare *"Mbështetje për Sipërmarrjen dhe Punëmarrësit"* u komunikua në 13 prill 2020 dhe përmban gjashtë masa, nga të cilat masa 1-5 lidhen me biznesin, si më poshtë:[73]

1. Subvencionim për punonjësit e larguar plus ata aktualë në bizneset me të ardhura 14+ milionë lekë, që janë mbyllur me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
2. Mbështetje për të larguarit nga puna në periudhën 1 mars – 17 maj për të gjitha subjektet e hapura apo të mbyllura nga urdhrat e MSHMS-së;
3. Subvencionim për të gjithë punonjësit e bizneseve me të ardhura nën 14 milionë lekë, përjashtuar 8,000 persona në profesionet e lira, tregtia, farmacitë, përfituesit e pagës së luftës nga Paketa 1 etj;
4. Subvencionimi i pagës së luftës për punonjësit e strukturave akomoduese në sektorin e turizmit;
5. Mbështetje për punonjësit me pagë nën 100 mijë lekë/muaj në Rafinerinë e Ballshit.

Sipas publikimit në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përditësimit deri në datën 24 korrik 2020, rezulton se nga paketa e parë financiare kanë përfituar dhe janë paguar rreth 65 mijë qytetarë në secilin nga kështet 1, 2 dhe 3 (shiko grafikun 16 majtas). Ndërkohë që nga paketa e dytë kanë përfituar e janë paguar në total rreth 172 mijë qytetarë nga të gjitha masat e paketës (shiko grafikun 16 djathtas), ku dominojnë përfituesit nga masa 2 dhe 3 e kësaj pakete.[74]

71. Gjendet në: https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf
72. Gjendet në: http://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/
73. Gjendet në: http://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/
74. Ibid.

Grafiku 16: Përfituesit e pagës së luftës dhe përfituesit e Paketës 2



Deri më datë 3 korrik 2020, rreth 44% e përfituesve të ndihmës së shpërndarë nga qeveria shqiptare përmes paketave financiare ishin gra dhe vajza.[75]

Qeveria shqiptare ka ofruar mbështetje për sektorin privat edhe përmes një instrumenti tjetër financiar, asaj të "Garancisë Sovrane". Këshilli i Ministrave ka miratuar dy instrumente të tillë me një shumë totale prej 26 miliardë lekësh, si më poshtë vijon: [76]


75. Gjendet në: http://financa.gov.al/denaj-qasje-kombetare-per-te-adresuar-nevojat-e-grave-per-punesim-ne-periudhen-e-pandemise/


76. Gjendet në: http://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/

- Garancia Sovrane I në masën 11 miliardë lekë aplikohet nga bizneset e prekur nga situata e COVID-19 në çdo bankë të nivelit të dytë për të paguar pagat e tri muajve të punonjësve; garantohet 100% nga shteti shqiptar dhe po ashtu, interesi subvencionohet nga qeveria shqiptare, me një periudhë pa shlyerje të principalit (grace period) prej 3 muajsh.
- Garancia Sovrane II në masën 15 miliardë lekë aplikohet për bizneset në të gjithë sektorët e ekonomisë për nevoja në kapital qarkullues dhe investime. Është një instrument që ndan riskun me bankat, duke mbuluar një përqindje të principalit të çdo huaje, ka kushte preferenciale financimi dhe afat shlyerje deri 5 vjet, me një periudhë pa shlyerje të principalit (grace period) prej 6 muajsh.

Deri në datën 24 korrik 2020 kanë aplikuar mbi 1,000 biznese për Garanci Sovrane (I dhe II), por në total janë miratuar më pak se 700 biznese (shiko grafikun 17).[77]

Grafiku 17: Përfituesit nga Garancia sovrane I dhe II





Qeveria shqiptare ka aplikuar edhe disa instrumente lehtësuese fiskale për bizneset:[78] [79] [80]

- Lehtësitë për biznesin në shtyrjen e afatit të dorëzimit të bilancit kontabël;
- Bërjen zero të kësteve të parapaguar të tatimit mbi fitimin (TF) për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 milion lekë;
- Shtyrja e afatit të shlyerjes së tatimit mbi fitimin (TF / TFTH) pas shtatorit për të gjitha bizneset që u ndërprenë aktivitetin e tyre për shkak të pandemisë. Sidoqoftë, pagesat e tatimit mbi fitimin (TF / TFTH) shtyhen në vitin e ardhshëm për turizmin, fasonët dhe kompanitë call center, si dhe bizneset e vogla me xhiro vjetore më pak se 14 milion lekë;

77. Gjendet në: http://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/

78. Kuvendi. Raport për projektligjin "Për miratimin e huamarrjes prej 139 300 000 SDR-SH që FMN i akordon Shqipërisë nëpërmjet instrumentit të financimit të shpejtë (RFI)", 26 maj 2020

79. MFE. Kthim përgjigje ndaj kërkesës së shoqatës Together for Life me nr. Prot.11150/1, dt. 27.07.2020

80. Gjendet në: https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania.pdf

- Shtyrjen e detyrimit për pagesën e qirasë për një kategori individësh apo studentët, por edhe një fashë të tatimpaguesve.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë pranon se në hartimin dhe miratimin e masave të ndërmarra në ndihmë të bizneseve të prekura dhe punonjësve të tyre nuk kanë parashikuar ndonjë paketë të veçantë për mbështetjen e bizneseve të drejtuara nga gratë. Megjithatë, thekson se qeveria dhe vetë MFE planifikojnë të rishikojnë skemat ekzistuese të ndihmës për NVM-të që zbatohen nga AIDA dhe të alokojë fonde të reja në kuadër të planifikimit të ri buxhetor 2021-2023. Nisur nga problematikat dhe barriera me të cilat hasen bizneset e drejtuara nga gratë, MFE bën me dije se, në Strategjinë e re të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 do të parashikohet një mbështetje më e madhe për përmirësimin e klimës së biznesit në përgjithësi dhe sipërmarrjes së grave në veçanti. Strategjia, po ashtu, synon të adaptojë masa afatgjata për përballimin e efekteve të krizës COVID-19.[81]

Pandemia COVID-19 dhe ndikimi në ekonominë shqiptare

Qeveria shqiptare shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore në datën 24 mars 2020,[82] kur ishin regjistruar 5 viktima nga 123 persona të prekur nga COVID-19. Izolimi shoqëror dhe masat shtrënguese të përcaktuara nga qeveria detyruan bizneset të mbyllnin dyert, të ndërprisnin prodhimin dhe shitjen apo ofrimin e shërbimeve të tyre në mënyrë masive. Disa patën një pezullim ose mbyllje të përkohshme të biznesit të tyre, të tjerë falimentuan. Bizneseve të çdo forme e madhësie u është dashur të transformojnë mënyrën e punës, prodhimit apo përpunimit, duke e zhvendosur vendin e tyre të punës në mjedise të distancuara apo duke ofruar shërbimet në kanalet digjitale.

Gjatë periudhës kur qeveria shqiptare për të frenuar përhapjen e virusit urdhëroi bllokimin e përkohshëm të aktiviteteve të rëndësishme, si restorantet dhe tregtinë e artikujve jo jetike, kufizoi lëvizjen e njerëzve, aplikoi kufizime të gjera në udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, disa industri të lejuara për të vijuar aktivitetin e tyre, si ato të tekstileve, minierave, ndërtimit dhe qendrave telefonike (call centers), për të respektuar kufizimet, tkurrën aktivitetin e tyre.

Duke konsideruar ndërprerjet e aktiviteteve dhe paqartësinë mbi atë që do të ndodhë, familjet dhe bizneset po shtyjnë kryerjen e shpenzimeve jo jetike. Nga ana tjetër, destabilizimi i rëndë ekonomik i partnerëve kryesorë tregtare, si Italia, çoi në kopals porositë për produktet e eksportit. Ekonomia mund të përballet me goditje të ofertës për shkak të ndërprerjes në zinxhirin global të furnizimit, si dhe një rënie të ofertës së punës për shkak të izolimit dhe distancimit social.

81. MFE. Kthim përgjigje ndaj kërkesës së shoqatës Together for Life me nr. Prot.11150/1, dt. 27.07.2020
82. Fletore Zyrtare, viti 2020, numri 48, fq.3218. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020

Efektet negative në kërkesë mund të shtohen me humbjen e të ardhurave nga punësimi, veçanërisht në sektorët më të prekur si turizmi e hoteleria, prodhimi dhe tregtia e artikujve jo jetike.[83]

Gjatë periudhës 28 mars - 5 maj 2020, Sekretariati i Këshillit të Investimeve zhvilloi anketimin online "Vlerësim i ndikimit të pasojave që rrjedhin nga pandemia e COVID-19 mbi aktivitetin e biznesit në Shqipëri" me 833 kompani nga i gjithë vendi. Rezultatet kryesore të këtij studimi tregojnë se:[84]

- Gati gjysma (47%) e ndërmarrjeve ndaluan plotësisht aktivitetin gjatë COVID-19, ndërsa 53% e tyre vazhduan aktivitetin e tyre pjesërisht (42%) ose plotësisht (11%).
- Të gjithë sektorët e ekonomisë pritet të ndikohen negativisht. Në total 97% e kompanive presin që aktiviteti i tyre të ndikohet shumë negativisht (67%) dhe negativisht (30%) nga përhapja e koronavirusit të ri.
- Pavarësisht nga madhësia apo sektori, të gjitha kompanitë konvergojnë në lidhje me pritshmëritë mbi ndikimin e COVID-19 në xhiron e tyre vjetore. Shumica (80%) presin që të kenë më shumë se 20% rënie të xhiros vjetore.
- Problematikat më të shpeshta të kompanive gjatë COVID-19 janë mungesa e klientëve (24%), mungesa e likuiditetit (17%), vështirësitë në likuidimin e pagave (13%) dhe respektimi i detyrimeve e pagesave tatimore (12%). Disa probleme të tjera janë rritja e kostove (7%), sigurimi i lëndës së parë (6%) dhe ulja e prodhimit (6%).
- Gati gjysma (52%) kanë pasur problem me furnizimin e lëndës së parë nga importet, kryesisht nga vendet e BE-së, dhe pjesa më e madhe e këtyre importuesve (69%) janë dëmtuar seriozisht për shkak të varësisë totale nga importi, si p.sh. industria.
- Gati 1/5 e kompanive (21%) kanë bërë largime të punonjësve nga puna, ku industria dhe turizmi kanë shënuar largimet më të shumta, respektivisht 36% dhe 30%
- Për të siguruar vazhdimësinë e biznesit, kompanitë deklarojnë se kryesisht do të përdorin të ardhurat e mëparshme (34%) dhe do të ulin kostot (32%), ku fokus është shkurtimi i vendeve të punës dhe ulja e prodhimit. Marrja e kredisë bankare konsiderohet si opsioni i tretë.
- Pavarësisht nga madhësia apo sektori, shumica e kompanive vlerësojnë se ndikimi i pandemisë COVID-19 në biznes do të zgjasë deri në 1 vit.

83. Gjendet në: http://pubdocs.worldbank.org/en/764381588143421027/RER17-Albania-Country-Note-ALB.pdf
84. Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Vlerësim i ndikimit të pasojave që rrjedhin nga pandemia e COVID-19 mbi aktivitetin e biznesit në Shqipëri, Qershor 2020

KAPITULLI II

METODOLOGJIA

2.1 Objektivat e studimit

Shoqata "Together for Life" prej dy vitesh organizon panairin "Gratë në biznes", takime ku gratë sipërmarrëse kanë rrëfyer problemet me të cilat përballen dhe faktin që shteti nuk u ofron atyre mbështetje për të ndërtuar ose përmirësuar mikrobizneset e tyre, ndaj edhe zhvillimi i tyre i qëndrueshëm është i vështirë dhe i ngadaltë. Si rrjedhim, shoqata "Together for Life" ndërmori këtë projekt studimor, i cili kishte tre objektiva kryesorë:

• Të kuptojë klimën e përgjithshme dhe vështirësitë me të cilat përballen gratë sipërmarrëse në Shqipëri në përditshmërinë e aktivitetit të tyre;

• Të kuptojë ndikimin e tërmeteve të vjeshtës 2019 te bizneset e drejtuara nga gratë dhe nevojat e tyre për mbështetje nga autoritetet shtetërore;

• Të kuptojë ndikimin e pandemisë COVID-19 te bizneset e drejtuara nga gratë dhe nevojat e tyre për të rikuperuar.

2.2 Përqasja metodologjike dhe profili i të anketuarve

Për të mundësuar paraqitjen e një pamjeje të qartë të situatës në vendin tonë pas dy fatkeqësive, tërmetet e fundvitit 2019 dhe pandemia COVID-19, studimi u përqendrua në zonat e prekura më shumë nga tërmeti: qarqet Tiranë, Durrës e Lezhë. U përzgjodh dhe u zbatua një përqasje medologjike e kombinuar: studimi sasior me gratë sipërmarrëse, studim cilësor me institucionet publike e ato mikrofinancuese, dhe hulumtimi paraprak i të dhënave zyrtare, raporteve e studimeve mbi përfshirjen e grave në sipërmarrjen private, mbështetjen e qeverisë, nevojat dhe vështirësitë e shtuara për shkak të tërmetit vjeshtë 2019 dhe pandemisë COVID-19 në progres.


Faza e studimit sasior u zhvillua në formën e një ankete sasiore online, e cila u vetë administrua nga ana e subjekteve pjesëmarrëse, gra të cilat zotërojnë dhe/ose menaxhojnë një ndërmarrje private (përfshi këtu ato që janë të vetëpunësuar ose profesioniste të lira) dhe të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre të paktën në një nga tri qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Lezhës.

Në total, 357 subjekte ishin të interesuar për të marrë pjesë, nga të cilët 157 pyetësorë u skualifikuan si të paplotë apo për shkak se nuk plotësonin kriteret e pjesëmarrjes, si gjinia, pozicioni apo veprimtaria, ndërkohë që u kualifikuan si intervista të suksesshme 200 raste (56%).

Më konkretisht profili demografik e profesional i 200 grave sipërmarrëse, pjesëmarrëse të suksesshme në studim dhe ndërmarrjeve që ato drejtojnë, paraqitet në vijim.


Gati gjysma e këtyre grave sipërmarrëse janë pronare ose bashkëpronare të aktivitetit të cilin edhe e drejtojnë vetë (47%), kurse 32% janë të vetëpunësuar ose profesioniste të lira, pra nuk kanë punonjës të tjerë. Gati 1 në 5 pjesëmarrëse (21%) janë menaxhere drejtuese të aktivitetit privat, por nuk janë pronare ose bashkëpronare.

Grafiku 18: Pozicioni i pjesëmarrëseve në kompani




Mosha mesatare e pjesëmarrëseve është 41.1 vjeç, teksa më shumë se gjysma (56%) janë 40-65 vjeç dhe 12% janë midis 18-29 vjeç. Gjithashtu më shumë se gjysma e pjesëmarrëseve (56%) janë me arsim të lartë pasuniversitar (master ose doktoraturë) dhe vetëm 16% janë me arsim të mesëm.

Grafiku 19: Grupmosha




Grafiku 20: Arsimimi




Nga kampioni prej 200 ndërmarrjesh private të drejtuara nga gratë, gjysma (51%) e kryejnë aktivitetin e tyre në qarkun e Tiranës, kurse më pak se një e katërta janë respektivisht në qarkun e Durrësit (22%) dhe në qarkun e Lezhës (20%). Ndërkohë 11% e kampionit kanë shtrirje kombëtare, duke ofruar produktet dhe shërbimet e tyre në të gjithë vendin, dhe vetëm 4% kanë shtrirë aktivitetin e tyre edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Pra, në total të kampionit të intervistuar 62% e bizneseve kanë veprimtarinë e tyre në qarkun e Tiranës, 33% në qarkun e Durrësit dhe 31% në qarkun e Lezhës.

Grafiku 21: Zona ku pjesëmarrëset zhvillojnë aktivitetin privat




Treçereku i bizneseve pjesëmarrëse janë mikrobiznese me 1-9 punonjës, ku ato me 1 punonjës (të vetëpunësuarat ose profesionistet e lira) janë 32% dhe ato me 2-9 punonjës janë 43% e kampionit. Pjesa tjetër, 1/4 e pjesëmarrësve janë ndërmarrje të vogla, mesme ose të mëdha dhe më konkretisht, 16% janë ndërmarrje të vogla me 10-49 punonjës, 7% janë ndërmarrje të mesme me 50-249 punonjës dhe 2% janë ndërmarrje të mëdha me 250 ose më shumë punonjës.

Grafiku 22: Madhësia e biznesit sipas numrit të punonjësve



Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve drejtojnë ndërmarrje që prodhojnë e ofrojnë shërbime, ku spikasin aktivitetet profesionale, shkencore e teknike, me 18.5%. Ndërkohë, më pak se çereku i tyre drejtojnë ndërmarrje që prodhojnë të mira / produkte, ku spikasin artizanati ose zejtarët me 9.5%. Në total të kampionit, 79% e bizneseve ofrojnë vetëm shërbime, 17.5% ofrojnë vetëm të mira dhe 3.5% e tyre ofrojnë edhe shërbime, edhe të mira.


Grafiku 23: Sektori




Shumica dominuese (88%) janë ndërmarrje me pronësi shqiptare, dhe vetëm 4% janë ndërmarrje me pronësi totalisht të huaj.

Koha mesatare e veprimtarisë private në tregun shqiptar për bizneset që kanë marrë pjesë në studim është 8.8 vjet, nga të cilat 55% kanë mbi 5 vjet aktivitet dhe 28% kanë vetëm 1 vit aktivitet.

Grafiku 24: Pronësia e biznesit



Grafiku 25: Koha e biznesit në treg



Faza e studimit cilësor u fokusua tek mbledhja e opinionit nga përfaqësues të institucioneve publike përgjegjës për politikat e biznesit, si dhe nga përfaqësues të institucioneve mikrofinancuese. Pas disa përpjekjeve, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), deleguan marrjen e informacionit zyrtar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila iu përgjigj kërkesës sonë për informacion. Gjithashtu u realizuan intervista të thelluara me katër institucione mikrofinanciare (NOA, Fondi Besa, Iute Credit dhe Kredo Finance).

2.3 Instrumentet studimore

Pyetësori sasior

Pyetësori sasior u hartua në përputhje me objektivat studimorë, duke synuar mbledhjen e informacionit mbi klimën e përgjithshme të zhvillimit të biznesit nga gratë, ndikimin e tërmetit të nëntori 2019 dhe pandemisë COVID-19, shoqëruar nga masat izoluese prej qeverisë. Përpara finalizimit të instrumentit dhe aplikimit të pyetësorit online në mënyrë masive, u zhvillua një fazë pilotimi me disa biznese për të testuar shkallën e kuptueshmërisë dhe rrjedhshmërinë e plotësimit të pyetësorit. *(Për më shumë informacion, gjeni pyetësorin e plotë si Aneks B të këtij raporti).*

Plotësimi i pyetësorit online u mundësua përmes platformës SurveyMonkey dhe mbledhja e të dhënave u realizua gjatë periudhës 30 prill – 15 qershor 2020. Anketa u shpërnda nëpërmjet mesazheve elektronike të dedikuara tek gratë sipërmarrëse, në rrjetet sociale LinkedIn, Facebook e Instagram, duke përdorur edhe teknikën snowball, ku pjesëmarrësët kanë ndihmuar me shpërndarjen e kësaj ankete tek të njohurat e tyre.

Udhërrëfyesi cilësor

Udhërrëfyesi për intervistat me institucionet publike dhe ato mikrofinancuese u hartua me qëllimin për të kuptuar më mirë rolin dhe mbështetjen e këtyre institucioneve përkundrejt sipërmarrjes në përgjithësi dhe biznesit të grave në veçanti. Ky udhërrëfyes fokusohet tek situata e përgjithshme e biznesit në vend, pasojat e tërmeteve të vjeshtës 2019 e pandemisë COVID-19 dhe nevojat e grave sipërmarrëse, sikurse edhe reagimi dhe mbështetja e ofruar nga këto organizma. Duke qenë një formë pyetësori gjysmë i strukturuar, ky instrument fleksibël u përshtatet rast pas rasti, nga institucioni në institucion. *(Për më shumë informacion, gjeni udhërrëfyesin e plotë si Aneks C të këtij raporti).*

Pyetjet u përshtatën për secilin institucion dhe u dërguan me shkresë zyrtare e email në adresën e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit të secilit prej institucioneve qendrore: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtim, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ktheu përgjigje me shkresë zyrtare në të cilën ofroi informacion vetëm për gjysmën e pyetjeve të drejtuara. Institucionet e tjera publike sqaruan se shkresat i ishin deleguar për ndjekje dhe kompetencë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Institucionet mikrofinanciare janë kontaktuar drejtpërdrejtë dhe me to ishte e mundur realizimi i intervistave ballë përballë.

2.4 Aspektet etike

Shoqata "Together for Life" përzgjodhi dy ekspertet studimore me përvojë, znj. Alketa Berzani dhe znj. Silvana Xheka, të cilat administruan rishikimin e literaturës dhe studimor sasior online nga hartimi i pyetësorit sasior, përshtatja në platformën SurveyMonkey, mbledhja, monitorimi dhe pastrimi i të dhënave.

Stafi i shoqatës administroi fazën cilësore, si zhvillimin e intervistave dhe analizën e të dhënave. Znj. Berzani zhvilloi analizën e të dhënave sasiore, integrimin e të gjitha burimeve e analizave dhe hartoi raportin e plotë studimor. Ekspertet janë anëtare zyrtare të ESOMAR (Organizata Evropiane për Studime Marketingu e Sondazhe të Opinionit Publik) dhe gjatë punës së tyre respektojnë rigorozisht "Kodin Etik Ndërkombëtar për Studimet e Tregut, Hulumtimet e Opinionit Publik e Sociale"[85] (ICC/ESOMAR) bashkë me standardet e udhëzimet e tjera, sikurse edhe ligjin shqiptar Nr.9887, datë 10.3.2008 "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.[86]

Sa i përket aspekteve etike, në deklaratën hyrëse të pyetësorit sasior online u përshkruan qëllimi dhe kohëzgjatja mesatare e anketës, respektimi i anonimitetit dhe konfidencialitetit të të dhënave, si dhe qartësohej se të anketuarit mund ta ndërprisnin ose t'i bënin pauzë anketimit në çdo fazë. Pjesëmarrja e të gjithë subjekteve ishte vullnetare dhe asnjë pyetje, përveç atyre filtruese, nuk ishte e detyrueshme.

Baza e përftuar e të dhënave u pastrua përpara analizimit të tyre dhe gjetjet paraqiten pa aplikuar peshime pas mbledhjes së të dhënave.

85. Gjendet në: https://iccwbo.org/publication/iccesomar-international-code-market-opinion-social-research-data-analytics/
86. Gjendet në: http://www.ildkpki.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligji_9887_date_10_-03_2008_i_ndryshuar-2.pdf

2.5 Kufizimet e studimit

Gjatë leximit të këtij raporti studimor duhet të konsiderohen disa kufizime, si më poshtë vijon. Së pari është përfaqësimi i bizneseve në mënyrë jo-proporcionale sipas madhësisë apo sektorit. Bizneset e vogla me 10-49 punonjës dhe ato të mesme e të mëdha me 50+ punonjës janë të mbipërfaqësuar në studim, respektivisht zënë 16% dhe 9%, ndërkohë që, sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT, këto ndërmarrje zënë respektivisht 4.3% dhe 1.2% nga totali i 162,342 ndërmarrjeve aktive në vitin 2019.

Nga ana tjetër, prodhuesit e të mirave janë të nënpërfaqësuar në studim, ku zënë 23% të kampionit përkundrejt të dhënave zyrtare për vitin 2019, të cilat tregojnë se këta prodhues zënë në total 37% të ndërmarrjeve aktive.

Studimi është zbatuar në një periudhë 45-ditore ku vëmendja e sipërmarrjes ishte e fokusuar tek COVID -19 dhe pasojat e pandemisë. Kjo ka qenë një periudhë gjatë së cilës ecuria e pandemisë ishte në ndryshim e sipër, po ashtu edhe reagimi i qeverisë me masat izoluese shtrënguese e lehtësuese, si dhe mbështetjen ndaj biznesit apo punonjësve. Rrjedhimisht edhe shqetësimet, nevojat, reagimet dhe pritshmëritë e vetë sektorit privat kanë qenë në ndryshim e sipër.

Së fundmi, anketa u shpërnda në formë elektronike dhe u promovua në rrjetet sociale. Ndaj, në mënyrë të pashmangshme, pikëpamjet e grave sipërmarrëse të cilat nuk kanë akses në shërbimin e internetit, nuk kanë adresë elektronike ose nuk janë pjesë aktive e rrjeteve sociale (si ato në zonat rurale, të vetëpunësuara në bujqësi apo mbi 50-55 vjeç), nuk janë të përfaqësuara.

KAPITULLI III

GJETJET STUDIMORE

Ky kapitull përshkruan analizën e të dhënave sasiore të mbledhura në harkun kohor të këtij studimi, duke pasqyruar klimën e përgjithshme të biznesit të drejtuar nga gratë, si edhe pasojat e tërmetit 2019 dhe pandemisë COVID-19, gjithnjë sipas vlerësimit të grave sipërmarrëse, qofshin këto pronare, bashkëpronare dhe/ose drejtuese.

Gjetjet paraqiten në total dhe të ndara sipas qarkut ku vepron aktiviteti privat:

- Qarku Tiranë, me 123 bizneset të cilat kanë aktivitet të paktën në një nga zonat e këtij qarku (Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë a Rrogozhinë);
- Qarku Durrës, me 65 bizneset të cilat kanë aktivitet të paktën në një nga zonat e këtij qarku (Durrës, Shijak, Krujë a Fushë-Krujë);
- Qarku Lezhë, me 62 bizneset të cilat kanë aktivitet të paktën në një nga zonat e këtij qarku (Lezhë, Shëngjin, Kurbin a Mirditë).

Në raste të tjera analiza ka vijuar sipas madhësisë së biznesit, bazuar tek numri i punonjësve, e ndarë në tri nivele:

- Të vetëpunësuar pa punonjës ose profesioniste të lira, gjithsej 64 raste.
- Mikrobiznese me 2-9 punonjës, gjithsej 86 raste.
- Ndërmarrje të vogla me 10-49 punonjës, ndërmarrje të mesme me 50-249 punonjës dhe ndërmarrje të mëdha me 250 ose më shumë punonjës, bashkërisht gjithsej 50 raste.

Në të gjitha rastet, të dhënat në grafikë tregojnë përqindjen e përgjigjeve të grupuara në secilën alternativë, bazuar tek kampioni përkatës për secilën kategori (qarku ose madhësia e biznesit).

3.1 Klima e përgjithshme, vështirësitë tipike dhe nevojat e sipërmarrjes së grave


Situata e përgjithshme e biznesit përpara nëntorit 2019

Shumica e grave sipërmarrëse (63%) raportojnë se para nëntorit 2019 aktiviteti dhe fitimet e biznesit të tyre kanë qenë përgjithësisht në nivel mesatar, dhe vetëm 14% deklarojnë se kanë pasur aktivitet të lartë dhe fitime të mira.

Situata para nëntorit 2019 paraqitet në raport të drejtë me madhësinë e biznesit. Ndërmarrjet me 10 ose më shumë punonjës raportojnë aktivitet më të lartë dhe fitime më të mira (24%) krahasuar me mikrobizneset me 2-9 punonjës (13%) apo gratë e vetëpunësuar / profesionistet e lira (6%).


E kundërta ndodh me bizneset që kanë aktivitet dhe fitime të ulëta, ku grupohen 29% e grave të vetëpunësuara përkundrejt 16% e bizneseve me 10+ punonjës.

Grafiku 26: Gjendja e aktivitetit privat përpara nëntorit 2019, sipas madhësisë së biznesit



Dallime të lehta midis qarqeve, ku vihet re se ndërmarrjet që kanë veprimtari në qarkun e Tiranës kanë aktivitet më të lartë dhe fitime më të mira (17%) sesa ato në qarkun e Lezhës (11%).

Grafiku 27: Gjendja e aktivitetit privat përpara nëntorit 2019, sipas qarkut




Vështirësitë e zakonshme të biznesit të drejtuara nga gratë

Vështirësitë me të cilat haset aktiviteti privat drejtuar nga gratë është i shumëfishtë, ku më të shpeshtat janë ato të lidhura me marketingun dhe shitjet (85%), legjislacionin në fuqi dhe detyrimet shtetërore (85%), financimin e aktivitetit (73%) dhe burimet njerëzore ose tregun e punës (70%). Gjysma e grave sipërmarrëse deklarojnë se hasin vështirësi sociale (51%).

Ndërmarrjet me 10+ punonjës deklarojnë se hasin ndjeshëm më shumë vështirësi në tregun e punës ose burimet njerëzore (88%), krahasuar me mikrobizneset me 2-9 punonjës (70%).

Grafiku 28: Vështirësitë e zakonshme të ndërmarrjeve private drejtuar nga gratë




Më konkretisht, ndër vështirësitë për financim, sipërmarrëset përmendin vështirësinë për të siguruar informacionin e nevojshëm mbi subvencionet, grantet apo kreditë (60%), interesat e larta të kredive nga institucionet financiare (58%) dhe problemin e likuiditetit për shkak të afateve të gjata, shlyerjeve të vonuara nga klientët ose pagesat me klering (56%).

Këto dy të fundit janë vështirësitë kryesore për financimin e ndërmarrjeve me 10 ose më shumë punonjës në strukturë, secila 63%.


Profesionistet e lira ose gratë e vetëpunësuar hasin vështirësi për shkak të mungesës së ofrimit të kredive të zbutura për bizneset e reja ose bizneset e vogla (63%) dhe interesat e larta të kredive (63%).

Grafiku 29: Vështirësitë në financim




Ndër vështirësitë në fushën e marketingut dhe shitjeve, gratë sipërmarrëse përmendin si më kryesoret luhatjen e kërkesës ose klientelën e paqëndrueshme (61%) dhe informalitetin e lartë (59%), pasuar nga kostot e larta të marketingut (54%) dhe konkurrencën e ashpër (53%). Profesionistet e lira ose gratë e vetëpunësuara shfaqin shqetësim më të lartë pikërisht për informalitetin e lartë në sektorin e tyre, si p.sh. konkurrentë informal të paregjistruar, mosdeklarimi i punonjësve etj. (60%) dhe luhatjen e kërkesës ose klientelës (57%). Ndërmarrjet me 10+ punonjës gjithashtu shqetësohen për informalitetin e lartë në sektorin e tyre (63%).

Grafiku 30: Vështirësitë në marketing dhe shitje



Në drejtim të prodhimit dhe aspektit teknik, gratë sipërmarrëse përmendin si vështirësi kryesore nevojën për investime të vazhdueshme me qëllim përshtatjen ndaj zhvillimeve teknologjike gjithnjë e më tepër (54%). Kjo vështirësi shfaqet e përshkallëzuar dhe në shkallë të drejtë me madhësinë e biznesit: 63% e ndërmarrjeve me 10 ose më shumë punonjës e pohojnë këtë, përkundrejt 56% të mikrobizneseve me 2-9 punonjës dhe 44% të grave të vetëpunësuara.


Grafiku 31: Vështirësitë në prodhim dhe aspektin teknik



Kur flitet për vështirësitë me burimet njerëzore dhe tregun e punës, gratë sipërmarrëse përmendin si tepër shqetësuese mungesën e stafit të kualifikuar dhe me përvojë (68%). Kjo problematikë është veçanërisht e lartë tek ndërmarrjet me 10+ punonjës (89%), të cilat shfaqin si vështirësi të dytë në këtë drejtim atë të qarkullimit të shpeshtë të punonjësve, p.sh largimet nga vendi i punës, lejet e lindjes (57%).

Gati gjysma e tyre cilësojnë si vështirësi kërkesën e punonjësve për paga të larta dhe bonuse, ndërkohë që mungesa e trajnimit për veten dhe/ose punonjësit është një tjetër vështirësi tek më shumë se 1/3 e sipërmarrëseve (38%).


Grafiku 32: Vështirësitë në tregun e punës dhe burimet njerëzore



Sikurse u vu në dukje më lartë, vështirësitë me legjislacionin dhe detyrimet shtetërore janë renditur si vështirësia e dytë kryesore për ndërmarrjet që drejtohen nga gratë. Më konkretisht, sipërmarrëset përmendin si më shqetësuese taksat e tatimet e larta (71%) dhe ndryshimet e vazhdueshme në sistemin fiskal (70%), pasuar nga mungesat në kuadrin ligjor të ligjeve apo akteve normative (61%).


Ndërkohë, ndërmarrjet me 10+ punonjës shprehen se hasin më shumë vështirësi se mikrobizneset në lidhje me mosrimbursimin e TVSH-s dhe korrupsionin në radhët e administratës shtetërore, si p.sh.: në dogana, tatime, bashki, respektivisht në masën 68% dhe 57%. Inspektimet e shpeshta nga administrata tatimore duket se janë një problematikë veçanërisht shqetësuese për gratë e vetëpunësuara ose profesionistet e lira (54%).

Grafiku 33: Vështirësitë në legjislacion dhe detyrimet shtetërore



Sipas vlerësimit të grave që zotërojnë dhe menaxhojnë ndërmarrjet private, vështirësitë sociale renditen të fundit. Rreth 1 në 3 gra sipërmarrëse përmendin si vështirësi mjedisin e biznesit jo shumë favorizues dhe ku ka mungesë besimi nga parterët, furnitorët e investitorët (34%), kurse 1 në 4 gra sipërmarrëse shohin me shqetësim ruajtjen e balancës biznes–familje, duke hasur vështirësi me plotësimin e atyre që perceptohen si detyrimet e tyre si gra, bashkëshorte apo nëna (26%). Edhe pse në masë më të vogël se vështirësitë e tjera sociale e gjinore, 15% e grave sipërmarrëse shprehen për ngacmime verbale e seksuale gjatë ndërveprimit me partnerët e biznesit, furnitorët etj. Kjo e fundit rezulton të jetë më shqetësuese për gratë e vetëpunësuara ose që ushtrojnë profesionet e lira (20%).

Grafiku 34: Vështirësitë sociale e të tjera



Vështirësitë e biznesit për shkaqe gjinore të pronësisë ose administratorit

Të pyetura për vështirësitë që shfaqen ose amplifikohen për shkaqe gjinore, mund të vihet re se vetëm një pjesë e problematikave të shtruara i atribuohen gjinisë së pronarëve dhe drejtuesve. Vështirësitë sociale janë ato që shfaqen më të shtuara për shkak të gjinisë së tyre.

Nëse krahasojmë nivelin e vështirësive të përgjithshme me ato të perceptuara për shkaqe gjinore (shiko grafikun 35), kuptohet se gratë drejtuese të bizneseve nuk mendojnë se të gjitha vështirësitë që hasin në mbarëvajtjen e biznesit kanë të bëjnë me gjininë e tyre.

Dallim ka pikërisht tek vështirësitë sociale, të cilat janë dukshëm në përqindje më të lartë për arsye gjinore sesa si një vështirësi e përgjithshme e biznesit, specifikisht 61% përkundrejt 51%. Kjo diferencë është më e lartë për problematika si balanca biznes – familje, pasi gratë kanë rol të shumëfishtë si bashkëshorte e nëna nga të cilat tradicionalisht pritet të kryejnë një sërë detyrash në familje; si dhe prezenca dominuese e meshkujve në sektorin privat bashkë me ngacmimet verbale e seksuale.

Gratë sipërmarrëse në qarkun verior të Lezhës shprehen për një shkallë më të lartë (77%) të vështirësive sociale për arsye gjinore, krahasuar me sipërmarrëset në dy kryeqendrat e biznesit, Tiranë e Durrës.

Nga intervistat me institucionet mikrofinanciare (MFI), rezulton se disa nga pengesat për zhvillimin e sipërmarrjes femërore lidhen:


a. steriotipet gjinore që kufizojnë mundësitë e grave për t'u përshtatur në çdo lloj biznesi, si ndërtimi, servis makinash, transport, të konsideruara si "biznese burrash";

b. mungesën e politikave shtetërore lehtësuese për financimin me fondet publike të sektorëve, si zejtaria, agrobiznesi, kulinaria ku dominojnë gratë;

c. ndjekja e procedurave jo të lehta dhe shumë të kushtueshme për certifikimin e produkteve të prodhuara e tregtuara nga gratë;

d. sigurimi i tregut në një mjedis pa rregulla të qarta loje dhe me konkurrencë të ashpër.

Grafiku 35: Vështirësitë e përgjithshme të biznesit vs. shkaqeve gjinore




Kur pyeten në mënyrë të drejtpërdrejtë për politikat publike dhe mjedisin e biznesit në Shqipëri se sa favorizuese janë përkundrejt grave sipërmarrëse në krahasim me burrat sipërmarrës, qartazi peshorja anon nga favorizimi për sipërmarrësit e gjinisë mashkullore. Përjashtim ka qasja gati e barabartë për të dyja gjinitë në edukim dhe trajnim për menaxhimin e ndërmarrjeve private.

Më specifikisht, fitimi i tenderave publikë dhe koncesioneve duket shumë më favorizues për sipërmarrësit meshkuj (61%), pasuar nga mundësia e tyre për të hyrë në treg ose për t'u përqasur tregjeve të reja (57%) dhe promovimi i sipërmarrjes private kur pronarët dhe/ose drejtuesit janë meshkuj (48%). Gjithashtu mundësia për të aksesuar mjedise biznesi si forume, panaire etj. apo pjesëmarrja në shoqata e grupe biznesi janë më favorizuese për meshkujt, secila në masën 41%.

Ndryshe nga vlerësimet e tjera, qasja në edukim dhe trajnime për menaxhimin e ndërmarrjeve private vlerësohet si një mundësi gati e barabartë për të dyja gjinitë (50%). Intervistat me MFI-të evidentojnë se gratë marrin vlerësime pozitive, pasi paraqesin risk më të ulët dhe besueshmëri më të lartë si kreditore krahasuar me burrat, por janë larg nga të qenit të barabarta në numër me burrat kredimarrës. Kështu NOA, një nga institucionet më të hershme mikrofinanciare në vend, deklaron se në portofolin e saj gratë zënë rreth 27% të numrit të klientëve të shërbyer, ndonëse janë një grup i promovuar nëpërmjet historive të suksesshme.

Grafiku 36: Favorizimi gjinor i sipërmarrësve përmes politikave publike dhe mjedisit të biznesit



Mbështetja e qeverisë shqiptare dhe aktorëve të tjerë ndaj biznesit të grave


Sipas grave sipërmarrëse, mbështetja e qeverisë shqiptare apo aktorëve të tjerë ndër vite ka qenë e kufizuar: midis 4% fonde nga bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm, si qeveria shqiptare, donatorët, bankat dhe 11% nga bankat ose institucionet e mikrokredive.

Nga analiza sipas madhësisë së biznesit, vihet re se të gjithë aktorët kanë ofruar më pak mbështetje për profesionistet e lira / gratë e vetpunësuara sesa bizneset me të punësuar; maksimalisht gratë e vetëpunësuara kanë marrë mbështetje nga fondet publike të qeverisë shqiptare në masën 5%, dhe kjo në periudhën pas tërmetit të nëntorit 2019.


Nuk ka diferenca statistikisht domethënëse midis mikrobizneseve me 2-9 punonjës dhe ndërmarrjeve me 10+ punonjës në lidhje me mbështetjen e marrë nga aktorë të ndryshëm, me përjashtim të kreditimit nga bankat dhe institucionet e tjera financiare. Këto të fundit kanë mbështetur më shumë ndërmarrjet me 10+ punonjës (26%) sesa mikrobizneset me 2-9 punonjës (8%) dhe vetëm 3% të grave të vetëpunësuara / profesionisteve të lira.

Nga intervistat me MFI-të, të cilat kanë për qëllim ofrimin e konsulencës dhe financimeve për sipërmarrjet e vogla të mesme, kryesisht mikrobizneset familjare dhe agrobizneset, rezulton se deri më sot nuk kanë krijuar ndonjë produkt specifik të dedikuar sipërmarrëseve gra. Sipas këtyre institucioneve, ofrimi i një trajtimi të unifikuar për sipërmarrësit e të dyja gjinive është një politikë e drejtë e cila nuk vë në kushtet e diskriminimit (negativ a pozitiv) as gratë e as burrat. Të pyetura nëse janë duke planifikuar ndonjë produkt të dedikuar për sipërmarrëset gra, vetëm Kredo Finance sh.p.k deklaron se është duke punuar për të krijuar produkte më të specifikuara për këtë kategori.

Grafiku 37: Mbështetja e sipërmarrjes së grave nga aktorë të ndryshëm, në total



Grafiku 38: Mbështetja e sipërmarrjes së grave nga aktorë të ndryshëm, sipas madhësisë së biznesit




Më specifikisht, vihet re që sipërmarrja e grave ka përfituar ndër vite (deri në fund të vitit 2019) më shumë fonde nga donatorët e huaj e vendas dhe bankat e institucionet mikrokredituese sesa nga qeveria shqiptare. Kjo e fundit duket se ka kontribuar më shumë pas tërmetit të nëntorit 2019.

Nga analiza sipas madhësisë së biznesit, vihet re se 2-5% e grave të vetëpunësuar / profesionisteve të lira kanë marrë mbështetje nga aktorët e ndryshëm pas nëntorit 2019. Bankat dhe institucionet e tjera mikrokredituese kanë mbështetur më shumë ndërmarrjet me 10+ punonjës (17% para tërmetit dhe 9% pas tërmetit) sesa mikrobizneset me 2-9 punonjës (7% para tërmetit dhe vetëm 1% pas tërmetit).

Nga ana tjetër, mikrobizneset me 2-9 punonjës deklarojnë se kanë marrë më shumë mbështetje nga donatorët e huaj (7%) pas tërmetit të nëntorit 2019 në krahasim me ndërmarrjet e tjera.

Grafiku 39: Mbështetja e sipërmarrjes së grave nga aktorë të ndryshëm ndër vite



Sugjerime për prioritizimin e mbështetjes së sipërmarrëseve femra

Sipas grave sipërmarrëse, ka shumë aktivitete e forma për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve të tyre, si dhe për të mbështetur gratë të cilat duan të ndërmarrin nisma të reja private, por më kryesorja e prioritarja lidhet me mundësitë e financimit (64%). Si mundësi financimi ato shohin ofrimin e financimit të drejtpërdrejtë, por edhe lehtësirat fiskale e ato në përfitimin e fondeve, si dhe hartimin e politikave buxhetore me ndikim gjinor, si më poshtë listuar:

- Grante e subvencione për fillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të sipërmarrjes së grave;
- Programe ose skema të dedikuara nga pushteti lokal për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë ose në pronësi të tyre;
- Kredi të zbutura me norma të ulëta interesi e afate të gjata shlyerjeje;
- Lehtësira fiskale për gratë sipërmarrëse në vitin e parë të veprimtarisë së tyre, e veçanërisht kur përfshihen në sektorë më të brishtë, si p.sh arti e kultura;
- Forma financimi si kapitali privat (private equity), kapitali i sipërmarrjes (venture capital) apo investitorët engjëj (angel investors).

Një nga vështirësitë e sipërpërmendura është pikërisht mungesa e informacionit për grantet, subvencionet apo kreditë e buta. Për këtë arsye ato kërkojnë gjithashtu që të ketë fushata informuese mbi këto programe mbështetëse, që ofrohen nga shteti apo donatorët vendas e të huaj për gratë, si në drejtim të punësimit të tyre dhe të sipërmarrjes private.

Prioriteti i dytë sipas tyre është mbështetja për të shitur produktet dhe shërbimet e tyre në tregje e kanale të reja (41%) dhe krijimi i një portali online për gratë sipërmarrëse (41%).

Sugjerimet e tyre në lidhje me gjetjen e tregjeve dhe kanaleve të reja të shitjes lidhen sa me mbështetjen financiare, aq edhe me informimin e mbështetjen teknike të tyre për të arritur këtë qëllim, sikurse vihet re më poshtë:


- Ndihmë nga pushteti qendror dhe lokal përmes politikave e planeve konkrete për të siguruar treg në zonën ku veprojnë, por edhe për shtrirje në tregje të tjera brenda dhe jashtë vendit;
- Informimi dhe mbështetja teknike për t'u zgjeruar në tregje të cilat kanë nevojë për produktet dhe shërbimet e tyre;
- Fokus i veçantë sidomos për bizneset e vogla apo sektorë si zejtaria (artizanati) e bujqësia, të cilat kanë shumë nevojë, por kanë kapacitete të kufizuara;
- Trajnime për përdorimin e shtuar të teknologjisë dhe shitblerjes në internet (e-commerce);
- Mbështetje teknike për të ndërtuar platformat e tyre të shitblerjes në internet;
- Informimi dhe mbështetja teknike e grave që merren me zejtari (punime dore) për t'u zgjeruar në tregun digjital dhe shitur produktet e tyre përmes platformave të caktuara, si p.sh. Etsy, Shoppify, Zibbet, Amazon Handmade etj.

Sipas grave sipërmarrëse, prioriteti i tretë është krijimi i një portali të dedikuar për to në internet (41%), ku mund të ofrohen:

- Informacione të ndryshme për krijimin e një biznesi, mundësitë e financimit, tregjet që kanë mungesa në produkte e shërbime të caktuara, etj;
- Informacion mbi organizatat dhe grupimet e biznesit në përgjithësi, dhe ato të fokusuara tek gratë sipërmarrëse në veçanti;
- Informacion mbi aktivitete biznesi, si p.sh panaire, forume, konferenca, trajnime e kurse profesionale për menaxhim, etj;
- Këshilla të përgjithshme për krijimin dhe mbarëvajtjen e biznesit në aspektin ligjor, fiskal, burimet njerëzore, etj;
- Këshillime online nga ekspertë për aspektet ligjore, promovimin dhe marketingun, zhvillim të burimeve njerëzore, etj;

- Listimi i ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë, përfshi këtu edhe profesionistet e lira, si një katalog online që mund të organizohet ose filtrohet sipas sektorit e qarkut ku ato veprojnë;
- Promovim i sipërmarrjeve të reja duke iu kushtuar një hapësirë të veçantë në portal.

Grafiku 40: Aktivitetet prioritare për të mbështetur gratë sipërmarrëse në Shqipëri



Institucionet mikrokredituese të intervistuara evidentojnë nevojën për trajnim të grave sipërmarrëse për rritjen e njohurive në drejtim të studimit të tregut dhe analizës strategjike të tregut dhe biznesit. Ndërkohë, për gratë sipërmarrëse në zonat rurale, nevoja për trajnim mbi aftësitë sipërmarrëse e menaxheriale, menaxhimin e parasë, parashikimi i inventarit, procedurat për hapjen e biznesit dhe rritje kapacitetesh konsiderohet akoma më e madhe.

Gratë sipërmarrëse japin sugjerime për ofrimin e trajnimeve dhe seminareve të ndryshme për menaxhim e udhëheqje, si një formë edukimi i vazhdueshëm, dhe mbi tematika si aspektet ligjore dhe fiskale (tatimet, detyrimet vendore, zhdoganimi etj.), komunikimin dhe marketingun, zhvillimin e burimeve njerëzore, teknika negocimi, shkrim projektesh, etj, por edhe programe për trajnimin e liderëve (Leadership Coaching Training Program).

Ato mbështesin idenë për ofrimin e trajnimeve profesionale për gratë në përgjithësi, si një parakusht për sipërmarrjen e tyre në të ardhmen, madje trajnime pa pagesë, duke prioritizuar grupet vulnerabël, dhe duke u fokusuar në fusha si IT, gjuhë të huaja, estetikë etj.

Rrjetëzimi dhe shkëmbimi mes tyre shfaqet si një tjetër sugjerim i rëndësishëm për gratë sipërmarrëse. Ato hedhin idenë se nevojitet një organizëm apo shoqatë e cila ka në fokus sipërmarrjen e grave, të drejtat, nevojat dhe interesin e tyre. Për më tepër duhet të organizohen aktivitete për forcimin e marrëdhënieve të grave sipërmarrëse mes tyre dhe shkëmbimin e përvojave pozitive përmes panaireve promovuese, tryezave të diskutimit, forumeve e konferencave të ndryshme. Referimi i njëra-tjetrës, shitblerja midis kompanive të tyre, vizitat shkëmbyese pranë bizneseve të suksesshme në vend ose shtete të tjera, shihen si alternativa të tjera për përforcimin e marrëdhënieve dhe fuqizimin e grave sipërmarrëse.

Promovimi i barazisë gjinore dhe sipërmarrjes femërore që herët është një nevojë për të edukuar brezat e ardhshëm. Disa sugjerime në këtë rast lidhen me organizimin e takimeve me gratë sipërmarrëse ose prezantimeve të ambienteve të biznesit (online e offline) me nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme apo studentët, duke ndarë përvojat dhe duke i frymëzuar ata. Gjithashtu gratë e suksesshme sipërmarrëse mund të shërbejnë si mentore për studentët ose nxënësin e shkollave të mesme profesionale. Promovimi i sipërmarrjes së grave në median e shkruar, portalet e forumet online apo botime të biografive të shembujve të suksesit, si dhe përmes fushatave ndërgjegjësuese të marketingut janë disa mënyra për edukimin e gjerë.

Një sugjerim tjetër nga gratë sipërmarrëse lidhet me lehtësimin e shërbimeve të kujdesit, duke subvencionuar kopshtet e shkollat, kujdestarët për fëmijët apo të moshuarit, duke krijuar hapësirën e nevojshme për gratë të angazhohen në sektorin privat dhe sipërmarrjen e tyre.

Së fundmi, të gjitha këto kërkojnë që sipërmarrja të zhvillohet në një terren ku kuadri ligjor është jo vetëm i kompletuar dhe i përditësuar sipas zhvillimeve të kohës, por edhe zbatohet në mënyrë korrekte. Sipas tyre, është e nevojshme që organet shtetërore të tregojnë një përqasje proaktive ndaj sektorit privat dhe të mos e shohin si objekt sulmi apo përfitimi.

3.2 Tërmetet e vjeshtës 2019 dhe ndikimi në sipërmarrjen e grave

Tërmetet e 21 shtatorit dhe 26 nëntorit 2019 që goditën Shqipërinë patën dëme materiale e njerëzore, kryesisht në qarqet e Durrësit, Lezhës dhe Tiranës.


Sikurse vihet re në grafikun e mëposhtëm, 83% e bizneseve të drejtuara nga gratë në këto qarqe deklarojnë se tërmetet e shtatorit dhe nëntorit 2019 kanë pasur ndikim negativ (shumë ose disi negativ) në aktivitetin e tyre dhe vetëm 16% shprehen se nuk kanë pasur asnjë ndikim nga këto fatkeqësi natyrore. Bizneset të cilat operojnë në Durrës e Lezhë janë goditur edhe më shumë (respektivisht 88%) sesa ato që operojnë në Tiranë (77%).

Teksa 21% e bizneseve të drejtuara nga gratë në qarkun e Tiranës shprehen se nuk kanë pasur asnjë ndikim nga tërmetet, vetëm 10% e bizneseve në Durrës e Lezhë kanë pasur këtë fat.

Sikurse është e pritshme, këto fatkeqësi natyrore nuk sjellin pasoja pozitive tek bizneset në përgjithësi, me përjashtime të vogla në varësi të aktivitetit që kryen. Vetëm 1% e ndërmarrjeve kanë deklaruar ndikim pozitiv.

Nga ana tjetër, ndërmarrjet me 10 ose më shumë punonjës në strukturën e tyre, janë ato që shprehin ndikim neutral të këtyre tërmeteve (22%), dy herë më shumë sesa gratë e vetëpunësuara (11%), të cilat shprehen si më shumë të dëmtuara (54% e tyre cilësojnë ndikim shumë negativ).

Grafiku 41: Ndikimi i tërmeteve në aktivitetin privat të drejtuar nga gratë




Ndërkohë që 27% e bizneseve të drejtuara nga gratë në total deklarojnë se kanë pësuar dëmtime të ambienteve të biznesit (fabrikë, dyqan, zyrë, magazinë, etj), kjo përqindje është më e lartë në Durrës dhe Lezhë (respektivisht 33%) dhe gati dy herë më e vogël në Tiranë (14%). Dy pasojat e tjera kryesore të tërmetit tek aktiviteti privat rezultojnë të jenë ulja e xhiros dhe fitimeve në më pak se gjysmat e ndërmarrjeve (44%) dhe pezullimi i përkohshëm i veprimtarisë (34%).

Pasojat e tjera të shkaktuara nga tërmeti shfaqen në nivele të ndryshme në secilin qark. Më konkretisht, në Durrës 50% e bizneseve të drejtuara nga gratë kanë mbyllur përkohësisht aktivitetin si pasojë e tërmeteve dhe 52% deklarojnë uljen e xhiros dhe fitimeve.

Në Lezhë, 30% e bizneseve të drejtuara nga gratë kanë mbyllur përkohësisht aktivitetin si pasojë e tërmeteve dhe 33% deklarojnë uljen e xhiros dhe fitimeve. Nga ana tjetër, Tirana, e dëmtuar fizikisht më pak, ka pezulluar përkohësisht aktivitetin në atë kohë në 34% të bizneseve të drejtuara nga gratë, e megjithatë gjysma e tyre (50%) kanë pësuar rënie të xhiros dhe fitimeve.

Grafiku 42: Pasojat negative të tërmeteve 2019 te bizneset e drejtuar nga gratë



Ndërmarrjet me 10+ punonjës shprehen në përqindje ndjeshëm më të lartë sesa mikrobizneset me 2-9 punonjës se kanë ulur numrin e punonjësve si pasojë e tërmeteve të vjeshtës 2019, respektivisht 22% përkundrejt 9%. Në të njëjtin trend, 20% e ndërmarrjeve me 10+ punonjës kanë ulur volumin e prodhimit përkundrejt 9% të mikrobizneseve.

Sipas intervistave me MFI-të, biznesi u ndikua në mënyrë të ndjeshme nga tërmeti, çka u duk në skepticizmin e klientëve për të kryer investime apo për të ngritur biznese të reja, ndonëse zgjati vetëm për një periudhë të shkurtër. Nga ana tjetër, disa sektorë të ekonomisë nuk u ndikuan ose u ndikuan pozitivisht, si: agjencitë e sigurimeve, tregtia e elektro-shtëpiakeve, ndërtimi dhe zinxhiri i lidhur me të.

Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, MFI-të kanë marrë masa për lehtësimin e bizneseve të dëmtuara në zonat e prekura nëpërmjet shtyrjes apo rishikimit të planeve të pagesave, financimeve shtesë për rimëkëmbjen e aktivitetit, por nuk ka pasur asnjë paketë që i drejtohet specifikisht grave.


3.3 Pandemia COVID-19 dhe ndikimi në sipërmarrjen e grave, periudha maj – qershor 2020

Pandemia COVID-19 dhe izolimi social, bashkë me pezullimin e përkohshëm të shumë aktiviteteve private për shkak të kërkesave të përcaktuara nga qeveria shqiptare në mes të muajit mars 2020, pati një ndikim masivisht negativ tek bizneset e drejtuara nga gratë. Sikurse vihet re në grafikun e mëposhtëm, 93% e bizneseve të drejtuara nga gratë deklarojnë se COVID-19 ka pasur ndikim negativ (shumë ose disi negativ) në aktivitetin e tyre deri në mes të muajit qershor (kohë kur u zbatua faza e mbledhjes së të dhënave të këtij studimi).

Ndikim i lartë negativ vihet re veçanërisht tek gratë e vetëpunësuara / profesionistet e lira dhe mikrobizneset me 2-9 punonjës, respektivisht 89% dhe 79% cilësojnë ndikim shumë negativ të kësaj pandemie. Ndjeshëm më e ulët kjo masë tek ndërmarrjet me 10+ punonjës, 59% e të cilave shprehen se pandemia ka pasur ndikim shumë negativ.

Nuk ka ndonjë diferencë statistikisht domethënëse midis qarqeve në lidhje me ndikimin e pandemisë COVID-19, dhe kjo është e kuptueshme për shkak të masave kombëtare të njëjta që u përcollën përgjatë tri muajve të fazës fillestare të pandemisë.

Grafiku 43: Ndikimi i COVID-19 në aktivitetin privat të drejtuar nga gratë



Drejtuesit e MFI-ve shprehen se COVID-19 paralizoi pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë, dhe diferencën se cili biznes u godit më shumë e bëri shëndeti financiar i mëparshëm i vetë bizneseve. Sipas tyre, u ndikua më fort sipërmarrja e vogël, si: bar-kafe, restorante, struktura shërbimi, hoteleri-turizmi, palestrat, sallonet e bukurisë, qendrat e masazheve, ku shumë prej tyre po përballen ende me rrezikun e mbylljes së përhershme për shkak të falimentimit.

Sektorët më pak të prekur, sipas MFI-ve, vlerësohen të jenë postat, shërbimet delivery, farmacitë, furrat e bukës, të cilat nuk e ndërprenë asnjëherë punën, por përsëri hasën vështirësi. Ndërkohë, të vetmet biznese që patën ndikim pozitiv në këtë situatë, ishin bizneset e shpërndarjes e shitjes së mallrave ushqimore, kryesisht grosistët, supermarketet, agro-biznesi dhe tregtia online.

Përpos bllokimit të plotë të veprimtarisë gjatë pandemisë dhe izolimit social (51%) ose pezullimit të përkohshëm të aktivitetit të tyre (49%), pasojat e tjera kryesore negative prej COVID-19 lidhen me uljen e xhiros dhe fitimeve tek gjysma e bizneseve të drejtuara nga gratë (48%), vështirësi për të shlyer detyrimet shtetërore dhe ndaj palëve të treta (34%), si edhe kosto të shtuara për të garantuar kushtet higjieno-sanitare dhe dezinfektimin e ambienteve të punës (30%).

Grafiku 44: Pasojat negative të COVID-19 në bizneset e drejtuar nga gratë



Ndërmarrjet me 10+ punonjës shprehin në masë më të madhe vështirësinë për të siguruar lëndën e parë (26%) dhe uljen e volumit të prodhimit (30%), përkundrejt mikrobizneseve me 2-9 punonjës të cilat kanë hasur këto pasoja respektivisht në masat 15% dhe 12%.

Trend i ngjashëm në lidhje me kostot e shtuara, ku ndërmarrjet me 10+ punonjës shprehin në masë më të lartë rritjen e kostove për të garantuar kushtet higjieno-sanitare dhe dezinfektimin e ambienteve të punës (46%) dhe për të siguruar mjetet e shërbimet e punës dhe komunikimit në distancë (32%), përkundrejt mikrobizneseve me 2-9 punonjës të cilat kanë hasur këto pasoja respektivisht në masat 27% dhe 12%.

Për këto arsye, edhe aplikimi për kredi bankare ka qenë më e lartë nga ndërmarrjet me 10+ punonjës (18%) sesa mikrobizneset (2%), që i janë drejtuar më shumë rrjetit personal për huamarrje (11%).

Si masë mbrojtëse për të kontrolluar shpenzimet e për të mos falimentuar në kushtet e bllokimit ose pezullimit të përkohshëm të aktivitetit, 18% e bizneseve të drejtuara nga gratë kanë reduktuar numrin e punonjësve dhe 17% kanë reduktuar pagat e stafit, nga të cilat 8.5% kanë aplikuar edhe shkurtim personeli, edhe ulje page. Shifrat e reduktimit të punonjësve janë më të larta tek ndërmarrjet me 10+ punonjës (32%), kurse reduktimi i pagave ka qenë një strategji e aplikuar në nivel të ngjashëm midis këtyre bizneseve (22-26%).


3.4 Mbështetja dhe nevojat e sipërmarrëseve pas tërmeteve të vjeshtës 2019 dhe pandemisë COVID-19

Mbështetja e biznesit pas tërmetit të nëntorit 2019

Vetëm 17% e grave sipërmarrëse deklarojnë se ndërmarrja e tyre ka marrë mbështetje nga pushteti qendror ose lokal si pasojë e dëmtimit nga tërmeti, ndërkohë që 17% të tjera janë ato që nuk kishin pasur ndikim negativ prej këtyre fatkeqësive të vjeshtës 2019. Pra, 66% e bizneseve, edhe pse deklarojnë se kanë pasur ndikim negativ nga tërmetet e vjeshtës 2019, nuk kanë marrë asnjë lloj mbështetjeje nga shteti.

Duke parë rezultatet sipas madhësisë së biznesit, vihet re se gratë e vetëpunësuara ose profesionistet e lira kanë marrë mbështetje në përqindje më të lartë (20%) sesa ndërmarrjet me 10+ punonjës (12%). Duke konsideruar raportimin e dëmtimit për secilën kategori, 57% e grave të vetëpunësuara dhe 62% e ndërmarrjeve me 10+ punonjës nuk kanë marrë asnjë lloj mbështetjeje nga shteti, ndonëse shprehen se kanë pasur ndikim negativ nga tërmetet e vjeshtës 2019.

Grafiku 45: Niveli i mbështetjes së sipërmarrëseve nga qeveria pas tërmetit nëntor 2019



Më konkretisht, mbështetja e marrë nga shteti shqiptar në kuadër të dëmeve të pësuara nga tërmetet e vjeshtës 2019 ka konsistuar në njohjen e shpenzimeve në bilancet e bizneseve për dëmet materiale, të mallrave, të ndërtesave dhe të çdo shpenzimi të kryer për rindërtim (8%); heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për materialet e ndërtimit për përdorim të brendshëm dhe ato që importohen (5%) dhe përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve për rindërtim (4%).

Grafiku 46: Mbështetja konkrete e grave sipërmarrëse nga qeveria pas tërmetit nëntor 2019




Mbështetja gjatë pandemisë COVID-19 dhe izolimit social

Mbështetja qeveritare për bizneset për shkak të pandemisë COVID-19 ka arritur në 60% të totalit të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë. Frekuenca e kësaj mbështetjeje ka qenë në raport të drejtë me madhësinë e biznesit: ndërmarrjet me 10+ punonjës janë mbështetur në masë më të madhe (70%) sesa mikrobizneset me 2-9 punonjës (62%) apo gratë e vetëpunësuara (48%).


Duke konsideruar masën e dëmit sipas deklaratave të grave sipërmarrëse, rezulton se 33% e bizneseve në total të drejtuara nga gratë nuk kanë marrë asnjë mbështetje, pavarësisht pasojave që ka sjellë COVID-19 në veprimtarinë e tyre private. Duke analizuar të dhënat sipas madhësisë së biznesit, rezulton se 46% e grave të vetëpunësuara, 33% e mikrobizneseve me 2-9 punonjës dhe 20% e ndërmarrjeve me 10+ punonjës nuk kanë marrë asnjë mbështetje nga shteti për pasojat negative në aktivitetin e tyre privat të krijuara prej pandemisë COVID-19.

Më specifikisht, ndihma e qeverisë për sipërmarrjen private të grave ka konsistuar në përfitimin e shumës prej 40 mijë lekësh për periudhën prill – qershor 2020 (20%), shtyrjen e deklarimit të bilanceve (19%) dhe përfitimin e "pagës së luftës" (15%). Mbështetje minimaliste nga ana e shtetit shqiptar përmes rimbursimit të pjesshëm të pagës së punonjësve dhe kompensimit të pagesës së qirasë, secila në masën 4%.

Grafiku 47: Niveli i mbështetjes së grave sipërmarrëse nga qeveria, mars-qershor 2020



Grafiku 48: Mbështetja konkrete e grave sipërmarrëse nga qeveria, mars – qershor 2020



Referuar masave të marra nga qeveria shqiptare, MFI-të shprehen se ato ishin një përpjekje për t'i dhënë frymëmarrje biznesit dhe individëve gjatë tre muajve të izolimit, por jo të studiuara mirë. Ndërkohë që shtyrja e kredive u realizua në të gjithë sektorin (banka e jobanka), kredia sovrane pati efekt të kufizuar tek bizneset, pasi u aplikua vetëm në sektorin bankar, e jo atë mikrofinanciar. Deri në 28 maj 2020, institucionet financiare, anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, shqyrtuan dhe procesuan më shumë se 30 mijë kërkesa për shtyrje me një vlerë totale prej afro 70 milionë Euro.

Sektori i mikrofinancës ofron si ndihmë për rimëkëmbjen e bizneseve mundësinë e rifinancimit për bizneset në vështirësi, si dhe shtyrjen pa asnjë penalitet apo ngarkesë financiare të të gjitha kredive të bizneseve të prekura nga COVID-19. Këto MFI deklarojnë se rifinancimi ose financimi me kushte lehtësuese janë të vetmet programe që zbatohen për t'i ardhur në ndihmë biznesit të vogël dhe se nuk parashikojnë programe të tjera lehtësuese.

Pritshmëritë e grave sipërmarrëse për të ardhmen e afërt


Duke u goditur nga dy fatkeqësi të ndryshme në harkun kohor të 6 muajve, ndërmarrjet private kanë pasoja dhe nevoja të shumëfishta. Të pyetura mbi pritshmëritë e tyre për veprimtarinë ekonomike në të ardhmen e afërt, gratë sipërmarrëse vlerësojnë se pasojat kryesore në të gjitha aspektet i presin të ndodhin kryesisht në 6-mujorshin e parë (pra gjatë periudhës maj – tetor 2020) dhe në masë më të reduktuar nga nëntori 2020 e më tej.

Sikurse ka një masë të konsiderueshme që nuk e parashikojnë dot ecurinë e biznesit pikërisht për shkak të pasigurisë së krijuar nga pandemia COVID-19, kohëzgjatja e masave të qeverisë, ndryshimeve në vendimet e qeverisë për mbështetje ndaj biznesit, si dhe frika për rikthimin e një vale të dytë.

Më konkretisht, 20% e bizneseve parashikojnë ndërprerjen e pjesshme të veprimtarisë së tyre ekonomike gjatë periudhës maj – tetor 2020 dhe vetëm 5% ndërprerjen e plotë, ndërkohë që më pak se gjysma shprehen gjithsesi të pasigurt e që nuk mund ta parashikojnë. E megjithatë, pjesa më e madhe e grave sipërmarrëse janë optimiste se do të rifillojnë veprimtarinë ekonomike gjatë periudhës maj – tetor 2020 (40%) ose më pas (11%).

Gjysma e sipërmarrëseve parashikojnë uljen e xhiros dhe fitimeve të biznesit të tyre gjatë periudhës maj-tetor 2020, ndërkohë që për të njëjtën periudhë 32% e tyre besojnë se do të hasin vështirësi për sigurimin e lëndës së parë për prodhim, si pasojë edhe ulje të volumit të prodhimit (24%). Gati një e treta e tyre vlerësojnë se do të ndryshojnë portofolin e shërbimeve dhe produkteve që ofrojnë për të mbijetuar, ku 23% mendojnë se ky ndryshim do të ndodhë në periudhën maj-tetor 2020 dhe 10% pas tetorit 2020.

Grafiku 49: Pritshmëria për ecurinë e veprimtarisë ekonomike, prodhimit dhe shitjeve



Midis 29% dhe 46% e sipërmarrëseve nuk parashikojnë dot si dhe kur mund të veprojnë në lidhje me huamarrjen, kurse 1/4 do të shfrytëzojnë overdraftin e llogarive të tyre bankare bashkë me kartat e kreditit për të financuar biznesin në nevojë (18% gjatë periudhës maj-tetor 2020). Më pak se 1 në 5 gra sipërmarrëse do të aplikojnë për kredi nga institucionet financiare (15% gjatë periudhës maj-tetor 2020).


Ndërmarrjet me 10+ punonjës janë ato që parashikojnë në masë më të madhe aplikimin për kredi bankare (34%), nga të cilat 29% do të aplikojnë gjatë periudhës fillestare maj-tetor 2020. Kurse mikrobizneset me 2-9 punonjës do të aplikojnë dy herë më pak, respektivisht 17% në total dhe 14% gjatë periudhës maj-tetor 2020.

Teksa ulja e çmimeve të shërbimeve e produkteve që ofrojnë këto biznese shikohet si strategji më e mundshme përballimi se sa rritja e tyre (23% vs. 12%), gati 3 nga 10 biznese (29%) shohin si nevojë dhe mundësi investimin në teknologji për t'iu përgjigjur më mirë kërkesës së tregut dhe rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19.

Gjithashtu, 28% e bizneseve deklarojnë shkurtim personeli dhe 20% reduktim të pagave të tyre, masa të cilat parashikohen të aplikohen kryesisht në periudhën maj-tetor 2020.

Sërish këto masa do të jenë më të larta tek ndërmarrjet me 10+ punonjës, konkretisht 45% do të bëjnë shkurtim personeli dhe 30% do të reduktojnë pagat e punonjësve. Ndërkohë gjetjet tregojnë se 34% e mikrobizneseve me 2-9 punonjës do të shkurtojnë personel dhe 26% e tyre do të reduktojnë pagat e punonjësve.

Grafiku 50: Pritshmëria për nevojën për huamarrje, çmimet dhe personelin



Edhe pse rimëkëmbja e ekonomisë projektohet e vështirë nga institucionet mikrofinanciare të intervistuara, ato besojnë se shumica e bizneseve (rreth 50-80%) do të arrijnë të rimëkëmben, do të priren që të diversifikojnë gamën e produkteve dhe shërbimeve apo të aktivizojnë ide inovative.

Shanset për t'u rimëkëmbur vlerësohen të barabarta për sipërmarrjet e drejtuara nga gratë apo burrat. Megjithatë, rimëkëmbja e ekonomisë do të varet edhe nga menaxhimi i situatës nga qeveria shqiptare, nëse merr masa për heqjen e detyrimeve financiare të biznesit apo zbaton programe të fokusuara te lehtësimi fiskal, dhe sigurisht nëse vendi nuk detyrohet të futet sërish në izolim.

Nevojat dhe kërkesat për mbështetjen e grave sipërmarrëse pas dëmtimeve nga tërmetet e vjeshtës 2019 dhe COVID-19

Gratë sipërmarrëse të cilat morën pjesë në këtë studim shprehen se kanë tashmë nevoja të shumëfishta për të mbajtur hapur biznesin e tyre, për t'u rimëkëmbur e për t'u zhvilluar më tej.

Nevojat dhe kërkesat për politika lehtësuese që duhet të ndërmarrë qeveria shqiptare për të mbështetur bizneset private të dëmtuara nga tërmetet e vjeshtës 2019 dhe/ose pandemia COVID-19 janë disa. Ato kryesohen nga kërkesa e 72% e grave sipërmarrëse për të lehtësuar barrën fiskale ose reduktimin e TVSH-s dhe taksave (qendrore e vendore). Më specifikisht, disa sugjerojnë reduktimin e tatimeve dhe taksave nga pushteti qendror dhe ai lokal për një periudhë 6-12 mujore, disa sugjerojnë edhe shtyrjen e afateve për shlyerjen e këtyre detyrime, kurse të tjera vlerësojnë si të nevojshme "faljen" ose përjashtimin nga shlyerja e këtyre detyrimeve për të paktën 6 muaj, përfshi këtu periudhën e izolimit.

Kërkesat e tjera lidhen me lehtësimin ose reduktimin e kontributeve shëndetësore e shoqërore që bizneset duhet të paguajnë për personelin (39%), ofrimin e granteve dhe subvencioneve për bizneset në nevojë (37%) dhe lehtësimin e shlyerjes së qirave teksa përdorin pjesërisht ose aspak ambientet e biznesit (31%).

Grafiku 51: Politikat lehtësuese për bizneset që janë dëmtuar nga tërmeti dhe COVID-19



Edhe MFI-të e intervistuara besojnë se tejkalimi i vështirësive të shumta si pasojë e tërmeteve e COVID-19 dhe rimëkëmbja e ekonomisë në përgjithësi është e mundur nëse ka ndërhyrje shumëplanëshe: Qeveria, duke lehtësuar bizneset e vogla nëpërmjet uljes ose heqjes së taksave, reduktimit të taksave doganore, programeve për nxitjen e biznesit dhe eksporteve; institucionet bankare dhe mikrofinanciare, duke aplikuar masa lehtësuese kredi dhënie; dhe nga ana e tyre bizneset duke aplikuar teknologjitë digjitale dhe ide inovative.

Ofrimi i granteve dhe subvencioneve është një kërkesë kryesisht e bizneseve me 10+ punonjës (40%) apo mikrobizneseve me 2-9 punonjës (35%). Profesionistet e lira ose gratë e vetëpunësuara kërkojnë më tepër lehtësimin për shlyerjen e qirasë (35%) bashkë me mikrobizneset me 2-9 punonjës (31%) në krahasim me ndërmarrjet me 10+ punonjës (24%).

Kur flitet për ofrim grantesh e subvencionesh, gratë sipërmarrëse sugjerojnë vëmendje të veçantë për ndërmarrjet e vogla dhe profesionistet e lira apo sektorë të caktuar, si p.sh turizmi. Sipas tyre, shteti duhet të ofrojë fonde të dedikuara në formë granti për riparimin e godinave të dëmtuara dhe për blerjen e makinerive të dëmtuara nga tërmeti.

Lehtësimi për shlyerjen e qirasë është një kërkesë më e shpeshtë nga sipërmarrësët që operojnë në qarkun e Tiranës (37%) sesa ato në qarkun e Durrësit (25%) apo të Lezhës (22%).

Duke dëshiruar që të ruajnë përmasat e veprimtarisë së tyre private dhe të mos kenë efekte negative të mëdha tek personeli, gratë sipërmarrëse kërkojnë nga shteti mbështetje financiare dhe profesionale, si më poshtë:

- Bashkëfinancim për shlyerjen e kontributeve shëndetësore e shoqërore;
- Një paketë më të gjerë ndihmuese për shlyerjen e pagës së punonjësve;
- Shtrirjen kohore mininmalisht deri në fund të vjeshtës 2020 të "pagës së luftës";
- Kompensim më i lartë për pagën e punonjësve të prekur;
- Këshillim profesional për drejtuesit dhe stafin gjatë fazës së rimëkëmbjes;
- Informim dhe ofrim i shërbimeve profesionale për mirëqenien dhe kujdesin e shëndetit mendor për bizneset e prekura dhe punonjësit e tyre, kostot e të cilave duhet të mbulohen nga shteti dhe fondi i sigurimeve shëndetësore.

Teksa shteti harton paketat ekonomike lehtësuese dhe ndihmuese ndaj sektorit privat, gratë kërkojnë që të ketë një vëmendje të shtuar ndaj ndërmarrjeve të tyre, e sidomos ndaj bizneseve të vogla dhe atyre të reja (2 vitet e para të aktivitetit). Nga ana tjetër, kërkohet edhe zgjerimi i target grupit që mbështetet përmes këtyre paketave, duke përfshirë profesionet e lira dhe biznesin e madh, i cili punëson një numër të lartë punonjësish. Gjithashtu e rëndësishme të mos lihet mënjanë informimin dhe transparencën mbi ndryshimet ligjore dhe fondet që alokohen për rimëkëmbjen e bizneseve nga tërmeti dhe/ose pandemia COVID-19.

Përpos lehtësimeve fiskale dhe ndihmës ekonomike në forma të ndryshme (fonde, kredi etj.), në këto kohë të vështira, biznesi kërkon edhe mbështetje teknike për marketing e strategji komunikimi, veçanërisht për bizneset familjare ose ato të vogla.

Gjithashtu kërkohet promovim nga qeveria përmes portaleve online dhe fushatave, p.sh. “nëse do të kaloni pushimet në bregdet, gjeni listën e hoteleve ku mund të akomodoheni”; “nëse doni të hani një darkë, shikoni restorantet e zonës”; “nëse do të udhëtoni brenda vendit, mund të merrni një mjet me qira në këto agjenci”, e shumë shembuj të tjerë.

Së fundmi, disa biznese kërkojnë thjesht lehtësim ose relaksim të masave për lëvizjen e lirë brenda e jashtë vendit apo për organizimin e aktiviteteve me numër të lartë pjesëmarrësish, si dasma e funerale, që bizneset e tyre të vijojnë aktivitetin e ndalojnë humbjet e mëtejshme. Shtetit i kërkohet të sensibilizojë konsumatorin familjar me fushata edukuese për higjienë, distancë fizike etj., si dhe të nxisë rritjen e konsumit të mallrave e shërbime vendase me skema të ndryshme, si p.sh. kuponë me një vlerë të përcaktuar për çdo individ për t’u konsumuar në bare, restorante e hotele deri në fund të vitit etj.

KAPITULLI IV

REKOMANDIME

Gratë dhe bizneset e tyre në Shqipëri hasin vështirësi të ndryshme dhe barriera shoqërore, pjesërisht të ngjashme edhe me problematikat që hasin simotrat e tyre në botë. Në harkun kohor të më pak se një viti, ato janë ballafaquar edhe me problematika të shkaktuara nga tërmetet e vjeshtës së vitit 2019 dhe nga pandemia COVID-19 gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, efektet e të cilave pritet të zgjaten në kohë. Problematikat për biznesin shqiptar në përgjithësi dhe gratë sipërmarrëse në veçanti mund të rriten më tej, nëse nuk hartohen dhe zbatohen strategji me ndjeshmëri gjinore për t'i luftuar dhe tejkaluar këto barriera. Nevoja për ndërhyrje nga qeveria dhe institucionet financiare është emergjente në situatën e krijuar në vend, ndërkohë që deri tani përgjigjet e institucioneve ndaj pasojave të tërmetit dhe pandemisë nuk adresojnë në asnjë moment pabarazitë ekzistuese gjinore në sipërmarrje.

Më poshtë paraqiten disa rekomandime të mbështetura në gjetjet e këtij studimi, sikurse dhe sugjerimet e bëra nga vetë gratë sipërmarrëse. Disa prej këtyre masave janë parashikuar në strategjitë e deritanishme të qeverisë shqiptare, por nuk ka raporte vlerësuese se deri në çmasë janë zbatuar me sukses këto strategji dhe planet e tyre të veprimit.

Mbështetje e përgjithshme ndaj sektorit privat në Shqipëri

Plotësim i kuadrit ligjor dhe thjeshtim i procedurave administrative

Disa rekomandime të përgjithshme që ndihmojnë përmirësimin e klimës së biznesit dhe fuqizojnë bizneset e ndershme, të drejtuara nga gra e burra, lidhen me luftën efikase ndaj informalitetit në sektorin privat dhe korrupsionit në radhët e administratës shtetërore, plotësimin e kuadrit rregullator dhe qëndrueshmërinë e politikave fiskale, sikurse edhe zbatimin e ligjeve në mënyrë korrekte dhe të paanshme.

Heqja e pengesave ekzistuese dhe praktika të thjeshtuara që lehtësojnë marrëdhënien e biznesit me administratën shtetërore, p.sh në procedurat e tenderimit publik, duke mënjanuar kërkesat e shtuara për dokumentacion, kriteret disproporcionale dhe afatet e shkurtra të aplikimit.

Korniza ligjore dhe detyrimet për biznesin duhet të jenë sa më të qarta e të thjeshta. Në këtë mënyrë qeveria mund të sigurojë një mjedis barazie dhe të konkurrencës së lirë e të drejtë, dhe sipërmarrësit mund të kenë siguri për zhvillimin e biznesit dhe të parashikojnë tregun.

Mbështetje për aksesin në financim

Ndërmarrjet e reja në hapat e para, sikurse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përgjithësisht mbështeten te huadhënia ose kredia bankare, por fatkeqësisht kjo shpesh bëhet e vështirë për t'u miratuar. Pa fonde të përshtatshme dhe pa likuiditet, asnjë biznes nuk mund të operojë dhe të rritet, ndaj duhet të ofrohen mundësi alternative huadhënieje.

Rimbursimi i TVSH është gjithashtu një e drejtë që qeveria shqiptare duhet të zbatohet në praktikë, duke lehtësuar mungesën e likuiditetit të bizneseve.

Mbështetje teknike për sektorin privat: me trajnime, shërbime ligjore, këshillime, promovim

Aplikimi i modelit "one stop shop" për të gjitha shërbimet e mbështetjes së biznesit: mentorimi, lehtësimi dhe këshillimi për qasjen në financime jo/tradicionale, për qasjen në inkubatorë e përshpejtuesit e biznesit, për trajnime, për aktivitete promovues, për informim e këshillim mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) etj.

Programi i trajnimit për sipërmarrjen duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe me larmi tematikash: si krijohet dhe menaxhohet një biznes; aftësitë e nevojshme menaxheriale dhe njohuritë bazë mbi aspektet financiare, ligjore, të marketingut e burimeve njerëzore etj. Trajnimet duhet të përshtaten sipas kategorive, si p.sh. të rinjtë, gratë, bizneset e reja etj.

Kjo qendër duhet të shërbejë si një pikë ndërlidhje mes sipërmarrësve të suksesshëm, gra e burra dhe të rinjve e bizneseve të reja, duke krijuar një marrëdhënie mentorimi e shkëmbimi mes tyre.

Transparencë për programet e mbështetjes ndaj biznesit

Qeveria duhet të bëjë transparencë mbi programet mbështetëse, financiare e teknike, duke përdorur kanale të ndryshme dhe të sigurojë që mesazhi arrin çdo sipërmarrës: publikimi i grupuar i të gjitha programeve dhe përfituesve në një portal të vetëm për sipërmarrjen; njoftime të drejtpërdrejta për çdo sipërmarrës përmes broshurave që mund të dërgohen me postë; aktivitete informuese në çdo bashki apo përmes dhomave të tregtisë e organizatave të tjera të biznesit.

Institucionet dhe fondacionet që ofrojnë këto programe mbështetëse duhet t'u japin aplikantëve kohë të mjaftueshme, minimalisht 4-5 javë, për të dorëzuar aplikimin, duke konsideruar edhe ata sipërmarrës që kanë më pak përvojë në kërkesa për grante, mbështetje teknike a projekte.

Edukim masiv

Sipërmarrësit janë një burim i çmuar për rritjen e punësimit, ndaj ia vlen të investosh në arsimimin dhe zhvillimin e tyre. Qeveria duhet të pasurojë kurrikulat e arsimit, të mesëm e të lartë, me tema e programe praktike mbi sipërmarrjen private, duke ndihmuar të rinjtë, djem e vajza, të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ngritur e menaxhuar një aktivitet privat.

Për të përforcuar kulturën e sipërmarrjes, është e nevojshme promovimi i sipërmarrësve, gra e burra, përmes fushatave pozitive mbi arritjet dhe vlerën e tyre për shoqërinë. Pra, të rritet vizibiliteti i tyre dhe të paraqiten larmi profilesh gjinore, moshore apo mënyrat e rrugët e ndjekura për të arritur drejt suksesit.

Mbështetje e dedikuar për gratë sipërmarrëse

Është e rëndësishme të hartohen politika publike dhe plane veprimi që nxisin gratë sipërmarrëse, duke mundësuar rritjen e numrit të tyre dhe për të kontribuar në zhvillimin e suksesshëm të tyre, sikurse qeveria ka parashikuar në SZHBI 2014-2020 apo SKBGJ 2016-2020. Politika të tilla kërkojnë një përqasje shumëplanëshe që mbështesin barazinë gjinore, sikurse përmirësojnë klimën e përgjithshme të të bërit biznes në Shqipëri.

Politikat mbi arsimin, punësimin, taksimin dhe politikat e financimit duhet të nxisin iniciativat e grave sipërmarrëse, sikurse politikat sociale duhet të mbështesin gratë që punojnë apo drejtojnë biznese private. Disa politika sociale që i mundësojnë grave të arrijnë një ekuilibër midis jetës familjare dhe punës ose biznesit përfshijnë: leja e lindjes prindërore për të dy prindërit, shërbimet cilësore dhe ekonomikisht të përballueshme për kujdesin e fëmijëve në çerdhe e kopshte apo kujdesin e të moshuarve, puna me orare fleksibël, nisma edukuese për të adresuar stereotipet kulturore.

Rekomandimet e mësipërme, për të plotësuar kuadrin rregullator, për të thjeshtuar procedurat administrative, për të ofruar mbështetje financiare e teknike për bizneset dhe transparencë, janë të gjitha në dobi të klimës së përgjithshme, sikurse edhe të sipërmarrjes femërore. Megjithatë, ndërmarrjet e drejtuara nga gratë duhet të mbështeten në mënyrë të veçantë përmes politikave dhe programe gjinore, duke i ndihmuar ato të tejkalojnë ato barriera ligjore, sociale e teknike që vazhdojnë janë prezente në mjedisin shqiptar.

- Lehtësira fiskale e mbështetje me grante dhe kredi të buta, veçanërisht në vitet e para të biznesit;
- Mbështetje teknike përmes shërbimeve profesionale ligjore, organizative, marketing etj.
- Fushata informuese e ndërgjegjësuese për programet aktuale dhe programet e reja me fokus në sipërmarrjen femërore;
- Krijimi i një organizmi kombëtar për gratë sipërmarrëse, duke bashkuar burimet dhe energjitë e të gjithë atyre rrjeteve të deritanishme në nivel lokal ose kombëtar, që synon shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mbështetjen reciproke;

- Aktivitete që shtojnë ndërveprimin dhe qasjen e grave sipërmarrëse në rrjete e forume të ndryshme për qëllime biznesi; përforcimin e marrëdhënieve në grupe biznesi midis sipërmarrësve të të dyja gjinive; si dhe përfshirje më e lartë në projekte e nisma për biznesin e vogël, startup-et apo inovacionin;
- Promovimi i sipërmarrjes femërore në media duke pasqyruar informacion të qartë dhe tërheqës për sfidat dhe përfitimet e një karriere sipërmarrëse mes grave; promovim përmes revistave, blogjeve e botimeve, duke paraqitur shembuj suksesi dhe duke nxitur sipërmarrjen si karrierë tek vajzat e reja;
- Krijimi i një platforme online të dedikuar tek sipërmarrja private dhe gratë drejtuese, si qendër informacioni, mentorimi, këshillimi e mbështetjeje, si platformë promovimi dhe ndërlidhëse (networking) mes grave sipërmarrëse;
- Mbledhja e të dhënave gjinore dhe publikimi i azhurnimeve vjetore mbi situatën e grave sipërmarrëse në shkallë vendi e më të detajuara për qark e bashki, për të evidentuar pengesat rajonale, si dhe progresin e politikave publike në këtë drejtim;
- Studimi periodik i sipërmarrjes femërore, vështirësitë me të cilat ato hasen dhe nevojat që ato kanë është po aq i nevojshëm për t'u thelluar në ecurinë e tyre dhe për të ndërtuar politika e plane veprimi efikase për t'i mbështetur ato drejt suksesit.

Përgjigje e koordinuar për rimëkëmbje e rindërtim të sektorit privat

Duke konsideruar situatën e vështirë në të cilën po kalon sektori privat në Shqipëri që prej tërmetit të nëntorit 2019 dhe të përkeqësuar më tej nga COVID-19, nevojitet një reagim i koordinuar dhe shumëplanësh, pra duke krijuar një program i përbashkët që adreson të dyja fatkeqësitë.

Fillimisht sugjerohet të kryhet vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga tërmeti dhe COVID-19 për çdo sektor e ndërmarrje, e më pas hartimi i një programi "për rimëkëmbje dhe rindërtim" që adreson nevojat respektive.

Plotësimi i shpejtë i kuadrit ligjor për zbatimin e politikave lehtësuese e mbështetëse, si dhe monitorimi i zbatimit të këtij programi janë të nevojshme. Qeveria duhet gjithashtu të konsolidojë më tej procedurat administrative të zbatimit të paketave financiare anti-COVID dhe asaj të tërmetit për mbështetjen ndaj biznesit.

Qeveria shqiptare, në bashkëpunim me institucionet financiare, duhet të ofrojë mbështetje financiare të targetuar për ndërmarrjet e prekura nga tërmeti dhe COVID-19, siç janë kreditë e zbutura me interesa të ulëta dhe afate të gjata shlyerje, grante e subvencione, lehtësim të barrës fiskale, lehtësim ose bashkëfinancim të kontributeve shëndetësore e shoqërore, sikurse të shtrijë efektet e paketave ekzistuese. Në këtë mënyrë do mund të kontrollohen pasojat dhe të mbahet në nivele sa më të ulëta falimentimi i ndërmarrjeve apo shtimi i numrit të të papunëve.

Hartimi i procedurave të qarta e të thjeshta për bizneset, mbështetje teknike për plotësimin e aplikimit dhe transparencë në procedurën e vlerësimit të çdo rasti.

ANEKSE

Aneksi A – Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabela nr.	Emërtimi i tabelës	Nr. Fq.
Tabela 1	Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë, viti 2019	10
Tabela 2	Ndërmarrjet aktive me pronar / administrator femër ndër vite (2012 – 2019)	13
Tabela 3	Hendeku financiar sipas qëllimit strategjik dhe objektivave, SKBGJ 2016-2020	22
Tabela 4	Dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga tërmeti 26.11.2019 për nënsektorët e Pro-dhimit	26

Grafiku nr.	Lista e grafikëve	Nr. Fq.
Grafiku 1	Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, grupmosha 15-64 vjeç (në %)	12
Grafiku 2	Shkalla e punësimit te grupmosha 15-64 vjeç (në %)	13
Grafiku 3	Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç sipas gjinisë, viti 2018-2019	13
Grafiku 4	Ecuria e ndërmarrjeve aktive dhe sipërmarrjes femërore ndër vite, 2010-2019	15
Grafiku 5	Raporti gjinor i sipërmarrësve, viti 2019	16
Grafiku 6	Madhësia e bizneseve në total dhe ato të drejtuara nga gratë, viti 2019	16
Grafiku 7	Shpërndarja gjeografike e ndërmarrjeve aktive në total vs. ndërmarrjeve me pronar / administrator femër, viti 2019	17
Grafiku 8	Ndryshimet në faktorët dhe rrethanat e financimit, prill-shtator 2019	19
Grafiku 9	Problemet kryesore për NVM-t, prill-shtator 2019	20
Grafiku 10	Ndryshimet në treguesit e biznesit në Shqipëri, prill – shtator 2019	21
Grafiku 11	Arsyeja kryesore përse kreditë bankare nuk janë të përshtatshme	21
Grafiku 12	Rritja e ndërmarrjeve sipas qarkullimit vjetor 2016-2018 vs pritshmërive për rritjen e këtij qarkullimi gjatë periudhës 2019-2021	22
Grafiku 13	Përfitues të skemave mbështetëse nga AIDA, në total dhe sipas gjinisë 2019	28
Grafiku 14	Dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga tërmeti 26.11.2019 sipas sektorëve	31
Grafiku 15	Shpërndarja e bizneseve të dëmtuara nga tërmeti i 26.11.2019 sipas bashkive	33
Grafiku 16	Përfituesit e pagës së luftës dhe përfituesit e Paketës 2	37
Grafiku 17	Përfituesit nga Garancia sovrane I dhe II	38
Grafiku 18	Pozicioni i pjesëmarrëseve në kompani	43
Grafiku 19	Grupmosha	43
Grafiku 20	Arsimi	43

Grafiku nr.	Emërtimi i Grafikut	Nr. Fq.
Grafiku 21	Zona ku pjesëmarrëset zhvillojnë aktivitetin privat	44
Grafiku 22	Madhësia e biznesit sipas numrit të punonjësve	44
Grafiku 23	Sektori	45
Grafiku 24	Pronësia e biznesit	45
Grafiku 25	Koha e biznesit në treg	45
Grafiku 26	Gjendja e aktivitetit privat përpara nëntorit 2019, sipas madhësisë së biznesit	51
Grafiku 27	Gjendja e aktivitetit privat përpara nëntorit 2019, sipas qarkut	51
Grafiku 28	Vështirësitë e zakonshme të ndërmarrjeve private drejtuar nga gratë	52
Grafiku 29	Vështirësitë në financim	53
Grafiku 30	Vështirësitë në marketing dhe shitje	53
Grafiku 31	Vështirësitë në prodhim dhe aspektin teknik	54
Grafiku 32	Vështirësitë në tregun e punës dhe burimet njerëzore	54
Grafiku 33	Vështirësitë në legjislacion dhe detyrimet shtetërore	55
Grafiku 34	Vështirësitë sociale e të tjera	56
Grafiku 35	Vështirësitë e përgjithshme të biznesit vs. shkaqeve gjinore	57
Grafiku 36	Favorizimi gjinor i sipërmarrësve përmes politikave publike dhe mjedisit të biznesit	58
Grafiku 37	Mbështetja e sipërmarrëjes së grave nga aktorë të ndryshëm, në total	59
Grafiku 38	Mbështetja e sipërmarrjes së grave nga aktorë të ndryshëm, sipas madhësisë së biznesit	59
Grafiku 39	Mbështetja e sipërmarrjes së grave nga aktorë të ndryshëm ndër vite	60
Grafiku 40	Aktivitetet prioritare për të mbështetur gratë sipërmarrëse në Shqipëri	62
Grafiku 41	Ndikimi i tërmeteve në aktivitetin privat të drejtuar nga gratë	64
Grafiku 42	Pasojat negative të tërmeteve 2019 te bizneset e drejtuar nga gratë	65
Grafiku 43	Ndikimi i COVID-19 në aktivitetin privat të drejtuar nga gratë	66
Grafiku 44	Pasojat negative të COVID-19 në bizneset e drejtuar nga gratë	67
Grafiku 45	Niveli i mbështetjes së sipërmarrëseve nga qeveria pas tërmetit nëntor 2019	69
Grafiku 46	Mbështetja konkrete e grave sipërmarrëse nga qeveria pas tërmetit nëntor 2019	69
Grafiku 47	Niveli i mbështetjes së grave sipërmarrëse nga qeveria, mars-qershor 2020	70
Grafiku 48	Mbështetja konkrete e grave sipërmarrëse nga qeveria, mars – qershor 2020	72
Grafiku 49	Pritshmëria për ecurinë e veprimtarisë ekonomike, prodhimit dhe shitjeve	72
Grafiku 50	Pritshmëria për nevojën për huamarrje, çmimet dhe personelin	73
Grafiku 51	Politikat lehtësuese për bizneset që janë dëmtuar nga tërmeti e COVID-19	74

ANEKSI B – PYETËSORI SASIOR ME GRATË SIPËRMARRËSE

Shoqata "Together for Life" po zhvillon një studim mbi gratë sipërmarrëse dhe përvojat e tyre në tregun shqiptar. Plotësimi i këtij pyetësori merr rreth 10 minuta. Gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra nga ky studim do të përdoren për të lobuar pranë pushteti lokal e qëndror për krijimin e programeve mbështetese të bizneseve të drejtuara nga gratë. Mendimet tuaja janë të rëndësishme për ne dhe përgjigjet tuaja do të mbeten anonime e konfidenciale, në respekt të plotë të Kodit Etik të hartuar nga ICC/ESOMAR (Dhoma Ndërkombëtare e Tregtësitë / Organizata Evropiane për Studime të Opinionit Publik dhe Hulumtime Tregu e Marketingu). Nëse dëshironi të bëni pauzë e vazhdoni plotësimin e pyetësorit më vonë, thjesht mbyllni këtë faqe e më vonë klikoni tek linku që ju kemi dërguar në e-mail ose mesazh.

P.1 Cila është gjinia juaj?

◊ Femër

◊ Mashkull (INTERVISTA NDËRPRITET)

P.2 Cila është grupmosha juaj?

◊ Nën 18 vjeç (INTERVISTA NDËRPRITET)
◊ 18-24
◊ 25-29
◊ 30-39
◊ 35-39
◊ 40-49
◊ 50-55
◊ 56-65
◊ Mbi 65 vjeç

P.3 Cili është niveli më i lartë arsimor që ju keni mbaruar?

◊ Arsim bazë
◊ Arsim i mesëm i përgjithshëm
◊ Arsim i mesëm profesional
◊ Arsim i lartë universitet (bachelor)
◊ Arsimi i lartë pasuniversitar (master, phd)

4 Cila nga alternativat e përshkruan më mirë situatën tuaj të punësimit?

◊ E vetëpunësuar - menaxhoj biznesin tim pa të punësuar të tjerë
◊ Pronare ose bashkëpronare dhe njëkohësisht menaxhere e biznesit tim ku kam edhe persona të tjerë të punësuar
◊ Menaxhere e një biznesi, ku ka edhe persona të tjerë të punësuar
◊ Pronare ose bashkëpronare e një biznesi, por nuk përfshihem aspak në menaxhimin e kompanisë (INTERVISTA NDËRPRITET)
◊ Jam e punësuar, por nuk jam administrator apo menaxhere e përgjithshme (INTERVISTA NDËRPRITET)
◊ Jam e papunë ose shtëpiake (INTERVISTA NDËRPRITET)
◊ Tjetër, shkruaj **…**

P.5 Sa punonjës me kohë të plotë ose të pjesshme ka gjithsej biznesi juaj? Përfshi këtu edhe veten tuaj, dhe të gjithë punonjësit në të gjitha degët brenda Shqipërisë

◊ Vetëm 1, unë (e vetëpunësuar)
◊ 2-4
◊ 5-9
◊ 10-49
◊ 50 -249
◊ 250 ose më shumë

P.6 Në cilën zona e zhvillon aktivitetit e saj kompania juaj? Zgjidh të gjitha zonat ku gjenden selia qendrore, fabrika, magazina apo pikat e shitjes së kompanisë tuaj.

◊ Tiranë
◊ Kamëz
◊ Vorë
◊ Kavajë
◊ Rrogozhinë
◊ Durrës
◊ Shijak
◊ Krujë
◊ Fushë-Krujë
◊ Lezhë
◊ Shëngjin
◊ Kurbin
◊ Mirditë
◊ Në zona të tjera të Shqipërisë
◊ Në të gjithë Shqipërinë
◊ Jashtë Shqipërisë
◊ Shkruaj në koment nëse nuk e gjeni alternativën tuaj…

P.7 Cili është sektori ose aktiviteti kryesor i kompanisë tuaj? Nëse kompania juaj ka disa aktivitete, ju lutem përzgjidhni atë kryesor.

◊ Bujqësi e blegtori, pyje, gjueti e peshkim
◊ Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
◊ Industri nxjerrëse (miniera etj.)
◊ Industri përpunuese
◊ Industri e lehtë (industri tekstile)
◊ Artizanat
◊ Ndërtim
◊ Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
◊ Tregti me shumicë ose pakicë, riparim automjetësh motoçikletash
◊ Transport (mallrash / njerëzish) e magazinim
◊ Akomodim / hoteleri
◊ Shërbim ushqimor (restorante, catering etj.)
◊ Art, argëtim e zbavitje (bar-kafe, qendër lojërash, palestër, etj. etj.)
◊ Agjenci udhëtimi / operator turistik
◊ Informacion dhe komunikacion (posta, telefoni, internet, tv, media)
◊ Aktivitete financiare dhe të sigurimit
◊ Aktivitete të pasurive të patundshme (real estate)
◊ Aktivitete profesionale, shkencore e teknike
◊ Shërbime administrative dhe mbështetëse
◊ Shërbime riparimi (kompjuterë, celularë, pajisje elektroshtëpiake etj.)
◊ Arsim
◊ Shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale
◊ Shërbime të tjera, shkruaj ...

P.8 Cila alternativë e përshkruan më mirë pronësinë e kompanisë tuaj?

◊ Pronësi shqiptare

◊ Pronësi e huaj që operon në Shqipëri (degë, zyrë përfaqësie, shpk etj.)

◊ Pronësi e përbashkët, shqiptare dhe e huaj

P.9 Prej sa vitesh është aktive kompania juaj në Shqipëri?

◊ Prej 6 muajsh

◊ Prej 7-12 muajsh

◊ Mbi 1 vit – deri në 3 vjet

◊ Mbi 3 vjet – deri në 5 vjet

◊ Mbi 5 vjet – deri në 10 vjet

◊ Mbi 10 vjet

Ky seksion përmban disa pyetje për situatën e biznesit përpara Tërmetit dhe COVID-19

Në disa tabela në vijim kemi përmbledhur vështirsitë kryesore që hasin bizneset në fusha të ndryshme. Ju lutem për secilën tabelë specifikoni si më poshtë

A. Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat përballet biznesi juaj zakonisht (përpara corona virusit ose tërmetit të nëntorit 2019)?
B. Cilat janë vështirësitë që besoni se vijnë si pasojë e faktit që ju si drejtuese grua ose vajzë?

P.10 Vështirësi në financim

Alternativat

◊ Vështirësi në sigurimin e informacionit për kredi, grante, subvencione etj.

◊ Nuk kam kolateral të mjaftueshëm ose nuk kam pasuri të patundshme në emrin tim

◊ Procedura të vështira për të marrë kredi

◊ Interesa të larta të kredive bankare

◊ Vështirësi në gjetjen e fondeve për të zgjeruar biznesin apo për të filluar një biznes të ri

◊ Mungesa e kredive të zbutura për bizneset e reja ose bizneset e vogla

◊ Probleme likuiditeti për shkak të shlyerjeve të vonuara nga klientët ose shlyerjeve me clearing

◊ Tjetër, shkruaj**….**

◊ Asnjë nga sa më sipër / Nuk vlen për biznesin tim / Nuk e di

Nënpyetjet

a) Vështirësitë që biznesi ka hasur

b) Vështirësitë si sipërmarrëse grua

P.11 Vështirësi në marketing dhe shitje

Alternativat

◊ Konkurrenca e ashpër

◊ Luhatja e kërkesës për produkte e shërbime (klientela)

◊ Informalitet i lartë në sektorin tim (konkurrentë informal të paregjistruar, mosdeklarimi i punonjësve etj.)

◊ Mungesë orientimi për mënyrën e marketingut

◊ Kosto e lartë marketingu

◊ Vështirësi në sigurimin e informacionit për mundësi eksporti etj.

◊ Mungesë njohurish për të hyrë në tregje të reja

◊ Mungesa e një rrjeti mbështetës (kontakte, partneritete etj.)

◊ Tjetër, shkruaj **.....**

◊ Asnjë nga sa më sipër / Nuk vlen për biznesin tim / Nuk e di

Nënpyetjet

a) Vështirësitë që biznesi ka hasur

b) Vështirësitë si sipërmarrëse grua

P.12 Vështirësi në prodhim dhe aspektin teknik

Alternativat

◊ Vështirësi për sigurimin e lëndës së parë

◊ Vështirësi për të gjetur ambiente të përshtatshme për biznesin tim

◊ Nevoja për investime të vazhdueshme për t'ju përshtatur teknologjive të reja

◊ Vështirësi për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive dhe pajisjeve të biznesit

◊ Tjetër, shkruaj **…**

◊ Asnjë nga sa më sipër / Nuk vlen për biznesin tim / Nuk e di

Nënpyetjet

a) Vështirësitë që biznesi ka hasur

b) Vështirësitë si sipërmarrëse grua

P.13 Vështirësi në tregun e punës dhe burimet njerëzore

Alternativat

◊ Mungesë stafi të kualifikuar dhe me përvojë

◊ Kërkesë për paga të larta e bonuse

◊ Qarkullim i shpeshtë i punonjësve (largime, leje lindje etj.)

◊ Mungesë trajnimi për veten dhe/ose stafin

◊ Tjetër, shkruaj **…**

◊ Asnjë nga sa më sipër / Nuk vlen për biznesin tim / Nuk e di

Nënpyetjet

a) Vështirësitë që biznesi ka hasur

b) Vështirësitë si sipërmarrëse grua

P.14 Vështirësi me legjislacionin dhe detyrimet shtetërore

Alternativat

◊ Kuadri ligjor (ka mungesa ligjesh e aktesh normative etj.)

◊ Ndryshimet e vazhdueshme në sistemin fiskal nga ana e qeverisë

◊ Taksa e tatime të larta

◊ Inspektime të shpeshta nga administrata tatimore

◊ Mosrimbursimi i TVSH-s nga qeveria

◊ Korrupsion në radhët e administratës shtetërore (tatime, dogana etj.)

◊ Tjetër, shkruaj **…**

◊ Asnjë nga sa më sipër / Nuk vlen për biznesin tim / Nuk e di

Nënpyetjet

a) Vështirësitë që biznesi ka hasur

b) Vështirësitë si sipërmarrëse grua

P.15 Vështirësi sociale e të tjera

Alternativat

◊ Prezenca dominuese e meshkujve në sektorin e biznesit

◊ Mjedisi i biznesit nuk është shumë favorizues (mungesë besimi nga parterët apo furnitorët, nga investitorët etj.)

◊ Mosmbështetja e sipërmarrësit/es nga ana e familjes për të filluar një biznes privat

◊ Balanca midis biznesit dhe familjes (detyrimet, nevojat dhe pritshmëritë e rolit të gruas/burrit brenda familjes)

◊ Ngacmime verbale ose seksuale gjatë ndërveprimit me partnerët e biznesit, furnitorët etj.

◊ Tjetër, shkruaj **…**

◊ Asnjë nga sa më sipër / Nuk vlen për biznesin tim / Nuk e di

Nënpyetjet

a) Vështirësitë që biznesi ka hasur

b) Vështirësitë si sipërmarrëse grua

P.16 Sa favorizuese janë politikat publike dhe mjedisi i biznesit për gratë përkundrejt burrave që menaxhojnë një aktiviteti privat?

◊ Promovimi i sipërmarrjes private

◊ Sigurimi i financimit

◊ Pjesëmarrja në shoqata dhe grupe biznesi

◊ Mundësia për të hyrë në mjedise biznesi (forume, panaire, etj)

◊ Mundësia për të hyrë në treg / tregje të reja

◊ Qasja në edukim dhe trajnim për menaxhimin e ndërmarrjeve private

◊ Fitimi i tenderave publikë dhe koncesioneve

Shkalla e përgjigjes

◊ Më shumë favorizuese për gratë sipërmarrëse

◊ Më shumë favorizuese për burrat sipërmarrës

◊ Njëlloj favorizuese për të dyja gjinitë

◊ Aspak favorizuese për të dyja gjinitë

◊ Nuk e di

P.17 Si do të përshkruanit situatën e biznesit tuaj përpara nëntorit 2019?

◊ Aktivitet i lartë dhe fitime të mira

◊ Aktivitet dhe fitime mesatare

◊ Aktivitet dhe fitime të ulëta

P.18 Çfarë aktivitetesh do të sugjeronit për të mbështetur gratë sipërmarrëse në Shqipëri?

Ju lutem shprehni të gjitha sugjerimet tuaja **.....**

P.19 Cila prej këtyre aktiviteteve janë prioritare për të mbështetur gratë sipërmarrëse në Shqipëri? Zgjidh 3 më kryesoret.

◊ Mundësi financimi për gratë sipërmarrëset si grante për fillim biznesi, kredi me interes të ulët, garanci për kredi etj.

◊ Ofrimi i informacionit, trajnimeve dhe asistencës teknike për gratë sipërmarrëset për financim eksportesh, gjetja e tregjeve të reja, etj,

◊ Rritja e sasisë së mikro-kreditimit.

◊ Ofrimi i informacionit, trajnimeve dhe asistencës teknike për akreditim, certifikim, standardizim, patenta dhe marka tregtare.

◊ Krijimi i një portali online për gratë sipërmarrëse me informacione, këshillime, aktivitete etj.

◊ Krijimi i inkubatorëve të biznesit që ofrojnë hapësirë fizike, informacion, trajnim për gratë sipërmarrëse

◊ Mbështetja e grave për të shitur produktet e tyre në tregje e kanale të reja

◊ Mbështetja e grave për të marrë pjesë në ekspozita e panaire tregtare në Shqipëri dhe më tej

◊ Publikimi i një katalogu me bizneset e drejtuara nga gratë

◊ Organizimi i aktiviteteve për të përforcuar rrjetin e grave sipërmarrëse (njohjen, promovimin dhe ndërveprimin me to)

◊ Tjetër, shkruaj **@ .....**

Tërmetet vjeshtë 2019 dhe Pandemia COVID-19

P.20 Si u ndikua biznesi juaj nga tërmeti i 21 shtatorit dhe 26 nëntorit 2019?

◊ Nuk patëm asnjë ndikim (as për mirë, as për keq)

◊ Ndikim shumë negativ

◊ Ndikim disi negativ

◊ Ndikim disi pozitiv

◊ Ndikim shumë pozitiv

P.21 Konkretisht, cilat ishin pasojat e këtij tërmeti në rrjedhën e aktivitetit tuaj të biznesit?

◊ Nuk patëm asnjë ndikim (as për mirë, as për keq)

PASOJA NEGATIVE

◊ Pezullim ose mbyllje e përkohshme e biznesit

◊ Ndërprerje e plotë e veprimtarisë tuaj ekonomike

◊ Dëmtim i ambientit të biznesit (fabrikës, dyqanit, zyrës etj.)

◊ Dëmtim i makinerive ose pajisjeve të tjera

◊ Dëmtim fizik ose shëndetësor i punonjësve gjatë punës

◊ Ulje e numrit të punonjësve

◊ Ulja e pagave të personelit

◊ Ulja e volumit të prodhimit

◊ Ulje e xhiros dhe fitimeve

◊ Aplikim për kredi nga banka ose institucione të tjera financiare

◊ Kërkesë hua nga individë (familjarë, miq, të njohur etj.)

PASOJA POZITIVE

◊ Porosi të shtuara, shitje të shumta, apo klientelë e re

◊ Shtim i numrit të punonjësve

◊ Rritja e xhiros dhe fitimeve

◊ Shtimi i portofolit me produkte / shërbime të reja

◊ Investime në teknologji (makineri të reja, pajisje, programe etj.)

◊ Tjetër, shkruaj **.....**

P.22 Si u ndikua biznesi juaj nga pandemia COVID-19 dhe masat izoluese të ndërmarra nga qeveria?

◊ Nuk patëm asnjë ndikim (As për mirë, as për keq)

◊ Ndikim shumë negativ

◊ Ndikim disi negativ

◊ Ndikim disi pozitiv

◊ Ndikim shumë pozitiv

P.23 Konkretisht, mund të rendisni pasojat të këtij virusi në rrjedhën e aktivititetit tuaj të biznesit?

- ◊ Nuk patëm asnjë ndikim (as për mirë, as për keq)
- ◊ PASOJA NEGATIVE
- ◊ Pezullim ose mbyllje e përkohshme e biznesit
- ◊ Bllokim i plotë i veprimtarisë ekonomike gjatë pandemisë
- ◊ Vështirësi për sigurimin e lëndës së parë
- ◊ Ulja e volumit të prodhimit
- ◊ Ulje e xhiros dhe fitimit
- ◊ Kosto e shtuar për kushtet higjieno-sanitare dhe dezinfektimin në ambientet e punës
- ◊ Kosto e shtuar sigurimin e mjeteve dhe shërbimeve të komunikimit në distancë me punonjësit
- ◊ Vështirësi për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe palëve të treta
- ◊ Ulje e numrit të punonjësve
- ◊ Ulja e pagave të personelit
- ◊ Aplikim për kredi nga banka ose institucione të tjera financiare
- ◊ Kërkesë hua nga individë (familjarë, miq, të njohur etj.)
- ◊ PASOJA POZITIVE
- ◊ Shtimi i portofolit me produkte / shërbime të reja
- ◊ Porosi të shtuara / Shitje të shumta, Klientelë e re
- ◊ Rritja e xhiros dhe fitimeve
- ◊ Shtim i numrit të punonjësve
- ◊ Investime në teknologji (pajisje e programe të reja, makineri etj.)
- ◊ Tjetër, shkruaj ....

P.24 Cilat janë nevojat tuaja si biznes për mbështetje si rrjedhojë e ndikimit të tërmetit vjeshtë 2019 dhe/ose pandemisë covid19?

Ju lutem shprehuni sa më qartë dhe me sugjerime konkrete **.....**

P.25 A ka përfituar kompania juaj nga ndonjë mbështetje ose program i veçantë nga aktorët e mëposhtëm?

Alternativat

- ◊ Nga qeveria shqiptare (fonde publike)
- ◊ Nga bankat ose institucionet e mikro-kredive
- ◊ Nga organizatat e donatorët vendas
- ◊ Nga donatorët e huaj
- ◊ Nga bashkëpunimi midis disa aktorëve (qeveria, donatorët, bankat etj.)
- ◊ Tjetër, shkruaj .....

Shkalla e përgjigjes

- ◊ Po, Dhjetor 2019 – aktualisht
- ◊ Po, Janar-Nëntor 2019
- ◊ Po, gjatë vitit 2014-2018
- ◊ Po, më herët se viti 2014
- ◊ Jo, nuk ka përfituar ndonjëherë

P.26 Më konkretisht, çfarë mbështetje ka përfituar kompania juaj nga qeveria shqiptare (pushteti qendror ose lokal)?

PAKETA NDIHMUESE E QEVERISË PREJ PANDEMISË COVID19

- ◊ Përfitim i "pagës së luftës", si e vetëpunësuar
- ◊ Përfitimi i shumës prej 40 mijë lekësh për periudhën Prill-Qershor 2020
- ◊ Rimbursimin e pjesshëm të pagës së punonjësve
- ◊ Rimbursimin e detyrimeve për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore
- ◊ Kompensim i pagesës së qerasë dhe tatimit në burim i qiradhënësit

◊ Shtyrja për deklarimet e bilanceve

◊ Shtyrjen e afatit për shlyerjen e kredive dhe interesave bankare

◊ Tjetër, shkruaj **.....**

PAKETA NDIHMUESE E QEVERISË PREJ TËRMETIT VJESHTË 2019

◊ Përjashtim nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve për rindërtimin

◊ Heqja e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për materialet e ndërtimit për përdorim të brendshëm dhe ato që do të importohen

◊ Njohja e shpenzimeve në bilancet e bizneseve për dëmet materiale, mallrave, ndërtesave dhe të çdo shpenzimi të kryer për rindërtim

◊ Tjetër, shkruaj **.....**

MBËSHTETJE OSE PROGRAM TJETËR NGA QEVERIA

◊ Tjetër, shkruaj ....

◊ Jo, nuk ka përfituar

P.27-28 Cilat nga aktivitetet e mëposhtme parashikoni të ndodhin me biznesin tuaj në 6 muajt e ardhshëm (maj - tetor'20) apo pas 7 muajve (nëntor'20 e më tej)?

◊ Ndërprerje e pjesshme e veprimtarisë tuaj ekonomike

◊ Ndërprerje e plotë e veprimtarisë tuaj ekonomike

◊ Rifillimi i veprimtarisë tuaj ekonomike

◊ Ulja e volumit të prodhimit

◊ Ulje e xhiros dhe fitimeve

◊ Vështirësi për sigurimin e lëndës së parë

◊ Ulje e çmimit të shërbimeve / produkteve që ofron kompania juaj

◊ Rritje e çmimit të shërbimeve / produkteve që ofron kompania juaj

◊ Shkurtim personeli

◊ Ulja e pagave të personelit

◊ Aplikoj për kredi nga banka ose institucione të tjera financiare

◊ Shfrytëzoj overdraftin e llogarisë bankare dhe/ose kartave të kreditit

◊ Shitja e aseteve të kompanisë

◊ Kërkoj hua nga individë (familjarë, miq, të njohur etj.)

◊ Ndryshim i portofolit me produkte / shërbime të tjera

◊ Investime në teknologji

P.29 Cilat do të ishin 2 sugjerimet tuaja për politikat lehtësuese që duhet të ndërmarrë qeveria shqiptare për bizneset që janë dëmtuar nga tërmeti dhe /ose nga pandemia COVID-19?

◊ Lehtësimi i barrës fiskale ose reduktimi i taksave, TVSH-s etj.

◊ Lehtësim ose reduktim i kontributeve sociale e shoqërore

◊ Lehtësimi i shlyerjes së pagave të punonjësve

◊ Lehtësimi i shlyerjes së qirave

◊ Lehtësimi i blerjes së materialeve të ndërtimit dhe shërbimeve ndërtuese, riparuese

◊ Ndihmë financiare (kredi të zbutura me norma të ulëta interesi etj.)

◊ Kreditimi i drejtpërdrejtë përmes institucioneve publike

◊ Thjeshtim në dhënien e garancive për kredi, që bankat tregtare të zgjerojnë huadhënien

◊ Ofrimi i granteve dhe subvencione për bizneset në nevojë

◊ Tjetër shkruaj**.....**

Shoqata Together for Life ju falënderon për pjesëmarrjen dhe mendimet tuaja! Nëse dëshironi të mësoni mbi rezultatet e këtij studimi, ju lutem plotësoni të dhënat e mëposhtme

Emër Mbiemër **.....** Kompania ..... *Adresë e-mail* **.....**

ANEKSI C – UDHËRRËFYESI PËR INTERVISTAT ME INSTITUCIONET PUBLIKE E ATO MIKROFINANCIARE

Situata e përgjithshme e biznesit (përpara tërmetit dhe COVID-19)

Q.1 Cili është roli i institucionit tuaj në hartimin e politikave ose shërbime të dedikuara për biznesin?

Q.2 Specifikisht, cila është përfshirja e institucionit tuaj me sipërmarrjen e grave?

Q.3 Si do ta përkufizonit zhvillimin e bizneseve nga sipërmarrëse femra në Shqipëri: në rritje ose rënie, biznese të vogla, mesme ose të mëdha, sektori, etj.?

Q.4 Sipas mendimit dhe përvojës tuaj, cilat janë janë vështirësitë kryesore me të cilat përballen sipërmarrëset femra? A janë këto vështirësi të ndryshme nga ato që hasin sipërmarrësit meshkuj? A janë burrat më të favorizuar sesa gratë në biznes?

Q.5 Nëse po, ku sipërmarrëset femra janë më pak të favorizuara, pra ku hasin vështirësi ose diskriminim për shkak të gjinisë? Dhe cilat janë arsyet ose faktorët që sipërmarrëset femra hasin më shumë vështirësi në treg sesa sipërmarrësit meshkuj?

Q.6 A ka propozuar institucioni (ministria) juaj masa ligjore (përpara tërmetit të 26 nëntorit) për përmirësimin e klimës së biznesit në përgjithësi dhe biznesit të grave në veçanti? Cilat janë këto masa?

Q.7 Çfarë mund të thoni për mbështetjen që institucioni juaj ka dhënë deri më tani për biznesin dhe veçanërisht për sipërmarrëset gra në Shqipëri? Po në zona si Tirana, Durrësi e Lezha?

Q.8 A ka plane për programe ose shërbime të reja mbështetëse për biznesin në përgjithësi? Cilat janë ato?

Q.9 A vlerësoni që pushteti qendror ose lokal, donatorët, institucionet bankare e mikrofinanciare duhet të ndërmarrin iniciativa të veçanta për mbështetjen e grave sipërmarrëse?

Q.10 A ka plane për programe ose shërbime të reja mbështetëse veçanërisht për sipërmarrëset gra? Nëse po, cilat janë ato?

Q.11 Çfarë tjetër do të sugjeronit si aktivitete ose aksione të domosdoshme për të ndihmuar dhe mbështetur gratë sipërmarrëse në Shqipëri? Këto mund të jenë nga pushteti qendror ose lokal, institucionet financiare, donatorët, etj.

Tërmetet vjeshtë 2019 dhe pandemia COVID-19: pasojat tek biznesi

Q.12 Në dijeninë tuaj sa është prekur sipërmarrja private nga tërmetet e vjeshtës 2019? Cilët janë sektorët dhe zonat më shumë të prekura negativisht nga tërmeti?

Q.13 A pati biznese ose sektorë të cilët u ndikuan pozitivisht nga kjo fatkeqësi natyrore? Nëse po, cilët? P.sh. ndërtimi, tregtia e materialeve të ndërtimit, etj.

Q.14 Më specifikisht për sipërmarrëset gra, a keni të dhëna sa prej tyre janë dëmtuar në përgjithësi? Po në zona si Tirana, Durrësi e Lezha?

Q.15 Sa është fatura financiare e dëmeve të shkaktuara biznesit nga tërmeti? Po ndaj biznesit të grave specifikisht? Sa është fondi i vënë në dispozicion nga qeveria për mbështetjen e tyre?

Q.16 Cilat kanë qenë masat, politikat apo programet për mbështetjen e biznesit të dëmtuar nga tërmeti shtator / nëntor 2019?

Q.17 Në dijeninë tuaj sa është prekur sipërmarrja private nga pandemia COVID-19 dhe masat e qeverisë për izolim (ndërprerje e plotë / pjesshme e aktivitetit privat)? Cilët janë sektorët dhe zonat më shumë të prekura negativisht nga pandemia?

Institucioneve publike:

a) A keni një faturë të dëmeve të shkaktuara biznesit nga COVID-19?

b) A ka pasur ankesa ose kërkesa nga biznesi pas tërmetit ose pandemisë? Sa është numri i tyre? Sa prej këtyre ankesave / kërkesave vijnë nga gratë sipërmarrëse? Cilat janë problematikat ose shqetësimet e ngritura prej tyre?

Q.18 A pati biznese ose sektorë të cilët u ndikuan pozitivisht nga kjo fatkeqësi natyrore? Nëse po, cilët? P.sh. e-commerce, media digjitale, etj.

Q.19 Më specifikisht për sipërmarrëset gra, a keni të dhëna sa prej tyre janë dëmtuar në përgjithësi nga kjo pandemi? Po në zona si Tirana, Durrësi e Lezha?

Q.20 Cilat kanë qenë masat, politikat apo programet për mbështetjen e biznesit të dëmtuar nga pandemia COVID-19? Dhe si i vlerësoni, sa efikase janë këto masa të ndërmarra nga qeveria apo institucionet bankare e mikrofinanciare?

- Si e vlerësoni paketën e parë të ndihmës financiare nga qeveria? Po paketën e dytë të ndihmës financiare nga qeveria si e vlerësoni?

Q.21 A ka masa apo programe të tjera të planifikuara për të mbështetur biznesin e dëmtuar nga pandemia në përgjithësi dhe për gratë sipërmarrëse në veçanti? Nëse po, çfarë mendohet të ofrohet akoma më tej?

Q.22 Sipas mendimit tuaj, sa e lehtë do të jetë rimëkëmbja e biznesit pasi është përballuar me disa

fatkeqësi natyrore të njëpasnjëshme (tërmetet dhe COVID-19)?

Q.23 Po specifikisht bizneset e grave sipërmarrëse? Sipas mendimit tuaj, sa kohë mund të duhet, sa e tyre mund të rimëkëmben vs sa % mund të falimentojnë etj?

Q.24 Çfarë duhet dhe mund të bëjë qeveria shqiptare dhe institucionet e saj? Çfarë mund dhe duhet të bëjnë institucionet financiare si bankat apo shoqëritë mikrofinancuese?

Shoqata Together for Life ju falënderon për pjesëmarrjen dhe mendimet tuaja!

Nëse dëshironi të mësoni mbi rezultatet e këtij studimi, na nevojiten të dhënat e mëposhtme

Emër Mbiemër ..... *Institucioni* ..... *Adresë e-mail* .....